- Gjatë muajit Janar dhe Shkurt 2024, Zyra e Personelit është marrë me procesin e pranimit të formularëve të vlerësimit të shërbyesve civil nga ana e Drejtorëve të Drejtorive dhe udhëheqësve të sektorëve;
- Zyra e Personelit gjatë vitit 2024 në vazhdimësi ka mbajtur kontaktet me Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik si dhe është marrë me kërkesat e të punësuarve rreth procesit të kategorizimit në klasa të vendeve të punës, bazuar në ligjet në fuqi;
- Janë përgatitur përgjigje për zyrtarët e punësuar rreth kërkesave të adresuara në Zyrën e Personelit;
- Janë mbajtur kontaktet me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, ku janë përgatitur dhe përcjellë materialet e kërkuara nga KPMSHCK-së, konform kërkesave të adresuara (të gjitha brenda afateve ligjore);
- Janë përgatitur kërkesa për korrigjimin e titujve të punës gjegjësisht për ndryshimin e koeficienteve të pagave për shërbyesit civil dhe janë përcjellë në Ministrinë e Punëve të Brendshme - DMZP;

- Janë përgatitur akt-emërimet dhe kontratat për të gjithë të punësuarit pas procesit të klasifikimit;
- Me kërkesa të ish të punësuarve janë dorëzuar në kopje dokumente të ndryshme nga dosjet pasive të zyrtarëve që nuk janë më në marrëdhënie pune;
- Janë lëshuar vërtetime siç janë përvoja e punës, referenca etj.
- Në sistem janë miratuar apo refuzuar kërkesat e pushimit për shërbyesit civil;
- 5 punëtorë janë pensionuar gjatë vitit 2024, 3 dorëheqje dhe 1 pensionim i parakohshëm dhe të njëjtëve iu është lëshuar vendimi;
- Gjatë vitit 2024 janë përgatitur 6 vendime për pushim të lehonisë;
- Janë plotësuar formularët si më poshtë:
 - Plani vjetor për trajnime;
 - Regjistri i shërbyesve civil të cilët pensionohen në vitin 2024;
 - Plani i Personelit për vitin 2024 (përmes SIMBNJ);
 - Janë ndjekur trajnime rreth legjislacionit për shërbyesit civil dhe publik si dhe rreth përdorimit të SIMBNJ (versionit të ri të Sistemit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore) dhe sistemit të ri të pagave në sistem elektronik;
- Për çdo muaj janë plotësuar formular të ndryshëm për pagat si:
 - Formularët për punonjësit e ri,
 - Formularët e largimeve,
 - Formularë të ndryshimeve si: ndryshimi i përvojës së punës, ndryshimet për lehonat, ndalesa në pagë, transfere bankare, etj.
 - Formularët retroaktiv për shtesa si dhe
 - Regjistrat Elektronik për Pagesat e Anëtarëve të Asamblesë Komunale dhe Komiteteve Obligative, pagesa e kujdestarisë për Qendrën Rezidenciale si dhe kujdestaritë për zjarrfikësit.

Të gjitha këto dokumente të plotësuara dhe të skanuara janë dërguar në formë elektronike në MFPT.

- Është plotësuar raporti i detajuar i punës për vitin 2024 dhe është dërguar në DMZP;
- Janë skanuar dhe janë vendosur në dosje, dokumente shtesë të punëtorëve që kanë sjellë në Zyrën e Personelit. Këto janë bërë në përputhje me rregulloren për dosje;
- Janë nxjerrë vërtetime të ndryshme sipas kërkesave të të punësuarve;
- Janë përgatitur vendime për përvojën e punës për punëtorët që kanë sjellë dëshmi shtesë të përvojës;
- Janë nxjerrë nga sistemi, regjistrat e pagave për punëtorët e administratës komunale, punëtorët e arsimit dhe shëndetësisë për vitin 2024 (për çdo muaj);

- Janë zhvilluar 6 procedura të jashtme;
- Për të gjithë këto rekrutime janë krijuar dosjet e punonjësve të ri.

Zyra e Personelit gjatë muajit Dhjetor përpos punëve të përditshme është marr si me konsultime të ndryshme me nëpunësit civil lidhur me të drejtat e tyre edhe me procesin e vlerësimit të shërbyesve civil përkatësisht janë udhëzuar për këtë proces.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



ZYRA E INFORMIMIT DHE KOMUNIKIMIT ME PUBLIKUN

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2024

Zyra e Informimit dhe Komunikimit me Publikun e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Ferizajt, shënoi suksese në fushën e informimit publik për aktivitetin e Komunës. Kjo për faktin se gjatë këtij viti kjo zyrë ka arritur të bëjë shpërndarjen e informacioneve që kanë të bëjnë me aktivitetet e realizuara nga Zyra e Kryetarit të Komunës dhe drejtoritë komunale.

Pasqyrimi i drejtë dhe i paanshëm i ngjarjeve që ndodhin për dhe nga Komuna është përmbushur si mision i Zyrës së Informimit dhe Komunikimit me Publikun. Kjo duke përcjellë e publikuar gjithë aktivitetin e mekanizmave kyç të organeve të administratës komunale, veprimtarisë së pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ në Komunën e Ferizajt.

Komuna e Ferizajt në vitin 2024, u shpall Komuna më transparente në Republikën e Kosovës, vlerësim ky nga Instituti Demokratik i Kosovës, përmes instrumentit të quajtur “Transparometri Komunal”, që vlerëson transparencën komunale duke matur e vlerësuar dhjetëra tregues të fushave të ndryshme të punës së Komunës.

Sfida kryesore që ka të bëjë me fushën e informimit publik është mungesa e garancisë për ruajtjen e të dhënave, dokumenteve të publikuara në ueb faqen e Komunës nga ana e kontraktorit të MAPL-së për mirëmbajtjen e ueb faqeve të komunave. Kjo sfidë është adresuar me kohë tek kompetentët.

Në planin e dokumenteve strategjike, ZIK ka përmbushur të gjitha detyrimet e kërkesat e nivelit qendror, përkatësisht MAPL-së sa i përket miratimit të dokumenteve në funksion të rritjes së transparencës komunale.

Raportet e bashkëpunimit mes Zyrës së Informimit dhe Komunikimit me Publikun me shoqërinë civile, mediat dhe qytetarët edhe gjatë vitit 2024 kanë mbetur mirë të strukturuara dhe korrekte. Kjo falë krijimit të një tradite bashkëpunimi dhe infrastrukture të qëndrueshme të komunikimit të dyanshëm.

Gjatë vitit 2024, Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun ka bërë edhe organizimin e konsultimeve publike, takimeve publike dhe dëgjimeve buxhetore.

Gjatë vitit 2024 janë mbajtur këto konsultime publike:

- Konsultim Publik për Plotësim-Ndryshimin e Rregullores për Orarin e Punës të Veprimtarive Afariste dhe veprimtarive tjera në Ferizaj;
- Konsultim Publik për Plotësim-Ndryshimin e Projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare;
- Konsultim publik për Projekt-Strategjinë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt për vitin 2024-2029 si dhe Draft-Planin e Veprimit për Rininë 2024-2027;
- Konsultim publik i organizuar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për Kornizën Afatmesme Buxhetore;
- Konsultim publik i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financave (KPF) për Buxhetin;
- Njoftimi për organizimin e konsultimit publik për Projekt-Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026

Gjatë vitit 2024 janë mbajtur 9 dëgjime publike për përgatitjen e Buxhetit të Komunës, ndërsa dëgjimet janë mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës me këto grupe të interesit:

- OJQ-të, të rinjtë, sportistë dhe mediat;
- Dëgjimi buxhetor me grupet e interesit (biznese, fermerë);
- Komuniteti i Arsimit, drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme të Komunës së Ferizajt;
- Dëgjimi buxhetor me grupe të nënpërfaqësura (pensionistët, personat me aftësi të kufizuara etj);
- Komuniteti shëndetësor - Personeli shëndetësor QKMF, QMF të Komunës së Ferizajt;
- Takim me komunitetet jo shumicë;
- Takim me gratë.

Po ashtu janë mbajtur edhe 3 takime buxhetore me pjesëmarrje në Komunën e Ferizajt.

-Janë mbajtur edhe dy takime publike me qytetarë, në këto takime Kryetari i Komunës, Agim Aliu ka raportuar për punën 6 mujore, si dhe ka prezantuar edhe Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027, si dhe ka raportuar punën një (1) vjeçare.

Mbledhjet e Kuvendit, diskutimet publike për aktet juridike që nxori Komuna e Ferizajt gjatë vitit 2024, diskutimet me qytetarë për hartimin e projektbuxhetit dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore, vendimet e Kryetarit të Komunës dhe drejtorive komunale, procesverbalet e Kuvendit, Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, marrëveshjet me institucione të ndryshme, raportet financiare, shpenzimet e buxhetit të vitit 2024, planet e raportet e mekanizmave të tjerë relevant të Komunës, konkurset, njoftimet, ankandet publike, lista e përfituesve të subvencioneve, projektet e realizuara, projektet që do të realizohen e dokumente tjera janë dokumentacione e materiale të qasshme në ueb faqen e Komunës së Ferizajt.

Gjatë vitit 2024, kemi pasur 89 kërkesa për qasje në dokumente publike ku 88 prej tyre janë miratuar, vetëm 1 nga kërkesat është refuzuar me miratimin edhe nga Agjencia e Informimit dhe Privatësisë, kërkesë e cila nuk ka plotësuar kushtet ligjore të legjislacionit në fuqi për qasje në dokumente publike. Për të gjitha kërkesat, janë përgatitur vendimet përkatëse për lejimin e qasjes në dokumente publike dhe të njëjtat i janë dorëzuar bashkë me materialin përkatës për qasje në dokumente publike, parashtruesve të kërkesave.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024, më 18.07.2024 është mbajtur takim i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, në të cilën temë e diskutimit ishte situata e sigurisë në nivel lokal, ku nga të pranishmit – anëtarë të KKSBB-së u diskutuan tema të shumta mbi sigurinë publike në territorin e Ferizajt.

Synim për vitin 2025, Zyra e Informimit dhe Komunikimit me Publikun ka krijimin e lehtësirave teknologjike për qasjen në informacione e dokumente zyrtare, përmes platformave digjitale, rritja e dukshmërisë dhe qarkullueshmërisë përmes promovimit të ueb faqes zyrtare të Komunës, shtimin e kapaciteteve njerëzore e operative në kryerjen e detyrave të informimit publik dhe përdorimi i zgjeruar i kanaleve alternative e të drejtpërdrejta të komunikimit me publikun. Në vitin 2025, do të bëhet edhe ndryshimi i Rregullores së Transparencës, por edhe Planit të Veprimit të Transparencës Komunale.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

INSPEKTORATI I KOMUNËS

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2024

Gjatë vitit 2024, Sektori për Inspektime në Komunën e Ferizajt, ka zhvilluar procesin e punës sipas objektivave dhe planit të punës të parashikuar për periudhën një vjeçare, ku ka kryer një varg inspektimesh: të planifikuara, të paplanifikuara, ri-inspektime, me parashitje dhe të përbashkëta në territorin e Komunës së Ferizajt. Të gjitha këto veprime, Sektori për Inspektime në Komunën e Ferizajt i ndërmori duke u bazuar në Ligjin Nr.08/L-067 për Inspektimet dhe ligjet dhe rregulloret e tjera përkatëse në fuqi.

Sektori për Inspektime përbëhet nga këto njësi:

- Inspektorati Komunal i Ndërtimit;
- Inspektorati Komunal i Tregut;
- Inspektorati Komunal i Mbrojtjes së Mjedisit;
- Inspektorati Komunal i Komunikacionit;
- Inspektorati Komunal i Shërbimeve Publike.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Në realizimin e objektivave të inspektimit në Sektorin për Inspektime, janë kryer këto aktivitete:

- Organizimi dhe planifikimi i punëve të brendshme të sektorit;
- Shqyrtimi i ankesave, kërkesave;
- Inspektimi i subjekteve afariste dhe pajisja e tyre me pëlqim të kushteve minimale teknike;
- Luftimi i informalitetit;
- Mbrojtja e Konsumatorit;
- Siguria e produkteve në treg;
- Inspektimi i subjekteve të ndryshme për leje mjedisore;
- Identifikimi i deponive ilegale;
- Monitorimi i hapësirave publike për hedhjen e mbeturinave dhe ndotjeve të ndryshme;
- Monitorimi i gjendjes së rrugëve të qytetit;
- Monitorimi dhe largimi i shitësve ambulantë nga bulevardi i qytetit;

- Lirimi i hapësirave publike në vend punishte;
- Inspektimi dhe monitorimi i shitësve ambulant;
- Monitorimi dhe kontrollimi i objekteve me ose pa leje;
- Kontrollimi dhe monitorimi i objekteve me leje ndërtimore deri në pajisjen me certifikatën e përdorimit;
- Lirimi i trotuareve nga pengesat e ndryshme, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe Kompaninë “Pastërtia”;
- Monitorimi i operatorëve të transportit në kryerjen e shërbimit pa leje pune;
- Kontrollimi dhe monitorimi i parkingjeve publike dhe private;
- Aksione me Policinë e Kosovës – Njësi Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore;

Inspektorati Komunal i Tregut

1. Numri i ankesave, kërkesave (parashtresa): 171

Nga to disa kanë qenë nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit, disa nga qytetarët në adresë të inspektoratit të tregut të Komunës së Ferizajt, kërkesa për pranim teknik të lokaleve, kërkesa për zgjatje të orarit të punës.

2. Numri i inspektimeve të kryera: 298

3. Numri i masave korrigjuese të lëshuara: 30

4. Numri i shkeljeve të lehta: 22 gjoba

Inspektorati Komunal i Ndërtimit:

1. Numri i ankesave (parashtresave) të pranuar: 1388

Gjithsej janë pranuar 1388 parashtresa, ku 1369 janë kërkesa, 17 ankesa dhe dy (2) njoftime. Nga 1369 kërkesa në total, 1341 janë kërkesa për inspektimin e fazave të ndërtimit sipas udhëzimit administrativ të MMPHI-së, Nr.05/2017, 28 për dalje në vendin e ngjarjes, ndërsa 17 ankesa janë për daljen në vendin e ngjarjes, konstatimin e gjendjes faktike dhe zgjidhjen e problemit.

2. Numri i inspektimeve të kryera: 205

3. Numri i masave korrigjuese të lëshuara: 71

4. Numri i shkeljeve serioze: 32

5. Numri i shkeljeve të lehta: 53

6. Numri i masave urgjente të ndërmarra nga inspektorët: 39 (31-të janë vendime për ndërprerje të punimeve dhe 5 kallëzime penale).

Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit

1. Numri i parashtresave të pranuar (ankesa, kërkesa): 57

2. Numri i inspektimeve të kryera: 443

3. Numri i masave korrigjuese të lëshuara: 233 (për pajisje me LMK dhe zbatimin e Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit).

4. Numri i shkeljeve të lehta: 31 gjoba

Inspektorati Komunal i Shërbimeve Publike

- 1. Numri i ankesave (parashtresave) të pranuarra: 47**
- 2. Numri i inspektimeve të kryera: 196**
- 3. Numri i masave korrigjuese të lëshuara: 189**
- 4. Numri i shkeljeve serioze: 6**
- 5. Numri i shkeljeve të lehta: 15**

Inspektorati Komunal i Komunikacionit

- 1. Numri i ankesave (parashtresave) të pranuarra: 13**
- 2. Numri i inspektimeve të kryera: 80**
- 3. Numri i masave korrigjuese të lëshuara: 6**
- 4. Numri i shkeljeve të lehta: 6**

Raporti i përgjithshëm i Sektorit për Inspektime

Gjatë vitit 2024 në Sektorin për Inspektime në Komunën e Ferizajt kanë punuar gjithsej njëmbëdhjetë (11) inspektorë duke përfshirë këtu edhe Udhëheqësin e Sektorit për Inspektime, ku janë kryer një mori inspektimesh ashtu siç parashihet me ligjet përkatëse dhe duke zbatuar Ligjin 08/L-067 Për Inspektime. Të poshtëshënuar po paraqesim raportin e përgjithshëm të Sektorit për Inspektime në Komunën e Ferizajt.

- 1. Numri ankesave të pranuarra gjithsej: 1676**
- 2. Numri i inspektimeve të kryera: 1222**
- 3. Numri i shkeljeve të lehta (gjoba mandatore): 127**



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2024

Raporti i punës është përgatitur nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, i cili përmbledh punët dhe shërbimet e auditimit të brendshëm të kryera gjatë vitit kalendarik 2024.

Raporti pasqyron punën e kryer dhe rezultatet e arritura, krahasuar me objektivat dhe detyrimet e planifikuara vjetore të vitit 2024. Auditimet e brendshme janë të mbështetura dhe të bazuara në Ligjin Nr.06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike si dhe ligjeve dhe akteve nënligjore të tjera në fuqi.

Njësia e Auditimit të Brendshëm, për vitin 2024 ka përgatitur Planin Strategjik 2024/2026 si dhe Planin Vjetor 2024 e që planifikimi i auditimit është bazuar në rrezikun dhe orientimin e identifikimit dhe përfshirjes për fushat me rrezik për organizatën buxhetore.

Pasi që nga ana e Njesisë së Auditimit të Brendshëm është përgatitur Plani Strategjik dhe Plani Vjetor për vitin 2024, është përcjellë për miratim tek Kryetari i Komunës dhe tek Kryesuesi i Komitetit dhe gjithashtu është dorëzuar një kopje e miratuar në Njësinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm.

Në Planin Strategjik 2024-2026 janë të përfshira të gjitha drejtoritë-njësitë buxhetore, duke u bazuar në nivelin e rrezikshmërisë me: rrezik të lartë, rrezik të mesëm dhe rrezik të ulët dhe gjithashtu është hartuar Plani Vjetor në të cilin janë paraparë ditët efektive për çdo auditim.

Për vitin 2024, sipas Planit Vjetor janë paraparë gjithsej shtatë (7) auditime të brendshme, që janë: katër (4) me rrezik të lartë dhe tre (3) me rrezik të mesëm. Për vitin 2024 janë kryer këto auditime:

- Grumbullimi i të hyrave vetanake në Drejtorinë e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit;
- Procedurat e menaxhimit të shpenzimeve të mallrave, shërbimeve, komunalit, subvencione dhe kapitale në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë;
- Procedurat e menaxhimit të pasurive dhe inventarit në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme;
- Procedurat e menaxhimit të resurseve njerëzore në Drejtorinë e Arsimit;
- Procedurat e menaxhimit të prokurimit në Zyrën e Prokurimit;
- Grumbullimi i të hyrave nga tatimi në pronë, taksat e bizneseve dhe qirave në Drejtorinë e Financave;
- Grumbullimi i të hyrave vetanake në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit.

Niveli i realizimit të Planit Vjetor

Gjatë vitit 2024, Zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm ka arritur t'i kryej shtatë (7) auditime të brendshme nga shtatë të planifikuara.

Pra, gjatë vitit 2024, Zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm ka arritur t'i kryej gjithsej shtatë (7) auditime të brendshme dhe t'i hartoj raportet dhe t'i dorëzoj në drejtoritë e audituara, Kryetarit të Komunës, si dhe Kryesuesit të Komitetit nga një kopje të raporteve finale.

Nga gjithsej shtatë (7) auditimet e kryera për të gjeturat e konstatuara kemi dhënë njëzetë e dy (22) rekomandime për përmirësim, me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe efektivitetit gjatë kryerjeve të detyrave të punës nga ana e zyrtarëve të Komunës.

Për rekomandimet e dhëna, të gjitha drejtoritë janë përgjigjur, duke na përcjellë dhe përgatitur planin e veprimit dhe datën përfundimtare të zbatimit të rekomandimeve. Bazuar në planet e veprimit të drejtorive, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka përgatitur oraret e përcjelljes së implementimit të rekomandimeve të dhëna nga kjo zyrë.

Gjatë përcjelljes së zbatimit të rekomandimeve nga gjithsej njëzetë e dy (22) rekomandimet e dhëna, kemi konstatuar këtë gjendje lidhur me zbatimin e tyre nga ana e drejtorive:

- Tërësisht të zbatuara - katër (4)
- Në proces - dhjetë (10)
- Të pazbatuara - tetë (8)

Dhjetë (10) rekomandime mbeten për përcjellje gjatë vitit 2025, sipas planit të veprimit të përgatitur për datën përfundimtare të implementimit.

Zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, për çdo përcjellje të rekomandimeve ka hartuar raporte dhe ua ka dorëzuar drejtorive të audituara, Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Komitetit.

Zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, për dy (2) gjashtëmuajt e vitit 2024 dhe përmbledhjen e vitit 2024 ka përgatitur raportet përmbledhëse dhe ua ka dorëzuar për njoftim me gjendjen e audituar në drejtoritë e audituara në Komunën e Ferizajt, Njesisë Qendrore Harmonizuese, Kryetarit të Komunës, si dhe Kryesuesit të Komitetit.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



ZYRA E INTEGRIMEVE EVROPIANE

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2024

Zyra e Integritimeve Evropiane vepron brenda Kabinetit të Kryetarit dhe ka për detyrë koordinimin, monitorimin dhe raportimin tek institucionet përkatëse që trajtojnë çështjet e integritimeve evropiane. Për këtë arsye, mbajmë komunikim të vazhdueshëm me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), konkretisht me Departamentin për Integritime Evropiane.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2024, kemi përmbushur me përpikëri të gjitha përgjegjësitë tona zyrtare, duke siguruar një bashkërendim efektiv, monitorim të rregullt dhe raportim të saktë në institucionet qeveritare të Republikës së Kosovës që trajtojnë integritet evropiane.

Zyrtari për Integritime Evropiane ka qenë pjesë e ekipit të Kryetarit të Komunës në procesin e aplikimit për fondet e Bashkimit Evropian, duke mbajtur kontakte të rregullta me organizata ndërkombëtare, përfshirë ato të Këshillit të Evropës dhe institucione të tjera që veprojnë në Republikën e Kosovës. Po ashtu, këto ekipe të përbashkëta vazhdojnë të jenë aktive në përgatitjen dhe aplikimin për thirrjet e reja të BE-së. Gjatë kësaj periudhe, kemi realizuar raportime periodike në MAPL në lidhje me Bashkëpunimin Ndër komunal dhe Ndër komunal Ndërkombëtar.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Zyra për Integritime Evropiane ka kryer raportime të rregullta në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) lidhur me zbatimin e Planit Individual të Veprimit për Komunën e Ferizajt, i cili buron nga Agjenda Evropiane për vitin 2024. Gjithashtu, kemi plotësuar pyetësorët e ndryshëm të kërkuara nga MAPL dhe Agjencia e Kosovës për Krahësim (AKK).

Janë ndërmarrë të gjitha veprimet prioritare për procesin e integritimeve evropiane, duke u fokusuar në krijimin e një mjedisi të favorshëm për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës së qytetarëve, forcimin e sundimit të ligjit, mbrojtjen e pronës, lirinë e lëvizjes, shprehjen e mendimit, promovimin e tolerancës dhe ndërtimin e besimit të ndërsjellë.

Në periudhën Janar–Dhjetor 2024, kemi mbajtur komunikim të vazhdueshëm dhe kemi përcjellë informacionet e kërkuara me Departamentin për Koordinim, Zhvillim dhe Integritime Evropiane të MAPL-së, si dhe me ministritë përkatëse. Po ashtu, kemi marrë pjesë aktivisht në të gjitha takimet konsultative dhe tryezat e punës, duke iu përgjigjur pozitivisht ftesave të institucioneve dhe duke dhënë kontributin tonë në çështjet përkatëse.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2024

Gjatë vitit 2024, ZKKK ka zhvilluar një mori aktivitete në përmbushje të detyrave zyrtare, duke ndihmuar, lehtësuar, asistuar, njoftuar dhe komunikuar me palë të shumta si dhe në komunikim me institucione qeveritare e joqeveritare, me qëllim të ofrimit të lehtësimeve për komunitetet jo shumicë në Ferizaj.

ZKKK gjatë vitit 2024:

- Ka dhënë kontributin e saj duke qenë pjesë e hartimit të dokumente strategjike e planeve të veprimit në kuadër të Komunës;
- Zhvilluam vizita në lagjet komunitare bashkë me KFOR-in amerikan si në lagjen Sallahane, Halit Ibish si dhe në fshatin Dubravë, ku pjesëtarët e KFOR-it amerikan u njohën më afër me kërkesat e banorëve;
- Bashkëpunuam me organizatën Terre Des Homme lidhur me parandalimin e braktisjes së mësimit nga nxënësit;
- Bashkëpunuam me organizatën “Self Employed Contractor” që kishte të bënte me hulumtimin e komuniteteve në sferën e edukimit, arsimit dhe shëndetësisë;
- Njoftuam dhe i asistuam familjet në nevojë për thirrjen e MAPL-së për ndërtimin e shtëpive për rastet sociale;
- U bëmë pjesë e projektit të aktivitetit të USAID-it “Kontrata Sociale”;
- Lehtësuam dhe mbështetëm të rinjtë në aplikimin për punë në kuadër të zyrës së punësimit;
- Bashkëpunuam me organizata të shumta në programe, trajnime e takime të ndryshme me fokus për avancimin e pozitës së komuniteteve në shoqëri si organizatën OSBE, CDF, GIZ, Fondacionin “Jahjaga”, USAID, Instituti Gjerman “Bom International Centre for Konflikt Studior Return+Belonging” - (BMZ), Vo Rae etj;
- Ishim pjesë e hartimit të Planit Lokal të Veprimit në kuadër të Strategjisë për Komunitetet.
- Ndihmuam, asistuam në plotësimin e dokumentacionit për aplikim për thirrjen publike të Ministrisë për Komunitet dhe Kthim për përmirësimin e kushteve të banimit për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë. Kjo përfshinte ndihmën në fushat si: rindërtimi i shtëpive, renovimi, material ndërtimor, teknikë të bardhë, mobilje dhe ushqim;

- Me pjesëmarrjen edhe të ZKKK-së, DSHMS ndihmoi me pako ushqimore 30 familje të komuniteteve;
- Mbështetëm përmes DSHMS-së dhe QPS-së, 106 familje skamnore të komunitetit;
- Realizuar pyetësin në terren për të dhënat socio-ekonomike për familjet rome, ashkali dhe egjiptiane në Komunën e Ferizajt;
- U integruam në kuadër të projektit për integrim socio-ekonomik dhe sigurim të të drejtave të barabarta për gratë dhe vajzat dhe gratë e riatdhesuara dhe refugjatët, projekt nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve dhe mbështetje nga Finlanda;
- Lidhëm bashkëpunimin dhe lehtësuam komunikimin me kompani private për punësimin e bashkëqytetarëve nga komuniteti jo shumicë;
- Komuna e Ferizajt dhe Shoqata “Jetimat e Ballkanit” ndërtuan dy shtëpi për familjet e komunitetit jo shumicë, si në fshatin Dardani dhe në fshatin Zaskok;
- Zhvilluam vizita të shumta në terren, në shkolla, biznese private, në institucione të ndryshme shtetërore, për të asistuar dhe ndihmuar bashkëqytetarët e komunitetit jo shumicë sipas kërkesave të tyre.
- Morëm pjesë në trajnime, diskutime dhe fokus grupe të shumta me organizata të shumta joqeveritare vendore e ndërkombëtare;
- Ishim pjesë e fushatës informuese nga ZK për liberalizimin e vizave;
- Asistuar Drejtorinë e Urbanizmit, Drejtorinë e Pronës, në takimin me banorët, lidhur me problemet pronësore të komunitetit në lagjet Sallahane, Halit Ibish dhe fshatin Dubravë;
- ZKKK-ja po ashtu i është përgjigjur 71 kërkesave gjyqësore të cilat kanë të bëjnë me adresat e panjohura të palëve në lidhje me kontestet pronësore.

RIATDHESIMI DHE RI-INTEGRIMI

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, qëllim parësor gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024 ka pasur koordinimin e aktiviteteve me të gjithë faktorët relevant që ndihmojnë në stabilizimin e komuniteteve, procesin e kthimit të qëndrueshëm dhe procesin e riatdhesimit dhe ri-integrimit me qëllim të krijimit të një klime të mirë për zhvillim të komuniteteve dhe ri-integrimit të tyre.

- Lehtësimin e dialogut ndëretnik dhe ndërtimin e besimit ndërmjet personave të kthyer dhe komunitetit pranues.
- Koordinimin e aktiviteteve me zyrtarët për kthim të qëndrueshëm, zyrtarët për integrim të komuniteteve, me institucionet komunale, ministritë përkatëse si dhe bashkëpunimin e ngushtë me organizatat e tjera lokale dhe ndërkombëtare të angazhuara në fushën e stabilizimit të komuniteteve, kthimit dhe ri-integrimit (shkëmbimi i informatave për personat e zhvendosur dhe personat e kthyer).

- Të riatdhesuar në vitin 2024 janë: 131 persona prej tyre 28 familje me 131 anëtarë dhe 9 individë (M 77 dhe F 54).

Sipas përkatësisë etnike :

Shqiptarë – 39 persona (22 M dhe 17 F)

Ashkali – 92 persona (55 M dhe 37 F)

- Të regjistruar në SMR (Sistemi i Menaxhimit të Rasteve) nga ZKKK – ja 33 raste të vitit 2024 dhe 4 raste të viteve të tjera.

- Komisioni Komunal për Ri-integrim ka mbajtur 3 takime për shqyrtimin e 4 kërkesave. Të aprovuar janë 3 kërkesa për akomodimi. Dy familje janë akomoduar për 12 muaj dhe një vazhdim akomodimi për 6 muaj. Ndërsa një familje është përkrahur me pako të orendive shtëpiake. Për këto lëndë janë përgatitur 4 vendime dhe janë kompletuar me dokumentet tjera të nevojshme të cilat janë bashkëngjitur në SMR dhe kopja fizike është dërguar tek Koordinatori Rajonal për Ri - Integrim pranë MPB – së.

- Vizita 72 orësh për plotësimin e Pyetësorit për Vlerësimin e Nevojave të Personave të Riatdhesuar dhe Formulari i Verifikimit në Terren janë 37. Pyetësori dhe Formulari i plotësuar janë bashkëngjitur në SMR.

- Nga Fondi për Ri - Integrim 3 familje janë furnizuar me pako ushqimore dhe higjienike dhe shpërndarja është bërë në koordinim me ZKKK -në.

- Tek Zyra e Punësimit janë rekomanduar 16 persona të riatdhesuar, të cilët më pastaj janë rekomanduar në Qendrën për Aftësim Profesional – QAP.

- Personat e riatdhesuar nga Gjermania gjatë vitit 2024, janë rekomanduar te organizatat URA 2 dhe organizata AVO, disa familje janë përkrahur nga këto organizata.

- Organizata e IOM – it ka bërë thirrje për aplikim me fonde të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim. ZKKK – ja ka njoftuar palët e interesit dhe në koordinim me organizatën e IOM – it janë vizituar dhe është bërë verifikimi për 20 aplikues.

KTHIMI

Sa i përket kthimit gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa për kthim. Të kthyerit nga Maqedonia e Veriut, janë asistuar nga UNHCR – i (AT - ja), të cilat gjatë kthimit janë përkrahur me akomodim njëvjeçar, pako ushqimore dhe jo ushqimore, pakot e orendive shtëpiake, pagesë mujore për një vit dhe projekt për qëndrueshmëri ekonomike. Por pas kësaj asistence, këto familje të kthyerat vazhdojnë të mbesin pa zgjidhjen e problemit të banimit në mungesë të pronës dhe gjendjes jo të mirë ekonomike.

Kemi qenë gjithashtu pjesë e aktiviteteve, trajnimeve dhe takimeve të punës me organizata të ndryshme dhe Ministri. Ngritja e kapaciteteve të ZKKK – ve dhe të gjitha aktivitete janë kryer në koordinim me Zyrtarët Komunal për Kthim të Qëndrueshëm.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



NJËSIA KOMUNALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE BARAZI GJINORE

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2024

Ky raport përmbledh aktivitetet, projektet dhe angazhimet e Zyrës për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në Komunën e Ferizajt për vitin 2024. Gjatë vitit 2024, Zyra është angazhuar në promovimin e barazisë gjinore, mbrojtjen nga diskriminimi, trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe fuqizimin e mekanizmave institucional për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore.

Raporti përmban të dhëna për aktivitetet kryesore të realizuara, bashkëpunimet ndër-institucionale dhe organizatat partnere dhe synimet në vitin 2025.

Nr.	Kategoria	Aktiviteti	Data/Vendi	Rezultatet/Komentet
1.	Hartimi i politikave për barazi gjinore	Draftimi i Planit Lokal për Barazi Gjinore (PLVBGJ)	Qershor- Dhjetor 2024	PLVBGJ u miratua në Kuvendin Komunal më 27.12.2024 dhe pritet të hyjë në fuqi në 2025.
2.	Bashkëpunimi ndërinstitucional	Takim me OSCE për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore	09.07.2024, Zyra e Nënkrjetarit	Diskutime mbi sfidat e implementimit të strategjive gjinore
3.	Mbrojtja nga dhuna në familje	Mekanizmi Koordinues Komunal kundër Dhunës në Familje	24.07.2024, Komuna e Ferizajt	Raportim mbi rastet e dhunës në familje dhe planet për ndërhyrje të shpejt
4.	Fuqizimi i grave dhe përfshirja e komunitetit	Takim me gratë e Komunës për dëgjime publike	08.08.2024, Komuna e Ferizajt	Identifikimi i nevojave dhe sfidave për gratë në komunitet.
5.	Takim me KRCT(Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës)	Diskutim mbi shërbimet për të mbijetuarit e dhunës dhe trajtimet psikologjike	01.10.2024, Ferizaj	Forcimi i bashkëpunimit me KRCT për mbështetjen e të mbijetuarve
6.	Takim në QPS	Koordinim për shërbimet sociale për rastet e dhunës në familje	25.10.2024, QPS-Ferizaj	Identifikimi i nevojave dhe mundësive për përmirësimin në shërbimet sociale.

7.	Punëtori me KRCT	“Qasja Sensitive ndaj të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale në Luftë”	11.10.2024, Hotel Garden-Prishtinë	Organizuar nga KRCT dhe mbështetur nga Ambasada Britanike. Diskutim mbi mbështetjen dhe trajnimin e të mbijetuarve.
8.	Takim me QPDG	Diskutime mbi mbështetjen për gratë dhe fuqizimin ekonomik të tyre	16.08.2024, Ferizaj	Planifikim i aktiviteteve për gratë dhe sfidat në përfshirjen e tyre në tregun e punës.
9.	Trajnime dhe ngritje kapacitetesh	Trajnim “Promovimi i Barazisë Gjinore përmes Teknologjisë Informative”	18-20.09.2024, Shkrel	Organizuar nga Zyra e Kryeministrit dhe UN Women.
10.	Konsultime Publike I	Konsultimi publik për PVBGJ	02.10.2024, Kuvendi Komunal	Përfshirja e publikut në hartimin e politikave për barazi gjinore.
11.	Vizita studimore	Vizitë në Bashkitë e Tiranës dhe Elbasanit për shkëmbim përvojash mbi barazinë gjinore	11-13.11.2024, Shqipëri	Përvojë nga mekanizmat e qeverisjes lokale për barazinë gjinore.
12.	Fushata vetëdijësuese	16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës me Baza Gjinore	25.11.2024 - 10.12.2024, Ferizaj	Organizimi i tryezave dhe aktiviteteve sensibilizuese me institucione lokale dhe organizata ndërkombëtare.
13.	Bashkëbisedim me nxënës të shkollave të mesme kundër dhunës me baza gjinore	16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës me Baza Gjinore	6 Dhjetor 2024, Palestra e Sporteve “Bill Clinton” - Ferizaj	Bashkëbisedim me nxënës të shkollave të mesme me pjesëmarrjen edhe të drejtuesve e përfaqësuesve të institucioneve tjera si Policia, Gjykata Themelore, Prokuroria Themelore, Strehimorja etj. Numri i nxënësve pjesëmarrës - 170 nxënës.
14.	Trajnime për buxhetimin gjinor	“Buxheti i përgjegjshëm gjinor si mjet për avancim të barazisë gjinore”	06.12.2024, Hotel Metropol	Pjesëmarrës nga drejtoritë komunale dhe përfaqësues të UN Women.
15.	Pjesëmarrje në takime institucionale	Mbledhja e Komisionit për Kthim dhe Ri integrim (KKR)	11.12.2024, Ferizaj	Shqyrtimi i rasteve të kthimit të familjeve nga diaspora dhe mbështetja institucionale.
16.	Mbledhje e organizuar nga Elizabeth Gouing – Këshilltare e Kryeministrit për Çështjet e Komuniteteve, me ndihmë nga OSBE-ja.	“Raportimi i Martesave Të Hershme në Komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian”.	22.11.2024, Ferizaj - Kuvendi Komunal	Pjesëmarrës nga drejtoritë komunale dhe komuniteti

SYNIMET PËR VITIN 2025

1. Rritja e fondeve për projektet e barazisë gjinore, për të mundësuar implementimin efektiv të PVBGJ-së.
2. Zhvillimi i fushatave vetëdijësuese për të rritur pjesëmarrjen e komunitetit në proceset vendimmarrëse.
3. Vazhdimi i bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare për mbështetje teknike dhe financiare.

Viti 2024 ka qenë një vit me angazhime të shumta në fushën e barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut në Komunën e Ferizajt. Përkundër sfidave të hasura, është arritur miratimi i Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore, fuqizimi i Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje dhe organizimi i fushatave vetëdijësuese për komunitetin.

Për vitin 2025, synojmë të rrisim bashkëpunimin institucional dhe ndërkombëtar për të avancuar më tej të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore në nivel lokal.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2024

Agnesa Hajredini
Drejtoresh e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme

Hyrje

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme është kompetente për ofrimin e shërbimeve të përgjithshme administrative për administratën komunale dhe për ofrimin e shërbimeve për qytetarë, bazuar në ligjet që janë në fuqi: Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji mbi Shërbimin Civil, Ligji për Gjendjen Civile, Statutin e Komunës, udhëzimet strategjike të Kryetarit të Komunës, rregulloret komunale, urdhëresat dhe udhëzimet administrative.

DAP është garantuese e funksionimit demokratik të administratës komunale në aspektin e vendimmarrjes

- E lirisë së shprehjes së mendimit;
- Trajtimin të drejtë të kërkesave e shqetësimeve të qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të caktuara të interesit;
- Zbatimin rigoroz të ligjit në procedurat administrative dhe ekzekutive;
- Rritjes së partneritetit ndërmjet administratës në njërën anë dhe qytetarëve në anën tjetër;
- DAP do të vazhdojë t'i ruajë dhe kultivojë edhe më tej marrëdhëniet e mira me komunitetet pakicë, në respektimin e të drejtave dhe lirive të tyre, sipas parimit ligjor dhe qytetar.

Synimet e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme gjatë vitit 2024 kanë qenë:

- Krijimi i një administrate profesionale, të përgjegjshme dhe të paanshme në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve;
- Infrastrukturë të avancuar profesionale;
- Ofrimin e shërbimeve që kanë të bëjnë me punët e legjislativit dhe të ekzekutivit.

DAP është angazhuar për të siguruar dhe garantuar:

- Respektim të ligjit (akteve ligjore, nënligjore dhe normative);
- Llogaridhënie;
- Profesionalizëm;
- Efikasitet;
- Barazi gjinore;
- Transparencë në vendimmarrje dhe procedura ekzekutive;
- Shërbime publike cilësore dhe të shpejta për qytetarët;

- Frymë të tolerancës për mendimin ndryshe dhe të bashkëpunimit e bashkëpjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në përmirësimin e shërbimeve të administratës komunale.

Angazhimi i vazhdueshëm i DAP për ndërtimin e një administrate funksionale dhe efikase mbi bazën e respektimit të ligjit.

- DAP gjatë vitit 2024 ka zhvilluar një aktivitet të gjithanshëm të bazuar në respektimin e ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës, duke qenë në funksion dhe në shërbim të gjithë administratës komunale dhe të qytetarëve të Komunës tonë.
- DAP e organizuar në sektorët e lartshënuar ka arritur që me përkushtimin më të lartë t'i kryej me sukses të gjitha punët dhe detyrat që i kanë dalë përpara gjatë kësaj periudhe një vjeçare të punës, duke qenë vazhdimisht në shërbim të gjithë administratës komunale dhe të qytetarëve të Komunës tonë.

Më poshtë po përmendim vetëm disa nga aktivitetet më të rëndësishme të administratës komunale:

- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme gjatë vitit 2024 ka bërë shitjen e inventarit të vjetruar jashtë përdorimit dhe jashtë funksionit (aparate elektrike dhe inventarë nga prodhimi i drurit dhe metalit) përmes ankandit të shpallur nga Zyra e Prokurimit, me numër 01K/94/2024 me datën 10.09.2024.
- Gjatë këtij viti kemi organizuar dhe mbikëqyrur regjistrimin vjetor të inventarit të gjithë sektorëve të administratës komunale duke përfshirë edhe institucionet arsimore, shëndetësore, bibliotekave si dhe institucioneve të tjera që janë nën menaxhimin e Komunës dhe pas këtij regjistrimi kemi bërë edhe tërheqjen e inventarit të demoluar, duke e grumbulluar në depo, kurse pjesën që kemi konstatuar se mund të përdoret e kemi riaftësuar dhe dhuruar shkollave që kanë pasur nevojë (sipas kërkesave të tyre).
- Këto veprime janë kryer duke formuar paraprakisht komisionet adekuate siç janë: Komisioni për vlerësim dhe regjistrim të inventarit;
- Janë ndërmarr edhe një varg hapash e masash të tjera për funksionalizimin e mëtejshëm dhe bërjen më efikase të administratës komunale.

Në vazhdim do të paraqesim punën vjetore të sektorëve dhe njësive të DAP.

Administrata gjatë vitit 2024

DAP gjatë vitit 2024 ka zhvilluar aktivitetin e vet përmes këtyre njësive organizative:

1. Asistentja Ekzekutive
2. Zyrtari financiar
3. Sektorit të Gjendjes Civile;
4. Sektorit të Shërbimeve të Qytetarëve;
5. Sektori i Shërbimeve të Përbashkëta;
6. Sektori i Arkivit të Komunës;

1. ZYRTARJA ADMINISTRATIVE (Asistentja Ekzekutive)

Është përkujdesur për punët administrative në kuadër të Drejtorisë, përkatësisht ka pranuar të gjitha kërkesat e Drejtorisë për të cilat janë zhvilluar procedura, dhe të njëjtat i klasifikon dhe i ruan në Arkivin e Drejtorisë. Përgatitë njoftime dhe shkresa të tjera të DAP-së, protokollon të gjitha shkresat që dalin nga DAP, përcjellë përmes postës elektronike shkresa dhe materiale të dedikuara për Ministri, përmes intranetit u jep përgjigje kërkesave që i kushtohet DAP-së si dhe përpilon raportet e Drejtorisë.

2. ZYRTARI FINANCIAR

Është përkujdesur për gjendjen financiare të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, përkatësisht i ka ndërmarrë të gjitha veprimet për kompletimin e lëndëve për pagesën e të gjitha faturave të cilat kanë të bëjnë me shpenzimet e energjisë elektrike, ujit, faturat e mbeturinave, faturat për riparimin e mjeteve zyrtare si dhe faturat tjera që janë barrë e drejtorisë përkatëse.

3. SEKTORI I GJENDJES CIVILE

Të dhënat për dokumentacionin e lëshuar dhe regjistrimet e bëra nga Sektori i Gjendjes Civile (SGJC), gjatë vitit 2024, po i paraqesim në formë tabelore:

Numri i dokumenteve të lëshuara:

Nr.	Përshkrimi	Përdorim brendshëm të	Përdorim jashtëm të
1.	Ekstrakt nga RQGJC	38530	10031
2.	Certifikata të lindjes	3773	19246
3.	Certifikata të martesës	3578	6028
4.	Certifikata të vdekjes	3364	903
5.	Certifikata të statusit martesor	2226	899
6.	Certifikata të shtetësisë	452	554
7.	Certifikata familjare	7795	2236
8.	Certifikata të vendbanimit	5628	2795
9.	Vërtetim nga arkivi	589	773
		65935	43465
Gjithsej dokumente të lëshuara		109400	

Regjistrime të bëra në Regjistrat e Gjendjes Civile:

1.	LINDJE	2425
	1.1.Brenda vendit	1538
	1.2.Jashtë vendit	381
	1.3. Me vonesë	506
2.	MARTESA	1286
	2.1. E rregullt	1052
	2.2. Jashtë vendit	234
3.	VDEKJE	727
	3.1.Brenda vendit	515
	3.2.Jashtë vendit	57
	3.3. Me vonesë	155
Gjithsej regjistrime të bëra		4438

Numri i dokumenteve të lëshuara nga Platforma Elektronike E-Kosova

1.	Certifikata të lindjes	21221
2.	Ekstrakt nga RQGJ	20690
3.	Certifikata të martesës	5645
4.	Certifikata të vdekjes	669
Gjithsej		84225

Raporti i adresave të regjistruara

1.	Adresat e regjistruara të deklaruara nga AKK	442
2.	Deklarimi i adresave nga E - Kosova	247
Gjithsej		689

Numri i kërkesave për fitim dhe lirim të shtetësisë

1.	Fitim të shtetësisë	251
2.	Lirim të shtetësisë	20
Gjithsej kërkesa		271

Numri i dokumenteve Shërbime me aktvendim

1.	Aktvendime për regjistrime të mëvonshëm në RGJCL-Ri regjistrim	29
2.	Aktvendime për regjistrime të mëvonshëm në RGJCV	88
3.	Aktvendime për Ndërrim- korrigjim të emrit mbiemrit personal	191
4.	Aktvendim për refuzim të regji. të mëvonshëm të lindjes në RGJC	00
5.	Aktvendimet për gabime teknike në Prog. sistem si dhe plotësimi i të dhënave në RTHL	63
6.	Aktvendime për refuzimin e ndërrimit të emrit personal	18
7.	Aktvendime për Anulim të regjistrimit të dyfishtë në RGJC	08
8.	Aktvendim për njohjen e vendimit të shtetit të huaj për ndërrimin e emrit personal	04
9.	Aktvendime për refuzim të regji. të mëvonshëm të vdekjes në RGJC	04
Gjithsej aktvendime		405

4. ZYRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE

Gjatë vitit 2024 në Zyrën për Shërbim të Qytetarëve janë kryer këto punë, të cilat do t'i paraqesim në mënyrë tabelore si më poshtë, të dhënat për pranimin e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve drejtuar organeve të Komunës sipas njësive organizative.

Nr. i kërkesave për drejtori

01/01/2024 - 31/12/2024

Nr.	Përshkrimi	Nr. Kërkesave	Përqindja
1	Drejtorja e Administratës së Përgjithshme	78,346	71.00
2	Drejtorja e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë	19,720	18.00
3	Zyra e Kryetarit	2,750	2.00
4	Drejtorja e Arsimit	2,042	1.00
5	Drejtorja e Urbanizmit dhe Mjedisit	1,791	1.00
6	Drejtorja e Bujqësisë	1,663	1.00
7	Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës	1,439	1.00
8	Drejtorja e Financave	615	0.00
9	Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	202	0.00
10	Drejtorja e Infrastrukturës	168	0.00
11	Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizëm	168	0.00
12	Kuvendi Komunal	49	0.00
13	Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	42	0.00
		108,995	

5.SEKTORI I SHËRBIMEVE TË PËRBASHKËTA

Struktura dhe stafi i Sektorit

Sektori për Shërbime të Përgjithshme përbëhet nga pozita specifike, secila me role dhe përgjegjësi të përcaktuara për të siguruar funksionimin efikas të administratës komunale:

- **Zyrtarja për Çështjet e Kuvendit Komunal (1)**
Përgjegjëse për menaxhimin e dokumentacionit dhe procesverbaleve të Kuvendit Komunal, koordinimin e mbledhjeve dhe përgatitjen e materialeve për anëtarët e Kuvendit.
- **Zyrtari për Mbështetje Administrative-Teknike të Kuvendit Komunal (1)**
Ofron mbështetje administrative dhe teknike për Kuvendin, duke ndihmuar në organizimin e takimeve dhe aktiviteteve të tjera të rëndësishme.

- **Zyrtari i Depos (1)**

Menaxhon proceset e furnizimit dhe depon e materialeve, pajisjeve dhe inventarit për nevojat e administratës komunale, duke siguruar mbikëqyrjen dhe shpërndarjen efektive të tyre.

- **Vozitësit(3)**

Sigurojnë shërbime transporti për administratën dhe departamentet komunale, duke garantuar sigurinë dhe mirëmbajtjen e automjeteve në përputhje me standardet dhe legjislacionin.

- **Korrier-Posta(1)**

Merret me shpërndarjen dhe marrjen e dokumenteve dhe dërgesave zyrtare brenda dhe jashtë Komunes, duke kontribuar në përmirësimin e komunikimit institucional.

- **Mirëmbajtësit(2)**

Përgjegjës për mirëmbajtjen e objekteve dhe ambienteve komunale, duke garantuar kushte optimale për punë dhe respektimin e standardeve dhe procedurave të miratuara.

Kjo strukturë siguron organizim dhe funksionim efikas të Sektorit për Shërbime të Përgjithshme, duke mbështetur realizimin e qëllimeve dhe objektivat e Sektorit.

Lëndët e pranuar në Intranet

Shkurtesa	Përshkrimi	Lëndët e pranuar	Lëndë në proces	Lëndët e miratuara	Lëndët e refuzuara	Lëndët e hedhura poshtë	Lëndët e pezulluara
KK Ferizaj	Kuvendi i Komunës Ferizaj	110	0	34	73	1	2

Mbledhjet e mbajtura të Kuvendit Komunal (KK)

- **12 mbledhje të Kuvendit Komunal.**

Për secilën mbledhje:

- 12 Ftesa për mbledhje,
- 12 Lista të nënshkrimeve të anëtarëve,
- 12 Procesverbale.

Të gjitha procesverbalet:

- Janë korrigjuar, dërguar elektronikisht për përkthim dhe, pas përkthimit, janë skanuar dhe publikuar në faqen zyrtare të Komunës.

Mbledhjet e mbajtura të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF)

- **12 mbledhje të KPF-së.**

Për secilën mbledhje:

- 12 Ftesa për mbledhje,
- 12 Lista të nënshkrimeve të anëtarëve,
- 12 Procesverbale.

Të gjitha procesverbalet janë trajtuar dhe publikuar siç përshkruhet më lartë.

Mbledhjet e mbajtura të Komitetit për Komunitete

- **12 mbledhje të Komitetit për Komunitete.**

Për secilën mbledhje:

- 12 Ftesa për mbledhje,
- 12 Lista të nënshkrimeve të anëtarëve,
- 12 Procesverbale.

Të gjitha procesverbalet janë përpunuar dhe publikuar.

Vendimet e Kuvendit Komunal

- **96 vendime të miratuara, të cilat:**

- Janë protokolluar dhe regjistruar në listën e akteve.
- Janë dërguar në MAPL për shqyrtim dhe pas kthimit nga MAPL-ja, janë përpunuar dhe publikuar.

Rregulloret e miratuara

- **2 rregullore të miratuara:**

1. Rregullorja e brendshme për menaxhimin e pasurisë jo financiare.
2. Plotësim-ndryshimi i Rregullores 01. Nr. 23, datë 28.02.2020.

Të gjitha dokumentet për rregullore janë trajtuar sipas procedurave të MAPL-së dhe publikuar.

Proceset shtesë

- Përgatitja dhe dërgimi i materialeve të mbledhjeve të KK-së për:
 - MAPL, Kryetarin, Nënkyetarët, 41 anëtarët e Kuvendit, 11 drejtoritë komunale, mediat dhe faqen zyrtare të komunës.
 - Të gjitha materialet janë dërguar në mënyrë elektronike dhe fizike.
- **Komiteti Konsultativ për Shërbime Sociale për Persona me Aftësi të Kufizuara:**
 - 6 mbledhje të mbajtura, për të cilat janë përgatitur listat e nënshkrimeve.

Statistika e Përdorimit të Veturave Zyrtare

Numri i automjeteve aktive është 20, të cilat monitorohen në mënyrë të vazhdueshme përmes sistemit GPS, duke mundësuar përdorim efikas dhe planifikim të mirë të udhëtimeve. Gjatë vitit 2024, automjetet zyrtare janë shfrytëzuar për një sërë aktiviteteve të rëndësishme, duke përfshirë vizitat zyrtare dhe inspektimet në terren, dorëzimin e materialeve dhe pajisjeve administrative, si dhe mbështetjen e projekteve komunale. Për të siguruar transparencë dhe përgjegjësi, në librin e veçantë për shfrytëzimin e automjeteve zyrtare shënohen emrat e zyrtarëve që i përdorin automjetet, si dhe përshkrimi i detyrave për të cilat janë përdorur.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihni statistikën e përdorimit të veturave zyrtare

Institucioni	Përshkrimi	Kërkesa të pranuara	Anuluar	Miratuar	Total	Viti
Komuna e Ferizajt	Shfrytëzimi i automjeteve zyrtare	1,415	15	1,400	1,415	2024

Shpenzimet e derivateve për automjetet e Komunës së Ferizajt

- Shpenzimet për derivate për automjetet e Komunës së Ferizajt gjatë vitit 2024 janë si më poshtë:

Nr.	Emri i automjetit	Nr. i regjistrimit	Drejtoria	Km. fillim muaji Janar	Km. fund muaj Dhjetor	Km. e kaluara	Shpenzime dizel	% paraparë	Mes. në 100 km.	Vërejtje
1	Kia	05z-04-25	DI	129217	132708	3491	199	5,90%	5,7	
2	Kia	05z-06-25	DSHPE	121894	124373	2479	181	6,00%	7,3	
Struktura gjinore	Viti 2023	Viti 2024
Meshkuj	905	943
Femra	282	309
Gjithsej	1187	1252
Sipas llojit të biznesit	Viti 2023	Viti 2024
SH.P.K.	787	805
B.I.	241	216
SH.A.	1	1
Dega në Kosovë	1	1
O.K	1	0
Gjithsej	1031	1023

Bizneset e ç'regjistruara		
Emërtimet	Viti 2023	Viti 2024
Prodhuese	23	4
Tregtare	29	41
Shërbyese	44	10
Ndërtimore	5	3
Gjithsej	101	58
Struktura gjinore	Viti 2023	Viti 2024
Meshkuj	74	44
Femra	27	14
Gjithsej	101	58
Sipas llojit të biznesit	Viti 2023	Viti 2024
SH.P.K.	17	22
B.I.	83	36
SH.A.		0
Gjithsej	101	58



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E ARSIMIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2024

Afrim Llabjani
Drejt看 i Drejtorisë së Arsimit

HYRJE

Drejtoria e Arsimit, përkundër sfidave të mëdha, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që ka, ka realizuar punë dhe detyra të shumta në funksion të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim dhe krijimit të kushteve më të mira në nivelin e arsimit parauniversitar, ku për vitin shkollor 2023/24, ka bërë një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm mbi ecurinë dhe performancën e procesit edukativo-arsimor, duke e analizuar suksesin e nxënësve për rezultatet dhe sukseset e arritura në të tri nivelet e arsimit parauniversitar, duke krahasuar rezultatet e suksesit me rezultatet e periudhës së njëjtë të vitit paraprak.

Përfundimi i vitit shkollor 2023-2024 është bërë në kushte të rregullta. Ndërsa edhe viti i ri shkollor 2024-2025, ka filluar normalisht.

Drejtoria e Arsimit ka përcjellë nga afër ecurinë e procesit arsimor, duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale nga zyrtarët e arsimit, duke funksionalizuar dhe fuqizuar Aktivitetet profesionale (seksionet), duke bashkëpunuar me institucionet dhe organizata të ndryshme për zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe sigurimin e efikasitetit të procesit të mësimdhënies dhe mësim nxënies dhe njëkohësisht në funksion të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim.

Po ashtu, janë vlerësuar dhe analizuar rezultatet e testeve të jashtme të Provimit Shtetëror të Maturës si dhe Testi i Arritshmërisë për klasat e IX-ta.

Duke ditur se vlerësimi është një proces dhe indikator determinues për nxjerrjen e treguesve kryesor, për ngritjen e cilësisë në arsim dhe për krijimin e një sistemi arsimor bashkëkohor në përputhje me kërkesat e shoqërisë së sotme-shoqërisë së dijes, kjo analizë bëhet jo vetëm për të konstatuar gjendjen, por edhe për të përcaktuar objektivat për të ardhmen, që do të reflektojnë pozitivisht në përmirësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve dhe ngritjen e cilësisë së mësimdhënies në procesin edukativo-arsimor.

Drejtoria e Arsimit po punon në mënyrë të vazhdueshme për krijimin e kushteve më të mira me qëllim që cilësia dhe rezultatet e suksesit në shkollat tona të shënoj progres dhe të arrijnë në nivelin dhe standardin e shkollave të përparuara, si në mësimdhënie, mësim nxënie dhe të një vlerësimi sa më objektiv të arritshmërisë së nxënësve.

Raporti i organizimit të punës së Drejtorisë së Arsimit

Organizmi i punëve në Drejtorinë e Arsimit bëhet përmes sektorëve të saj:

- **Spektori i Administratës**
- **Spektori i Financave**
- **Spektori i Arsimit**
- **Spektori i Shërbimit Teknik**

Qëllimi i raportit vjetor është prezantimi i punës njëvjeçare i të gjitha institucioneve edukativo-arsimore, gjegjësisht paraqitet suksesi, rezultatet, të arriturat, por edhe sfidat dhe vështirësitë që kanë përcjellë shkollat dhe procesin edukativo-arsimor në edukimin para fillor, fillor, të mesëm të ulët dhe mesëm të lartë në Komunën e Ferizajt, për vitin shkollor 2023-2024.

Drejtorja e Arsimit me kohë i ka planifikuar punët që duhet të kryhen dhe u ka kushtuar kujdes të veçantë, sidomos prioritetëve duke bërë përpjekje për shfrytëzim sa më racional të të gjitha resurseve të brendshme dhe të jashtme në shkollat tona.

Në raport janë përfshirë: rrjeti shkollor, lokali mësimor, nxënësit dhe paralelet, organizimi i mësimi, suksesi i nxënësve, mungesat e nxënësve, orët e mbajtura, aktivitetet jashtëkurrikulare etj. Pra, janë përfshirë të gjitha segmentet e punës dhe jetës në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Ferizajt.

Materialet bazë për hartimin e raportit:

- Plani vjetor i punës së DA-it për vitin 2024;
- Raporti vjetor i punës së Sektorëve të Arsimit pranë DA-it për vitin 2024;
- Programet vjetore dhe periodike të punës së njësive pranë DA-së:
- Njësia e Administratës;
- Njësia e Financave;
- Njësia e Shërbimeve Teknike;
- Kalendar i për vitin shkollor 2023-2024;
- Raportet tekstuale dhe tabelore të shkollave fillore dhe të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm i lartë;
- Raportet e organizimit të seminareve me mësimdhënës për zbatimin e KK-së dhe KB për nivelet e arsimit (0,1,2,3);
- Informatat rreth organizimit të Provimit të Maturës;
- Bashkëpunimi i zyrtarëve komunal të arsimit DA-së me SIA-në, dhe organe tjera relevante.

Drejtoria e Arsimit dhe stafi i saj në bashkëpunim me MASHTI-n, drejtoritë e shkollave dhe organet tjera relevante janë angazhuar në krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për punë në shkollat e komunës sonë. Planifikimi me kohë ka mundësuar një fillim të mbarë të procesit edukativo-arsimor.

Drejtoria e Arsimit në përfundim të vitit mësimor, në të gjitha shkollat e komunës sonë, fillon punët në lidhje me përgatitjet e përgjithshme e të nevojshme për vitin e ri shkollor.

Drejtorët e shkollave me kohë kanë marrë udhëzimet e nevojshme për fillimin e punëve në lidhje me përgatitjet të cilat duhet të bëhen sipas dinamikës së paraparë nga Drejtoria e Arsimit.

Përgatitjet janë kryer sipas punëve me prioritet:

- Në përfundim të vitit mësimor, ka filluar me përgatitjet e objekteve shkollore si renovime, lysterje, gëlqerosje, dezinfektime dhe dezinfektime etj;
- Për të siguruar kuadrin e nevojshëm, Njësia Administrative pranë Drejtorisë sonë, me kohë ka bërë përgatitjen dhe shpalljet e konkurseve;
- Me kohë është bërë edhe planifikimi për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore të cilat i ka siguruar MASHTI, për nivelin fillor dhe të mesëm të ulët. Për ndryshim nga vitet e kaluara, këtë vit, furnizimi me libra për nxënës është bërë përmes rimbursimit, me ç ‘rast prindërit, pas pranimit të mjeteve, kanë bërë blerjen e librave për fëmijët e tyre;
- Nga Drejtoria e Arsimit është bërë planifikimi për furnizimin e shkollave me lëndë djegëse dhe material tjetër të nevojshëm shpenzues;
- Gjithashtu me kohë shkollat janë pajisur me dokumentacion pedagogjik si libra amë, ditar të punës, fletore të punës për mësimdhënës, material shkollor e gjëra të tjera të nevojshme;
- Drejtoria e Arsimit, përmes Aktivit të Drejtorëve të Shkollave, kujdes të veçantë i ka kushtuar përfshirjes së të gjithë nxënësve në procesin edukativo-mësimor. Një kujdes të shtuar kemi pasur për nxënësit me nevoja të veçanta. Këtë kategori të nxënësve e kemi përfshirë në gjitha nivelet e arsimit, kurse një numër i tyre (për shkak të nevojave më specifike) janë të përfshirë edhe në dy shkolla fillore në „Gjon Serreçi” dhe në „Ahmet Hoxha”;
- Drejtoria e Arsimit ka themeluar edhe Ekipin Komunal për Vlerësimin e Fëmijëve me Nevoja të Veçanta, Ekipin Komunal për Vlerësim të Brendshëm dhe Ekipin për Parandalim e Braktisjes dhe Mos regjistrim;
- Drejtoria e Arsimit ka planifikuar buxhetin për ndarjen e bursave për studentët e komunës sonë. Edhe për vitin akademik 2023-2024 u ka ndarë bursa të gjithë studentëve që kanë aplikuar si dhe ju kanë vazhduar bursat studentëve vijues.

Me qëllim të mbarëvajtjes së procesit edukativo- arsimor dhe në përgjithësi të punëve nëpër shkolla, Drejtoria e Arsimit, i ka kushtuar kujdes të duhur edhe:

- Planifikimit dhe regjistrimit të fëmijëve në klasat parafillore;
- Planifikimit dhe regjistrimit të nxënësve në klasën e parë;
- Planifikimit dhe regjistrimit të nxënësve në klasën e X-të, në shkollat e arsimit të mesëm të lartë;

Gjatë vitit shkollor 2023-2024, kemi vazhduar me zbatimin e KK-së dhe KB-ve në të gjitha shkollat e Komunës së Ferizajt në të gjitha nivelet e arsimit përveç shkollave profesionale që ende nuk kanë filluar në zbatimin e KK-së.

Drejtoria e Arsimit, me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe disiplinës, ka realizuar vizitat të rregullta dhe informative nëpër shkolla.

Sigurisë në shkolla i është kushtuar rëndësi e duhur, është forcuar bashkëpunimi me Policinë, kemi angazhuar sigurimin fizik kryesisht në shkolla të qytetit, kemi vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me Këshillin e Prindërve si dhe është shtuar kujdestaria e ditës nga nxënësit dhe mësimmshënësit.

Një numër i madh i shkollave janë rinovuar nga brenda, ku është bërë suvatimi, ngjyrosja e shkollave, shtrimi i shumë klasave me linoleum etj. Janë rregulluar shume parkingje të shkollave dhe shtigje për ecje për nxënës. Gjellbërimeve në oborret shkollore i është kushtuar rëndësi e duhur. Në këtë drejtim edhe janë shënuar rezultate. Në disa shkolla janë rregulluar parqet shkollore si dhe janë mbjellë drunjt dekorativ.

Rëndësi e veçantë i kushtohet edhe organizimit të aktiviteteve jashtëkurrikulare, si organizimi i kuizeve nga lëndë të ndryshme të diturisë, garave kulturore, sportive etj.

RAPORTI I PUNËS PËR SEKTORIN ADMINISTRATIV TË DA-së

Spektori Administrativ në Drejtorinë e Arsimit gjatë periudhës për vitin 2023-2024 ka udhëhequr procedurat administrative dhe ligjore për pranimin e mësimmshënësve dhe punëtorëve tjerë në shkolla për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në kuadër të Komunës së Ferizajt.

Gjatë këtij viti shkollor kemi publikuar gjithsej 17 konkurse. Konkursët janë shpallur me kohë duke i respektuar afatet ligjore, ato janë shpallur edhe në faqen zyrtare të komunës si dhe në tabelën e shpalljeve me sa vijon:

- Për mësimmshënës - 12 konkurse
- Për asistente për FNV – 1 konkurs
- Për drejtor të shkollave – 1 konkurs
- Për edukatore - 2 konkurse
- Bursa për studentë – 1 konkurs

Gjithsej 17 konkurse

Janë udhëhequr procedurat e njoftimit të kandidatëve, intervistimit, për pranimin e kandidatëve për plotësimin e vendeve të punës, si në zëvendësime, plotësime etj. Janë zhvilluar procedurat e pushimeve të lehonisë, pushimeve mjekësore, pushimeve pa pagesë dhe të punëtorëve të pensionuar gjatë kësaj periudhe.

Kemi shqyrtuar kërkesa, ankesa, kemi dhënë përgjigje me shkrim sipas shkresave të palëve. Kemi bërë kompletimin e lëndëve për zyrën ligjore sipas padive të palëve për kompensimin e pagave me rastin e pensionimit, për rastet e punësimit.

NJËSIA E FINANCAVE

Ka kryer punët si vijon:

- Përgatitja për raportimin e borxheve për vitin e mëparshëm në kategoritë ekonomike paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, komunal, investime kapitale dhe subvencione.
- Përgatitja për raportimin e pasqyrave financiare për vitin e mëparshëm në kategoritë ekonomike paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, komunal, investime kapitale dhe subvencione.
- Përgatitja e planit të keshit për vitin 2024 në kategoritë ekonomike paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, komunal, investime kapitale.
- Shpërndarja e mjeteve në kategoritë e pagave për arsimin fillor të mesëm, sipas shkollave dhe raportimi i tyre për Ministrinë e Financave.
- Shpërndarja e mjeteve përmes free-balancit për çdo shkollë veç e veç në arsimin fillor të mesëm dhe çerdhen e fëmijëve.
- Kemi bërë shpërndarjen e pagave sipas shkollave, pastaj i kemi futur në free-balance pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, komunalit për vitin 2024.
- Kemi bërë përgatitjen e zotimeve për investime kapitale, përgatitjen e disponueshmërisë së mjeteve, kërkesa për zhvillimin e procedurave të prokurimit.
- Përgatitjen e raportit tremujor për kategorinë e pagave, mallrave dhe shërbimeve, komunalive.
- Rregullimin e retroaktivit për mësimdhënësit që nuk kanë hyrë me kohë në listën e pagave.
- Raporti i borxheve në të gjitha kategoritë ekonomike për Ministrinë e Financave sipas kërkesës së tyre.
- Përgatitja e të dhënave për rishikim të buxhetit në të gjitha kategoritë ekonomike në muajin qershor.
- Përgatitja e të gjitha të dhënave për bursat për studentë dhe pagesat e tyre prej subvencioneve.
- Futja e të dhënave në BDMS në të gjitha kategoritë ekonomike për çdo shkollë veç e veç.
- Përgatitja e investimeve kapitale për ridestitim, sipas programeve të arsimit.
- Përgatitja e listave të pagave për zyrën e thesarit.
- Raportimin e mjeteve të sindikatës.

- Trajnimet e drejtorëve dhe stafit administrativ, sipas nevojave.
- Kemi kryer të gjitha punët që na lidhin me prokurimin, planin e prokurimit, kërkesat për prokurim.
- Bashkëpunimi dhe harmonizimi i punëve me drejtorët e shkollave.
- Raportin e faturave të papaguara për vitin kalendarik 2024.
- Pasqyrat financiare 2024.

NJËSIA E SHËRBIMEVE TEKNIKE

Drejtoria e Arsimit i ka kushtuar rëndësi të veçantë edhe infrastrukturës shkollore dhe duke parë që shkollat në Komunën e Ferizajt kanë nevojë për renovime dhe përkujdesje, gjatë vitit 2024, ka vazhduar me realizimin e projekteve siç janë në vijim:

Ndërtimi i objekteve shkollore nga viti 2024-2025

Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Tërrn, vazhdon faza e dytë;

Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Neredime, vazhdon faza e dytë;

Është bërë përrurimi i ndërtimit të sallës së edukatës fizike në Fshatin e Vjetër,

Është bërë përrurimi i ndërtimit të sallës së edukatës fizike në Fshatin Balaj

Është bërë përrurimi i ndërtimit të sallës së edukatës fizike SHFMU “Astrit Bytyçi” - Ferizaj

Renovimi i brendshëm i shkollave- suvatimi, ngjyrosja, vendosja e perdeve dhe shtrimi i linoleumit në shkollat: “Muharrem Shemsedini”, “4 Prilli”, “Ramadan Rexhepi”, “Imri Halili”, “Enver Topalli”, “Mic Sokoli”, “Visar Dodani”, “Imri Halili”, “Pjetër Bogdani”, “Vezir Jashari”, “Liman Rekaj”, “Arsim Rexhepi”, “Naim Frashëri” (PNF në Doganaj), “Kuvendi i Arbërit”, “Riza Matoshi”, “Tefik Çanga”, “Jeronim de Rada”, “Gjon Serreçi” (funksionalizimi i aneksit);

Rregullimi i parkingut, trotuareve dhe shtigjeve për këmbësorë në shkollat: “Mic Sokoli”, “4 Prilli”, “Muharrem Shemsedini”, “Dituria”, “Ramadan Rexhepi”, “Ali Hadri”, “Liman Rekaj”, “Hajriz Muhadini”, Gjimnazi “Kuvendi i Arbërit”, “Pjetër Bogdani”, “Arsim Rexhepi”, “Visar Dodani”, “Abetarja”.

Punë të tjera:

- Riparimi i kulmit në SHFMU “Abetarja” PNF në Pojatë dhe në SHFMU “Afrim Abazi” në Sherret;
- Vazhdimi i punimeve në Çerdhen e Fëmijëve në rrugën “Rexhep Bislimi”;
- Në shkollën "Jeronim de Rada" në Ferizaj, është bërë drenazhimi komplet i shkollës, renovimi dhe suvatimi i bodrumit dhe disa klasave, si dhe asfaltimi i fushës së futbollit dhe volejbollit;
- Asfaltimi i fushës së futbollit dhe volejbollit në shkollën “Besim Rexhepi” në Komogllavë;
- Nga CARITAS Zvicëran, janë pajisur me mjete didaktike dhe inventarë 5 klasë parafillore.

SEKTORI I ARSIMIT

Në kuadër të sektorit të arsimit aktivitetin e tyre e zhvillojnë:

Zyrtari për arsimin parafillor dhe fillor
Zyrtari për arsimin e mesëm të ulët, dhe
Zyrtari për arsimin e mesëm të lartë.

Zyrtarët arsimor, i kanë kushtuar kujdes të duhur këtyre punëve:

- Kanë përcjellë dhe mbikëqyrur përgatitjet e gjithmbarshme të shkollave në kuadër të procesit edukativo-arsimor, janë angazhuar që të bëhet përfshirja e nxënësve në shkollimin e rregullt, kemi kontribuar në ngritjen e bashkëpunimit të shkollës me prindër dhe komunitetin në përgjithësi;
- Bashkëpunojnë me Shoqatën e Matematikentëve, Fizikentëve, Shoqatën e Gjuhës Shqipe si dhe Shoqatën e Kulturës Sportive në organizimin e garave në lëmit përkatëse;
- Në muajin gusht kanë pranuar dhe shpërndarë tekstet shkollore në të gjitha shkollat e komunës sonë, si dhe kemi vazhduar edhe me pjesën tjetër të teksteve të ardhura më vonë nga shtëpitë tjera botuese. Nga kontaktet që kemi pasur me shkolla mund të konkludojmë se të gjitha shkollat janë furnizuar me libra.
- Është bërë vlerësimi pedagogjik i mbi 20 fëmijëve me nevoja të veçanta, përmes Ekipit Vlerësues;
- Zyrtarët arsimor në kuadër të punëve dhe detyrave të tyre të punës për çdo gjysmë vjetor, janë marrë me grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore për suksesin e nxënësve, vijueshmërinë, disiplinën etj.;
- Zyrtarët arsimor gjatë vitit 2024 kanë bërë vizita në të gjitha shkollat, me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe disiplinës. Gjatë këtyre vizitave është përcjellë respektimi i orarit mësimor, realizimi i plan programeve, notimi i nxënësve, kontrollimi i dokumentacionit administrativ, pedagogjik, stafit arsimor, teknik si dhe zhvillimi i aktiviteteve tjera kurrikulare dhe jashtëkurrikulare;
- Janë dhënë udhëzime lidhur me organizmin e mbajtjes të Testit Kombëtar për klasat e IX-ta dhe të Testit të Maturës për klasat e XII-ta;
- Zyrtarët arsimor kanë bërë të gjitha përgatitjet për realizimin e testit, si dhe kanë marrë pjesë në mbarëvajtjen e Testit;
- Zyrtarët arsimor, kanë shqyrtuar konkuret e shpallura për pranimin e kuadrit arsimor, udhëheqës, teknik dhe punëtor administrativ, kanë bërë vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve;
- Koordinimi dhe përcjellja e të gjitha trajnimeve që realizohen në Qendrën për Ngritjen Profesionale (QNP) në shkollën “Tefik Çanga”, për të gjitha nivelet (0,1,2,3);
- Është hartuar plani i përcjelljes së trajnimeve për zbatim të KK dhe KB (Kurrikulës dhe Kurrikulës Bërthamë);
- Janë hartuar raporte mujore me shkrim lidhur me zbatimin e KKK-së dhe KB-ve në të gjitha shkollat e Komunës së Ferizajt, raportet janë dërguar në MASHTI;

Po ashtu, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të stafit arsimor në shkolla përmes zhvillimit profesional, DA në bashkëpunim me MASHTI-n dhe organizata të akredituara ka organizuar trajnime, seminare e punëtori.

DA në bashkëpunim me Caritas Zvicëran përmes projektit "TAKE" ka furnizuar me inventarë 5 (pesë) klasë parafillore. Me CARITAS zvicëran, kemi nënshkruar edhe një marrëveshje bashkëpunimi tre vjeçare që ka të bëjë edhe me projekte të radhës në vitet në vazhdim.

Trajnimet e mësimdhënësve

- Trajnimi i stafit arsimor për zbatimin e Kurrikulës i paraparë gjatë muajit korrik 2024 është realizuar nga Drejtoria e Arsimit ku ka angazhuar trajnerë nga Ferizaj dhe me shumë sukses trajnimin e kanë ndjekur mbi 60 mësimdhënësve në fushat kurrikulare.
- Përmes OJQ "TOKA" janë trajnuar dhe certifikuar 25 mësimdhënës.
- SHB "ALBAS" ka trajnuar dhe certifikuar 125 mësimdhënës.
- Përmes programit KOSED janë trajnuar mësimdhënësit e 6 shkollave.

Zhvillimi i procesit mësimor

Viti i ri shkollor ka filluar me 2 shtator. Shkollat me kohë kanë bërë të gjitha përgatitjet në aspektin teknik dhe kompletimin e dokumentacionit pedagogjik. Të gjitha shkollat janë pajisur me mjete higjienike, është bërë me kohë dezinfektimi dhe dezinfektimi i të gjitha objekteve shkollore si dhe është bërë vlerësimi higjienik edhe nga Inspektorati Sanitar. Gjetjet e tyre kanë konstatuar se shkollat plotësojnë kushtet teknike për fillimin e vitit të ri shkollor.

Sfidë për DKA-në gjatë këtij viti shkollor ishte edhe më tutje zhvillimi i procesit mësimor në tri ndërrime në shkollën "Dy Dëshmorët" në Talinoc.

NJËSIA E ARSIMIT PARAFILLOR

Në komunën tonë funksionojnë dy çerdhe të fëmijëve. IP “Ardhmëria Jonë”, si çerdhe publike, dhe Çerdhja “Engjujt”.

Viti shkollor 2023-2024

Në institucionet parashkollore janë regjistruar:

Grup mosha	Numri i grupeve	Gjithsej numri i fëmijëve		
		M	F	Gj
06 muaj – 2 vjeç	3	20	18	38
1 vjeç – 2 vjeç	0	0	0	0
2 vjeç – 3 vjeç	5	49	52	101
3 vjeç – 4 vjeç	4	49	49	98
4 vjeç – 5 vjeç	5	53	71	124
5 vjeç – 6 vjeç	5	58	55	113
Gjithsej	22	229	245	474

Numri i fëmijëve të regjistruar në klasat parafillore Viti shkollor 2023 – 2024

Numri i fëmijëve në klasat parafillore	M	F	GJ
	682	696	1378

Numri i nxënësve të regjistruar klasa 1 - 5 Viti shkollor 2023 – 2024

Numri i nxënësve klasa 1 – 5	M	F	GJ
	4147	3998	8145

Numri i nxënësve të regjistruar klasa 6 - 9
Viti shkollor 2023 – 2024

Numri i nxënësve klasa 6 – 9	M	F	GJ
	3280	3181	6461

Numri i nxënësve të regjistruar klasa 10 - 12
Viti shkollor 2023 – 2024

Numri i nxënësve klasa 10 – 12	M	F	GJ
	2534	2617	5151

Numri i përgjithshëm i nxënësve 0 -12
Viti shkollor 2023 – 2024

Numri i nxënësve klasa 0 – 12	M	F	GJ
	10643	10492	21135

Rezultatet e Testit të Arritshmërisë Klasa IX-të
Viti shkollor 2023 – 2024

Nr.	Shkolla	Kodi	Numri i paraleleve	Numri i nxënësve që kanë hyrë në test	Totali		
					Pikët e arritura	%	Maksimumi i pikëve të arritura
1	"Gjon Serreçi"	1	9	213	21255	49.89	42600
2	"Jeronim de Rada"	2	6	132	13614	51.56	26400
3	"Tefik Çanga"	3	5	157	15024	47.84	31400
4	"Ahmet Hoxha"	4	5	100	9535	47.67	20000
5	"Ganimete Tërbeshi"	5	4	70	7081	50.57	14000
6	"Vezir Jashari"	6	3	69	6758	48.97	13800
7	"Bilall Shala"	7	2	26	2254	43.34	5200
8	"Jeta e Re"	8	2	41	3594	43.82	8200
9	"Kostandin Kristoforidhi"	9	2	27	2217	41.05	5400
10	"Naim Frashëri"	10	3	39	3301	42.32	7800
11	"Dituria"	11	2	23	2099	45.63	4600
12	"Besim Rexhepi"	12	3	56	5305	47.36	11200
13	"Imri Halili"	13	2	36	3022	41.97	7200
14	"Abetarja"	14	1	25	1984	39.68	5000
15	"Muharrem Shemsedini"	15	2	55	5239	47.62	11000
16	"Visar Dodani"	16	2	23	2135	46.41	4600
17	"Dëshmorët e Koshares"	17	2	29	2728	47.03	5800
18	"Ismail Qemali"	18	1	20	1874	46.85	4000
19	"Liman Rekaj"	19	2	20	1751	43.77	4000
20	"Ramadan Rexhepi"	20	1	28	2164	38.64	5600
21	"Ali Hadri"	21	1	36	2939	40.81	7200
22	"Skënderbeu"	22	1	3	314	52.33	600
23	"Halit Ibishi"	23	1	19	1678	44.15	3800
24	"Dardania"	24	1	19	1731	45.55	3800
25	"Mic Sokoli"	25	1	15	1208	40.26	3000
26	"Tërrn"	26	1	14	1160	41.42	2800
27	"Pesë Dëshmorët e UÇK-së"	27	1	34	3126	45.97	6800
28	"Dëshmorët e Lirisë"	28	1	29	2439	42.05	5800
29	"Kemajl Hetemi"	29	1	11	870	39.54	2200
30	"Dy Dëshmorët"	30	2	29	2558	44.10	5800
31	"Mejdi Xhaferi"	31	2	17	1623	47.73	3400
32	"Pavarësia"	32	1	19	2084	54.84	3800
33	"Astrit Bytyçi"	33	3	56	5152	46.00	11200
34	"4 Prilli"	34	1	18	1314	36.50	3600
35	"Hajriz Muhadini"	35	1	16	1286	40.18	3200
36	"Afrim Abazi"	36	1	19	1833	48.23	3800
37	"Rizah Matoshi"	37	1	23	2370	51.52	4600
38	"Enver Topalli"	38	1	22	1891	42.97	4400
39	"Arsim Rexhepi"	39	1	14	1209	43.17	2800
40	"Aga Xhite"	40	1	13	1265	48.65	2600
G j i t h s e j			83	1615	150984	46.74	323000

Krahasuar me vitin e kaluar shkollor 2022-2023, suksesi është më i lartë 0.17 %

PROVIMI I MATURËS – Afati i Qershorit
Viti shkollor 2023-2024

Shkollat	Nr.i nxënësve	Pozitiv	%	Negativ	%
"K.Arbërit"	462	390	84.4	72	15.6
"F.Konica"	242	77	31.8	165	68.2
"P.Bogdani"	50	26	52	24	48
"Z.Hajdini"	56	16	28.6	40	71.4
"E.Gjika"	240	202	84.2	38	15.8
"Çesk Zadeja"	33	17	51.5	16	48.5
"Dr.Sh.Hashani"	291	150	51.5	141	48.45
"Kompetencës"	150	125	83.3	25	16.7
"Aga Xhite"	19	13	68.4	6	31.6
G j i t h s e j	1543	1016	65.8	527	34.2

Krahasuar me vitin e kaluar shkollor 2022-2023, në këtë vit shkollor, kalueshmëria është më e ulët për 1.2%.

PROVIMI I MATURËS – Afati i Gushtit
Viti shkollor 2023-2024

Shkollat	Nr. i nxënësve	Pozitiv	%	Negativ	%
"Kuvendi i Arbërit"	64	48	75	16	25
"Faik Konica"	81	56	69.13	25	30.86
"Pjetër Bogdani"	22	8	36.36	14	63.63
"Zenel Hajdini"	28	10	35.71	18	64.28
"Elena Gjika"	52	30	57.69	22	42.3
"Çesk Zadeja"	15	6	40	9	60
"Dr. Shaban Hashani"	103	60	58.25	43	41.74
"Qendra e Kompetencës"	28	27	96.42	1	3.57
"Aga Xhite"	4	2	50	2	50
G j i t h s e j	397	247	62.21	150	37.78

Krahasuar me vitin e kaluar 2022-2023, në këtë vit shkollor, kalueshmëria është më e lartë për 7.87 %.

Përfundim

Përkundër sfidave dhe peripecive të shfaqura në shumë dimensione që është duke u ballafaquar arsimi në Republikën e Kosovës, ku ende nuk po mund të arrijmë një standard të dëshiruar që garanton zhvillim, përparim dhe stabilitet të qëndrueshëm, Drejtoria e Arsimit, pas vlerësimit dhe analizës së përgjithshme mbi rezultatet e arritura nga nxënësit në tri nivelet e arsimit parauniversitar gjatë vitit shkollor 2023/2024, si dhe zhvillimeve të përgjithshme të ecursisë së procesit edukativo-arsimor, konstatojmë se në këtë vit shkollor ka zhvillime dhe përmirësime të kënaqshme të rezultateve dhe suksesit të nxënësve në komunën e tonë. Kjo është si rezultat i masave dhe veprimeve konkrete të ndërmarra nga Drejtoria e Arsimit, në shumë dimensione në funksion të përmirësimit dhe ngritjes së cilësisë në arsim.

Drejtoria e Arsimit po punon në vazhdimësi me të gjithë kapacitetin, duke bashkëpunuar edhe me institucionet relevante përgjegjëse të arsimit, që në komunën tonë të ndërtohet një infrastrukturë shkollore e nivelit bashkëkohor, duke krijuar kushte optimale që në shkollat tona të ngritët cilësia në arsim.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2024

Xhemile Murati Shabani
Drejtore e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit

HYRJE

Gjatë vitit 2024, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka funksionuar sipas planeve paraprahe në të gjithë sektorët e saj.

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është dikaster që funksionon në kuadër të Komunës së Ferizajt, me detyra, funksione dhe përgjegjësi institucionale, duke ushtruar punë menaxhuese, krijuese e organizative në këto fusha: kulturë, rini, sport, biblioteka dhe në atë të arkivit. Në kuadër të DKRS-së, funksionojnë këta sektorë dhe njësi: Sektori i Kulturës, Teatri i Qytetit, Galeria e Arteve, Muzeu i Qytetit, Sektori i Rinisë, Sektori i Bibliotekave, Sektori i Sportit, Arkivi Historik.

Kjo Drejtori ka nën menaxhim disa objekte ku zhvillon punën dhe aktivitetet e saj. Këto janë: Teatri i Qytetit /Galeria/Muzeu, Palestra e Sporteve, Stadiumi i Qytetit, fusha sportive në fshatin Tërrn, Biblioteka e Qytetit, Arkivi Historik.

Përveç këtyre objekteve, aktivitetet zhvillohen edhe në hapësira tjera publike si: Bulevardi i Qytetit, Sheshi i Qytetit, Skena Verore e Teatrit etj.

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – Ferizaj, bazuar në rregulloren e MF-së, publikon thirrjen publike, ku fton të gjitha organizatat që të aplikojnë në këtë thirrje, si mundësi për financim të projekteve.

Mbështetëm botimin e 14 veprave, kryesisht vepra letrare dhe monografike.

Në vazhdim paraqesim raportin e punës nga secili sektor veç e veç, ku janë të përfshira aktivitetet kryesore.

I. SEKTORI I KULTURËS

Sektori i Kulturës është një nga katër dikasteret që funksionojnë në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Ferizaj. Ky sektor organizon aktivitete kulturore të përbashkëta e të ndara, me grupet kulturore e komunitetin artistik, aktivitete të tjera që kërkohen nga institucionet komunale, si dhe propozime nga faktorë të jashtëm. Këto aktivitete shtrihen gjatë punës njëvjeçare duke iu përmbajtur planit të punës të përpiluar në fillim vit e në të shumtën e rasteve duke tejkaluar këtë plan me aktivitete shtesë.

Në raportin në vijim i gjeni aktivitetet e realizuara nga ky sektor me njësitë e tij, aktivitetet e zhvilluara nën përkujdesjen e këtij sektori, si dhe aktivitetet nga grupet kulturore që veprojnë në partneritet me të. Meqë është gati një natyrë e aktiviteteve dhe që realizohen nga i njëjti staf, në disa pjesë të raportit mund të gjenden të përfshira të gjitha njësitë apo edhe aktivitetet e ritheksuara.

Në kuadër të Sektorit të Kulturës funksionojnë këto njësi:

- **Njësia e Kulturës**
- **Galeria e Arteve**
- **Njësia e Muzeut**
- **Teatri**

Fillimi i vitit zakonisht është periudha kur bëhen rishikimet, analizat, raportet e punës, takime punuese dhe ato të ndarjeve të detyrave sipas llojit të aktivitetit. Por gjithsesi nuk mungojnë edhe aktivitetet e kohëpaskohshme.

Projektet janë kryesisht në bashkëpunim me grupet kulturore, respektivisht me organizatat jo qeveritare me karakter kulturor. Gjatë muajit Janar u dorëzuan raportet e punës të vitit paraprak në formë vizuale dhe tekstuale. Po ashtu, u shpalosën planet për aktivitetet e gjashtëmujorit të parë, e sidomos ato që organizohen në vigjilje të Festës së Pavarësisë.

Në muajin Janar u publikua repertori i shfaqjeve teatrore të Teatrit “Adriana”, u realizuan disa aktivitete publicistike e letrare në Bibliotekën e Qytetit, krahas vizitave të shumta në Muzeun e Qytetit dhe në Galerinë e Arteve. Këto vizita ishin kryesisht nga grupet e organizuara, si shkollat fillore, grupe studentore, mysafirë etj. Për vizitë në muzeun e qytetit ishin nxënësit e SHFMU “Ganimete Tërbeshi” nga Ferizaj, të cilët u informuan me vlerat e trashëgimisë kulturore që posedon treva e Ferizajt; pastaj nxënësit e SHFMU “Dëshmorët e Lirisë” nga fshati Manastirc, etj. Në vazhden e diskutimeve për krijimin e mundësive që Muzeu i Qytetit në vazhdimësi të pasurohet me artefakte, pati edhe takime me koleksionistë dhe dashamirë të trashëgimisë kulturore të Ferizajt, si dhe vizita në disa lokalitete dhe monumente të trashëgimisë kulturore të Ferizajt.

Në Galerinë e Arteve disa ditë me radhë ishte e hapur ekspozita e Bienalit të Skulpturës, nga viti paraprak. Ndërsa në mediat e shtypura dhe ato elektronike u prezantua dhe u promovua puna e Njesisë së Muzeut dhe Trashëgimisë Kulturore.

Vlen të theksohet se vizita të tilla nga grupe të vizitorëve në Muze dhe Galeri, vazhdojnë për gjatë gjithë vitit, varësisht nga organizimet dhe aranzhimet paraprake.

Ndonëse edhe gjatë muajit Shkurt vazhdoi ritmi i aktiviteteve, vizitave, takimeve me grupe kulturore, prezantimeve mediale etj., gjithsesi fokusi kryesor ishte te përgatitjet e aktiviteteve kushtuar përvjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Pas shumë takimeve e sugjerimeve, në fund u publikua tabela me aktivitetet e manifestimit kushtuar kësaj ngjarjeje të rëndësishme historike. Aktivitetet e ndryshme nga të gjitha fushat filluan që nga data 12 shkurt, për të vazhduar çdo ditë me nga dy aktivitete deri më 17 shkurt, kur u mbajtën tri aktivitete me të cilat edhe u përmbyll manifestimi.

Vlen të theksohet se të gjitha aktivitetet e përvjetorit të gjashtëmbëdhjetë të Pavarësisë së Kosovës janë mbajtur nën përkujdesjen e Kryetarit të Komunës.

Tabela 1. Aktivitetet për Ditën e Pavarësisë

12 shkurt	VULLNETARI I VITIT Aktivitet promovues nga Sektori i Rinisë	Galeria e Arteve
13 shkurt	PROMOVIM LIBRI “Epitafet në gjuhën osmane në Regjionin e Ferizajt – deshifrimi dhe përkthimi i tyre”	Galeria e Arteve
	SPORTISTI I VITIT Ceremonia zyrtare nga Sektori i Sportit	Teatri i Qytetit
14 shkurt	PROMOVIM LIBRI “Ferizaj në dokumentet osmane 1873-1912” - Ibrahim Gashi & Ayten Ardel	Galeria e Arteve
	PROGRAM ARTISTIK PËR TË RINJ Nxënësit e Gjimnazit “Kuvendi i Arbërit”	Teatri i Qytetit
15 shkurt	MBRËMJE FILMI Kuvendi i të Rinjve - Ferizaj	Galeria e Arteve
	SHFAQJE TEATRORE “Gënjeshitari”	Teatri i Qytetit
16 shkurt	AKTIVITETE NË BIBLIOTEKË • Zgjedhja e Lexuesit të Vitit • Ekspozitë me artikuj të gazetave të Pavarësisë	Biblioteka e Qytetit
17 shkurt	HOMAZHE	Varrezat e Dëshmorëve
	AKADEMI SOLEMNE / KONCERT Grupi i Arbëreshëve “Kreshnikët e Lirisë”	Teatri i Qytetit
	EKSPOZITA E PAVARËSISË Galeria e Arteve & SHAF “Zef Kolombi”	Galeria e Arteve

Nga kjo tabelë e ngjeshur me shumë aktivitete, gjithsesi do të veçonim dy më të rëndësishmet që e karakterizuan këtë herë Festën e Pavarësisë:

- Prezantimi i grupit të arbëreshëve “Kreshnikët e Lirisë” nga Kalabria që kishin përgatitur një program special për Ditën e Pavarësisë në Ferizaj dhe
- Ekspozita kolektive e Pavarësisë, ku fitues i Çmimit “Gursel Sylejmani” ishte piktori Xhevdet Pantina.

Festivali i Teatrove për Fëmijë - Është festivali i parë i këtij lloji në qytetin tonë. Edicioni i parë i organizuar këtë vit sinjalizoi se do të ketë një rrugëtim të mirë, duke u nisur nga serioziteti i organizimit dhe profesionalizmi i përgatitjeve. Pjesëmarrës në këtë edicion ishin trupa nga Kosova dhe nga Shkupi, ndërsa shfaqjet u dhanë edhe në qendrat e tjera të Regjionit të Ferizajt, si në: Shtime, Han i Elezit dhe Kaçanik, me disa repriza. Edicioni i këtij viti u realizua me shfaqjet në vazhdim:

- “Petrushi i Huaj” - Teatri i Gjilanit
- “Ela, Mira dhe Shtëpia Magjike” - Ferizaj
- “Përralla Palidhje” - Teatri Dodona
- “Kësulëkuqja” - Ferizaj
- “Krahët e Bletës” - Teatri “Avdush Hasani” Podujevë
- “Shpresa e Presa” - OJQ “DUA” Prishtinë
- “Libri Magjik” - Ferizaj

Festivali nuk ishte garues, ndërsa shfaqjet u dhanë me disa repriza. Po ashtu në kuadër të këtij festivali u organizua edhe kuizi i ditorisë për fëmijë, me tematikë nga teatri, ku morën pjesë shkollat fillore: “Ahmet Hoxha”, “Gjon Serreçi”, “Tefik Çanga” dhe “Vezir Jashari”.

7 Mars – Dita e Mësuesit - Sektori i Kulturës me këtë rast organizoi një koncert me grupin e mandolinistëve “Nostalgjikët”, që prezantuan me një program të përzgjedhur artistik.

Koloni artistike për 8 Mars - Galeria e Arteve në bashkëpunim me SHAF “Zef Kolombi”, tanimë e kanë bërë traditë që në çdo 8 mars të organizojnë një koloni artistike me gratë dhe vajzat piktores. Aktiviteti kishte karakter festiv, por edhe promovues dhe sensibilizues.

21 Marsi – Dita e Poezisë – Është datë që i mbledh poetët dhe dashamirët e fjalës së bukur. Çdo herë në këtë datë, Klubi Letrar “De Rada” organizon një takim të tillë, ku mblidhen poetët dhe adhuruesit e poezisë që të lexojnë vargjet e tyre të preferuara.

Aktivitet kushtuar mësuesit Maliq Luzha - Nën organizimin e radios në mërgatë “Zëri i Arbërit” dhe në mbështetje të një klase intelektuale dhe Sektorit të Kulturës, u organizua një aktivitet mirënjohës për punën shumëvjeçare të mësuesit Maliq Luzha, si intelektual dhe edukator.

Promovimi i librit “Për Sulejman Krasniqin” - Në vazhden e aktiviteteve të organizuara nga Klubi Letrar “De Rada” – Ferizaj, u promovua libri “Për Sulejman Krasniqin”, në bashkëpunim me Lidhjen e Shkrimtarëve të Kosovës.

Akademi përkujtimore për Gafurr Limanin - Në sallën e Teatrit “Adriana” u mbajt akademi përkujtimore për ish-luftëtarin e UÇK-së Gafurr Limanin, me rastin e pesë vjetorit të ndarjes nga jeta. Gafurri ishte edhe pjesë e stafit punonjës të Sektorit të Kulturës, andaj e kujtuan edhe kolegët me nder e krenari.

Shfaqje premierë në Ferizaj - Në sallën e Teatrit “Adriana” në Ferizaj, u dha premiera e radhës “*Fluturimi mbi folenë e qyqes*” e autorit Dale Uasserman në regji të Erson Zymberit.

23 prill - Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Librit, Klubi Letrar “De Rada” organizoi një takim me shkrimtarin e njohur nga Kosova, me përmasa botërore Ag Apolloni. Në qendër të bisedës ishin veprat e tij "Një fije shprese, një fije shkrepëse" dhe “Kësulëkuja përrallë për të rritur", por u fol edhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me librin dhe letërsinë. Për bashkëpunimin me Klubin "De Rada" dhe me Ferizajn, Ag Apolloni u nderua me mirënjohje nga DKRS - Ferizaj.

Arti ynë tejkalon kufizimet - Koloni artistike e organizuar nga HANDIKOS e udhëhequr nga piktorja Pranvera Sylejmani. Aktivitet nga fusha e artit pamor, i cili u organizua në Galerinë e Arteve.

Promovimi i librit “Po qe se mendon si unë” nga autorja Blerta Tmava- Veselaj

Në sallën e Galerisë së Arteve, në prezencë të shumë dashamirëve të librit, studiues e mysafirë të tjerë, u promovua libri më i ri me poezi nga Blerta Tmava- Veselaj.

Kolonia Letrare “Muzat e Jezercit” - Tani tradicionalisht Klubi Letrar “De Rada” – Ferizaj, organizon koloninë letrare “Muzat e Jezercit” në pjesëmarrje me poetë të ndryshëm nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut etj. Edicioni i këtij viti ishte i shtati me radhë dhe në kuadër të tij u organizuan orë letrare, tryeza shkencore dhe debate, gjatë tri ditëve në Ferizaj e Jezerc. Ky edicion iu dedikua 210 vjetorit të lindjes së Jeronim de Radës dhe 100 vjetorit të lindjes së studiuesit Jup Kastrati.

Ferfilm Festival - edicioni i 12-të - Festivali Ferfilm, viteve të fundit e ka datën dhe kohën e pandryshueshme të organizmit. Sivjet u realizua edicioni i 12-të me radhë, ku morën pjesë artistë nga vende të ndryshme të botës. Më 6 maj ishte nata e fundit e festivalit, ku u ndanë edhe çmimet për fituesit:

- FILMI MË I MIRË I LUAJTUR\ BEST SHORT FILM “Marko” Marko Šantić (Croatia)
- ANIMACIONI MË I MIRË\ BEST ANIMATION “Looped” Thomas cfreté (Sveeden)
- EKSPERIMENTAL MË I MIRË\ BEST EXP “The unspeakable” Vita Solis (Mexico)
- DOKUMENTARI MË I MIRË\ BEST DOCUMENTARY “I uon’t remain alone” J.Talebi (Iran)
- ÇMIMI SPECIAL I \ SPECIAL MENTION I “Illusion” Mustafa Sancak (Turkey)
- ÇMIMI SPECIAL II SPECIAL MENTION II “The Junction” Xhelal Haliti (Kosova)
- Klubi i Gazetarëve “Haki Braha”, ndau çmimin: MEDIA PRIZE për “Holy Care” Cristian Patane.

Dy premiera teatrore - Teatri “Adriana” gjatë muajit maj, realizoi dy premiera teatrore:

- “Katër Trëndafilat” – Julia Cameron; regjia Erleta Rexhepi;
- Stand Up Comedy: nga Fisnik Çerkini

Ansambli “Kastriotët” në Festivalin “Hasi jehon” - Ansambli “Kastriotët” ishte pjesë e festivalit folklorik “Hasi Jehon”, ku përveç pjesëmarrjes, ata u kthyen me mirënjohje e shpërblime. Vlen të theksohet se Ansambli “Kastriotët” (grupi i folklorit), është pjesë e shumë festivaleve folklorike në Kosovë dhe kudo që prezantohet merr çmimet e shpërblimet e para.

Diamond Fest- Edicioni i 11-të - Në këtë skenë magjike u ngjitën 30 fëmijë nga Kosova, Shqipëria dhe nga Maqedonia e Veriut. Fituesja e festivalit u shpall Sohejla Misini nga Vitia. Vendi i Parë Junior iu nda Lis Zenelit nga Shkupi. Mysafire speciale ishin aktorja turke Ömrüm Nür Çamçakalli si dhe Grejsi Lita nga Tirana.

Mural Fest 31 maj- Filloi Festivali Mural Fest Kosova - Në një ceremoni solemne, në qendër të qytetit, u bë hapja e edicionit të nëntë të Festivalit Mural Fest Kosova, **31 maj - 07 qershor**. Gjatë këtyre tetë ditëve grupi i festivalit, realizoi disa murale, punëtori, aktivitete nga fusha e artit pamor, ekspozitë etj. Kujtojmë se Mural Fest Kosova ka aktivitete gjatë gjithë vitit, brenda dhe jashtë Ferizajt.

Ditët e Kulturës- Ferizaj 2024 - “Ditët e Kulturës” është manifestim tradicional kulturor që organizon çdo vit Sektori i Kulturës, në kuadër të DKRS-së. Zakonisht, tabela e prezantimit të aktiviteteve të këtij manifestimi përfshinë afro njëzet aktivitete të ndryshme.

Për vitin 2024 hapja e manifestimit u bë me një program për fëmijë, që u ndoq nga një varg aktiviteteve të tjera, për të përfunduar pastaj në ditën e 12 Qershorit me aktivitetet qendrore të “Ditës së Çlirimit”. Të gjitha aktivitetet e 25 vjetorit të çlirimit të qytetit tonë janë mbajtur nën përkujdesjen e Kryetarit të Komunës.

Në tabelën e mëposhtme, të ngjeshur me shumë aktivitete, vërehet shumëllojshmëria e aktiviteteve të organizuara që harmonizohen me shijet e të gjitha shtresave dhe grup moshave të popullatës ferizajase, duke filluar nga fëmijët e deri te më të moshuarit.

Këto aktivitete, si gjithmonë edhe gjatë vitit 2024 i dhanë ngjyra solemne dhe shfaqën madhështinë e kësaj date të rëndësishme kombëtare.

Tabela 2. Aktivitetet për 25 vjetorin e Çlirimit

1 qershor	DITA NDËRKOMBËTARE E FËMIJËVE Prezantim ekspozues për fëmijë: Policia e Kosovës, FSK, Emergjencat, Zjarrfikësit, KFOR, grupe të fëmijëve, HANDIKOS etj.	Sheshi i Qytetit
	SHFAQJE TEATRORE PËR FËMIJË “Libri magjik”	Teatri i Qytetit
	KONCERT PËR FËMIJË Grupi “Kromatika”	Galeria e Arteve
2 qershor	EKSPOZITË ME FOTOGRAFI – HER SPOTLIGHT Arbesa Musa (Mural Fest)	Galeria e Arteve
3 qershor	SHFAQJE E SHKOLLAVE FILLORE SHFMU “Gjon Serreçi”	Teatri i Qytetit
4 qershor	SOFRA TRADICIONALE AKV “Kastriotët”	Sheshi i Qytetit
5 qershor	STORIE SUKSESI Prezantim i një artisti të ri (Sektori i Rinisë)	Shkolla e Arteve
8 qershor	FERIZAJ CODEFEST Shkolla digjitale	Teatri i Qytetit
	PROMOVIM LIBRI “Shtegtime nëpër atdhe” – Berat Luzha organizim i KL “De Rada”	Galeria e Arteve
	MANIFESTIM KULTUROR Dita e shkollës së arteve “Çesk Zadeja”	Shkolla e Arteve
	SHFAQJE TEATRORE “Katër trëndafilat” - Teatri “Adriana” Ferizaj	Teatri i Qytetit
9 qershor	FESTIVALI PIANO FEST – Edicioni i V-të Garat pianistike	Galeria e Arteve
10 qershor	FESTIVALI PIANO FEST – Edicioni i V-të Nata finale	Galeria e Arteve
	EKSPOZITË ME FOTOGRAFI – 25 VJETORI I ÇLIRIMIT Zyra për Trashëgimi dhe Muzeu	Sheshi i Qytetit
11 qershor	EKSPOZITË KOLEKTIVE E ARTIT PAMOR Galeria e Arteve & SHFA “Zef Kolombi”	Galeria e Arteve
12 qershor	DITA E ÇLIRIMIT	//

12 Qershori – Dita e Çlirimit - Në kuadër të kësaj date të veçantë, u organizuan disa aktivitete në nderim të kësaj dite: Në fshatin Koshare u bë shpalosja e shtatores së Dëshmorit të Kombit, Besim Fazliu u prezantua edhe një program artistik nga Okteti i Qytetit, Milaim Mezini e Skender Shabani.

Ekspozita e grave veterane të UÇK-së - Në hapësirën e Shkollës së Arteve “Çesk Zadeja” u bë hapja e ekspozitës me fotografi nga gratë dhe vajzat veterane të UÇK-së, me fotografi të ruajtura nga lufta.

Ekspozitë- sllajd nga Hazir Reka - Në kujtim të 12 qershorit 1999 dhe periudhës së vështirë të kohës së okupimit, fotografi Hazir Reka shpalos kujtime përmes fotografive të tij, të paraqitura në lled në bulevardin e qytetit.

Klasa e flautës me profesoreshë Blenda Konxheli - koncert të vogël në flautë. - Kujtojmë se në sallën e Galerisë së Arteve, organizohen koncerte të shpeshta nga fusha e muzikës klasike. Sektori i Kulturës gjithnjë tregon përkujdesje për këto koncerte.

HENDIFER – punëtori artistike me persona me nevoja të veçanta “Art për të gjithë” - Në bashkëpunim me Galerinë e Arteve, SHAF “Zef Kolombi” dhe HENDIFER organizuan një koloni artistike me persona me nevoja të veçanta, nga vende të Ballkanit, që merren me pikturë.

“Togeri i Inishmorit” – premierë teatrore në Teatrin “Adriana” – Ferizaj - Në rrjedhat e punës së Teatrit “Adriana”, u dha premiera e re e shfaqjes “Togeri i Inishmorit” të Martin McDonough, në regji të regjisorit maqedonas Rizenski.

Promovimi i librit “Hija që më ndjekë pas” - Në sallën e Galerisë së Arteve, u promovua libri me poezi “Hija që më ndjekë pas” i autorit Kanun Veseli. Ky është libri i dytë i tij me poezi.

Takim letrar me shkrimtarin Besnik Mustafaj - Në sallën e Galerisë së Arteve – u organizua një takim letrar me shkrimtarin e mirënjohur shqiptar, Besnik Mustafaj. Në takim morën pjesë dashamirë të librit dhe kritikës. Këtë aktivitet e inicoi krijuesi Gani Bytyçi dhe u përkrah nga Sektori i Kulturës.

Antropologë ndërkombëtarë në Ferizaj - Studentë e profesorë nga Universiteti Veror Ndërkombëtar i Prishtinës erdhën në Ferizaj dhe u njoftuan me Shkollën Antropologjike. Mysafirët ishin nga vende të ndryshme si nga Gjermania, Turqia, Greqia, Sudani, Shqipëria, Franca dhe Italia. Në anën tjetër, ne patëm mundësi të njihemi dhe të ndajmë përvoja me kolegët, studentët nga vende të ndryshme nga e gjithë bota.

Aktivitet letrar “Flasim për Kadarenë” - Në kujtim të shkrimtarit të madh shqiptar e botëror Ismail Kadare, Klubi Letrar “De Rada” në bashkëpunim me Sektorin e Rinisë – DKRS organizoi një aktivitet letrar me të rinj “Flasim për Kadarenë”. Krijues dhe studiues ferizajas shfaqën mendimet e tyre mbi veprën e Ismail Kadaresë dhe vendit që ajo zë në letërsinë shqipe. Ky aktivitet ishte homazh për shkrimtarin më të madh të letrave shqipe që u largua nga kjo botë më 1 korrik 2024.

Ditët e Mërgatës – Ferizaj 2024

Periudha e fundit e muajit korrik dhe pjesa e parë e muajit gusht, zakonisht është koha kur mërgimtarët tanë vijnë nga vende të ndryshme të Evropës e botës, për të kryer pushimet në atdhe. Natyrisht edhe ne, si Drejtori për kulturë, i kushtojmë një përkujdesje të veçantë kësaj periudhe, duke organizuar aktivitete të ndryshme kulturore e argëtuese në mikpritje të mërgimtarëve tanë.

Tabela 3. Aktivitetet e manifestimit “Ditët e mërgatës”

26 korrik	AKTIVITET PËR FËMIJË Hapja e manifestimit	Sheshi i Qytetit
27 korrik	SHFAQJE PËR FËMIJË “Rojtari i vreshtave” – Sabri Pajaziti	Teatri i Qytetit
28 korrik	FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I VALLEVE Grupe të valleve nga vende të ndryshme të botës	Oborri i SHFMU “Jeronim de Rada”
29 korrik	EKSPOZITË HISTORIKE Muzeu i Ferizajt – paraqitja e eksponateve	Sheshi i Qytetit
30 korrik	PANAIRI I BIZNESEVE ARTIZANALE Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Bulevard
31 korrik	PLAYFEST Festival multikulturor	Parku i Lirisë
2 gusht	TRYEZË ME BIZNESE NGA MËRGATA Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Hotel Rubis
4 gusht	HIKING ECJE MALORE Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit & Klubi i Turizmit dhe Rekreacionit	Jezerc
	BJESHKËT E JEZERCIT Aktivitet kulturor artistik	
5 gusht	LOJËRA ELEMENTARE NË UJË Aktivitet sportiv: DKRS & Pishina “Matoshi”	Pishina “Matoshi”
6 gusht	KOLONI ARTISTIKE PËR MËRGIMTARË	
8 gusht	VIZITË VENDEVE TURISTIKE ME MËRGATË	Pika turistike
8-11 gusht	“PANAIRI I LIBRIT” – EDICIONI I GJASHTË Klubi letrar “De Rada”	Sheshi i Qytetit

Tabela e aktivitete, çdo vit përfshin një varg aktivitete të të gjitha fushave të kulturës, të cilat nga njëri vit në tjetrin variojnë, por shumica prej tyre mbahen në ambient të hapur.

Festivali i Teatrove – Edicioni i 54 -të - Një prej ngjarjeve më të mëdha kulturore në Ferizaj, pa dyshim është Festivali i Teatrove ku marrin pjesë trupat performuese nga Kosova, Shqipëria e Maqedonia e Veriut, takohet komuniteti artistik i artit skenik, ka audiencë tradicionale, si dhe zhvillohen aktivitete e workshope paralele që e begatojnë festivalin. Është e rëndësishme edhe pjesa argëtuese pas shfaqjeve, me rock grupe muzikore që performojnë.

Fituesit në Edicionin e 54-të të Festivalit të Teatrove në Ferizaj

Kostumografia më e mirë: Yllka Brada për shfaqjet “Kamarja e Turpit” dhe “Tartufi”

Skenografia më e mirë: Enes Deari për shfaqjen “Mishi Egër”

Roli episodik më i mirë: Alban Shahiqi për rolin e tij në shfaqjen “Tartufi”

Aktori më i mirë në rol dytësor: Ylber Bardhi për rolin e tij në shfaqjen “Kamarja e Turpit”

Aktorja më e mirë në rol dytësor: Aurita Agushi për rolin e saj në shfaqjen “Tartufi”

Çmimi special: Shfaqja “Togeri i Inishmorit”

Çmimi Yll në Ardhje: Albina Krasniqi për rolin e saj në shfaqjen “Charles III”

Aktori më i mirë (Çmimi “Ismail Rama”): Ernest Malazogu për rolin e tij në shfaqjen “Audienca”

Aktorja më e mirë (Çmimi “Adriana”): Suela Bako për rolin e saj në shfaqjen “Çifti i Hapur”

Regjia më e mirë: Qëndrim Rijani për shfaqjen “Tartufi”

Çmimi i publikut: Shfaqja “Togeri i Inishmorit”

Shfaqja më e mirë: “Tartufi” - Teatri i Gjilanit

Promovimi i librit “Jeta me laps e Nehat Islamit” - U promovua libri i Xheladin Rexhepit “Jeta me laps” kushtuar veteranit të gazetarisë Nehat Islami. Promovimi u organizua nga Shtëpia Botuese “Drini” Ferizaj me përkrahje nga Sektori i Kulturës. Botimi i kësaj vepre u mbështet nga Komuna e Ferizajt.

Hapja solemne e Festivalit të Karikaturës HiTHi - Shoqata e Karikaturistëve HiTHi nga Ferizaj, tani e disa vite organizon Festivalin e Karikaturës në Ferizaj. Në vitet e para filloi si një ekspozitë individuale, por me kalimin e viteve ky aktivitet u shndërrua në festival.

Mbrëmje filmi me Klubin Rin On - Gati thuajse gjatë gjithë vitit, në çdo fund muaj, Klubi Rin On, ka organizuar mbrëmje filmash, e kohëve të fundit ka shfaqur filma të regjisorëve ferizajas, duke organizuar pastaj edhe diskutime. Në këtë mbrëmje u shfaq filmi “Skënderi” në regji të Sabri Pajazitit.

28 Shtatori – Dita e Dëshmorëve

Zakonisht kësaj date i kushtohet një rëndësi e veçantë me disa aktivitete. Fillimisht pas homazheve, organizohet një akademi përkujtimore, e shoqëruar me pjesë artistike. Po në këtë datë mbahet edhe aktiviteti letrar “Ora e Astritit”, si dhe një ecje tradicionale. Herë pas here mund të shtohen aktivitete të tjera.

Aktiviteti letrar “Ora e Astritit” – Edicioni i 8-të. Ky aktivitet i organizuar nga Klubi Letrar “De Rada” – Ferizaj, u mbajt në Galerinë e Arteve-Ferizaj, me pjesëmarrje të poetëve të shumtë nga Kosova, Shqipëria, mërgata etj.

Çmimi i parë: Valbona Mulaj – Lluka me poezinë ‘Ma nis’

Çmimi i dytë: Fatmir Gjata me poezinë ‘Vjeshtë’

Çmimi i tretë: Arsim Halili me poezinë ‘Lavjerrësi’

Festivali i këngës për fëmijë “Fëmijët e gëzuar” - Ky festival për fëmijë është themeluar në vitin 1988 dhe sivjet e realizoi edicionin e 36-të. Vendi e parë e fitoi kënga "Klithma e paqes" kënduar nga Isra Elmazi (Kërçovë).

Festivali i Recitatorëve 2024 - Në garë morën pjesë nxënës të shkollave fillore dhe të shkollave të mesme. Hapja u bë me një pjesë recital, me vargje të përzgjedhura nga poetja ferizajase Blerinë Murtezi, ku interpretuan nxënës të Shkollës së Arteve “Çesk Zadeja” të përgatitur nga profesoreshë Emine Berisha.

Fituesit nga shkollat fillore ishin:

Vlera Sahiti -Vendi i parë - Çmimi “Misret Halili”

Dea Shabani – Vendi i dytë

Elona Avdyli – Vendi i tretë

Fituesit nga shkollat e mesme ishin:

Nina Ramadani -Vendi i parë - Çmimi “Misret Halili”

Enea Reka - Vendi i dytë

Mariola Rexhepi - Vendi i tretë

Po ashtu Klubi Letrar "De Rada" ndau çmimin special “Zyhrije Vata”, që i takoi fitueses Daorsa Sopa. Udhëheqës artistik i festivalit ishte Ben Apolloni. Moderroi: Donika Zeqiri; skenari Sabri Pajaziti. Organizimi i gjithë festivalit u bë nga Fondacioni Chaplin, me udhëheqës Ali Krasniqi.

Dy promovime librash nga Idajete Qazimi dhe Deja Imeri - Në sallën e Galerisë së Arteve në të njëjtën kohë u promovuan dy libra: “Zonja e Shtëpisë” nga Idajete Imeri dhe “Vajza që i donte librat” nga Dea Qazimi. Autoret e këtyre dy librave janë nënë e bijë.

Promovimi i librit “Do të vij si pëshpërimë” të Zyhrije Vatës (postmortum) - Nën organizim të Klubit Letrar “De Rada”, u promovua libri “Do të vij si pëshpërimë” të poetes Zyhrije Vata. Kujtojmë se Zyhrije Vata ka qenë aktiviste shumë dimensionale, pedagoge arsimore, shkrimtare, si dhe moderatore e shumë programeve e promovimeve kulturore. Ajo ndërroi jetë vitin e kaluar. Ky promovim ishte edhe një homazh për jetën dhe veprën e saj. Libri është botuar nga Klubi letrar “De Rada”, ndërsa është përgatitur për shtyp nga: Zyrafete Shala – redaktore, Sylejman Dërmaku, Arsim Hamiti dhe Fatmir Vata.

Promovimi i librit “Ndërrim kohësh” nga Shyqeri Hyseni - Në këtë datë mjeku i njohur ferizajas Shyqeri Hyseni, në cilësinë e shkrimtarit promovoi librin e tij poetik “Ndërrim kohësh”. Salla ishte e mbushur me dashamirë të librit dhe miq të autorit.

Promovimi i krijimtarisë publicistike të gazetarit Fahri Musliu - Në sallën e Kuvendit komunal, Klubi Letrar “De Rada” organizoi një aktivitet ku u bë promovimi i krijimtarisë publicistike të gazetarit Fahri Musliu. Morën pjesë gazetarë, publicistë dhe njerëz të tjerë të kohës si dëshmi e ndodhive për të cilat flasin shkrimet e Musliut.

Festivali “Kosovarja Këndon” – Edicioni i 52-të - Në sallën e Teatrit “Adriana”, u mbajt edicioni i 52-të i Festivalit “Kosovarja Këndon”. Prezantuan këngëtare të reja nga treva të ndryshme të Kosovës. Juria e përbërë nga: Lindita Isufi – dirigjente; Adelina Thaqi - soprano; dhe Adelina Qerimi - soprano; vlerësuan kandidatet me këto rezultate:

Vendi i parë: Verona Kryeziu nga Suhareka, me këngën "Sytë për ty i kam të njomë"

Vendi i dytë: Teuta Morina nga Prishtina me këngën: "Njat zaman t'asaj furie",

Vendi i tretë: Daorsa Sopa nga Ferizaj, me këngën "Synin si qershia"

Çmimi Nexhmije Pagarusha: Erblina Rexhaj nga Shtimja, me këngën: "Dasho Shkreli"

Çmimi i mediave: Daorsa Sopa.

Festivali "**Kosovarja Këndon**" është aset shtetëror, është trashëgimi shpirtërore e popullit tonë.

Festivali për Fëmijë Sidorela Fest- Edicioni i 9-të - Në sallën e Teatrit “Adriana” u mbajt edicioni i 9-të i Festivalit të këngës për fëmijë Sidorela Fest, ku prezantuan fëmijë me këngët e tyre, në kategorinë live dhe kategori të tjera. Çmimin kryesor e mori Lanika Dashi, me këngën e Vaçe Zelës "*Rrisim jetën tonë*".

Festa e Flamurit në Tiranë - Në mesin e shumë grupeve kulturore e sportive nga mbarë bota shqiptare, denjësisht u prezantua edhe Komuna e Ferizajt e prirë nga Ansambli “Kastriotët” e “Nostalgjikët”, Sektori i Shëndetësisë, Spitali i Ferizajt, Mjekësia Familjare dhe klubet sportive.

Ekspozitë e fotografisë – Hazir Reka - Në vigjilje të 28 Nëntorit – Ditë së Flamurit Kombëtar, në Shkollën e Arteve “Çesk Zadeja” u organizua ekspozita personale e fotografit Hazir Reka.

Mbrëmje filmi - Animacion - Organizatorët e FerFilm Festival, në kuadër të programit vjetor, në këtë fundvit organizuan disa mbrëmje filmash. Kjo ishte mbrëmje filmi animacion ku u shfaqën filma për të vegjëlit.

Mbrëmje artistike për personat me nevoja të veçanta - Grupi i FerFilm Festival organizoi një mbrëmje artistike për personat me nevoja të veçanta, ku u shfaqën disa filma të zhanrit komedi dhe në fund u shtrua një koktej me ushqime tradicionale.

Shfaqje teatrore - premierë “13” - Në sallën e Teatrit “Adriana” u dha premiera teatrore “13” në regji të Sulejman Rushitit, ndërsa luajtën trupa e Teatrit “Adriana”. Shfaqja ishte një gërshetim që autori ka bërë prej disa pjesëve letrare nga Kadare, Floqi, Kuteli e Fishta.

Ekspozita e skulpturës Skulpt-Fer - Në ambientet e Galerisë së Arteve në Ferizaj u hap edicioni i katërt i Ekspozitës së Skulpturës “Skulpt-Fer” 2024. Ekspozita e Skulpturës “Skulpt-Fer” është një nga ngjarjet më unike dhe më të veçanta për skenën e artit pamor në Kosovë, që ka në qendër të vëmendjes ekskluzivisht skulpturën.

Juria seleksionuese e punimeve pjesëmarrëse përbëhej nga: Prof. Ismet Jonuzi, kurse juria për ndarjen e çmimeve të këtij edicioni ishin Prof. Guri Çavdarbasha (kryetar i jurisë), Prof. Fatmir Mustafa (anëtar) dhe prof. Kastriot Zeqiri (anëtar), të cilët ndanë tre çmime për tre skulptor, ku Çmimi “Skulpt-Fer I” iu nda skulptorit Arton Behrami dhe Bilbil Mazrekut, kurse Çmimi “Skulpt-Fer II” iu nda skulptorit Selam Kastrati. Në këtë ekspozitë u prezantuan 25 skulptorë me vepra nga medime të ndryshme të skulpturës.

Promovimi i albumit “Gjysmë” i rock grupit 7me7 - Në sallën e Teatrit “Adriana” u promovua albumi më i ri i rock grupit ferizajas 7me7. Kujtojmë se 7me7 është një prej rock grupeve më të njohura në skenën e rockut kosovar dhe mbarë shqiptarë.

Program nga fusha e artit skenik – “Njohje fillestare me artin skenik” - Disa ditë rresht është punuar me disa grupe nga shkollat e mesme, të cilët e kanë elanin dhe entuziazmin të merren me fushën e aktrimit. Më 18 dhjetor u bë nata finale, ku disa prej shkollave kishin përgatitur performanca të shkurtra në prezantim si shfaqje teatrore. Programi “Njohje fillestare me artin skenik” ka për qëllim nxjerrjen e talenteve të rinj, si dhe orientimin e duhur për ata që shfaqin dëshirë të merren me këtë art dramatik. Organizator: Fondacioni Chaplin.

Kromatika – Koncert për fëmijë - Kursi i muzikës “Kromatika” organizoi një koncert me fëmijë për fund vit. Koncerti kishte karakter festiv për festat e fund vitit.

Mbrëmje baleti – Në mesin e qindra të pranishmëve në Teatrin “Adriana” në prag të festave të fund vitit, u dha shfaqje e baletit e përgatitur nga Gresa Hamdiu në kuadër të “My Ballet Class” mbështetur nga Komuna e Ferizajt.

FerFilm punëtori me Myriam Cruese nga Spanja - Në kuadër të programit vjetor, FerFilm organizoi një punëtori dy ditore me Myriam Cruese nga Spanja, e cila ligjëroi për të rinjtë lidhur me përvojat e saja nga fusha e filmit. Punëtorja një ditë u mbajt në Ferizaj dhe një ditë në Kaçanik.

Promovim libri nga Enver Zhinipotoku - Në sallën e Teatrit “Adriana” u promovua libri publicistik *“Refleksione – nga jeta dhe për jetën”* nga profesori i filozofisë dhe sociologjisë, Enver Zhinipotoku.

Aktivitet në Zym kushtuar Katarina Josipit. - Me ftesë të nikoqirit Frrok Kristaj, një grup intelektualësh nga Ferizaj, bashkë me përfaqësuesit e kulturës, ishin mysafirë në Zym të Hasit, në një aktivitet të veçantë kushtuar aktorese së ndjerë Katarina Josipi. Kujtojmë se Katarina Josipi ishte një prej aktoreve të para shqiptare në ish Jugosllavi, e cila pjesën kryesore të karrierës e kishte bërë në Ferizaj.

Ansambli “Kastriotët” koncert me të vegjlit “Yjet e Kastriotëve” - 50 fëmijë e të rinj prezantuan talentin e tyre në këndim, vallëzim dhe anekdota të cilët në pesë muajt e fundit janë përzgjedhur dhe kanë mbajtur ushtrime në instrumente, këndim dhe vallëzim në kuadër të projektit “Yjet e Kastriotëve”, në kuadër të promovimit të trashëgimisë shpirtërore. Kujtojmë se gjatë vitit Ansambli “Kastriotët” ka qenë tejet aktiv, duke marrë pjesë në shumë programe, festivale dhe koncerte të ndryshme nëpër Kosovë e më gjerë dhe gjithnjë duke u kthyer me çmime e shpërblime.

Program kulturo-artistik për fund vit dhe Artisti i Vitit- Zakonisht në prag të festave të fund vitit, Sektori i Kulturës organizon një program kulturor-artistik për fund vit, ku prezantohet vizualisht puna njëvjeçare e Sektorit të Kulturës. Më pastaj ndahen mirënjohje e falënderime për bashkëpunëtorët gjatë vitit dhe bëhet shpallja e artistit të vitit nga komisioni vlerësues. Artisti i Vitit u zgjodh regjisor i ri, Sovran Nrecaj. Në këtë mbrëmje fund viti, të pranishmit i argëtoi rock grupi 7me7.

II. SEKTORI I RINISË

Sektori i Rinisë përgjatë vitit 2024 ka realizuar një numër të madh të ngjarjeve rinore, sportive dhe aktiviteteve të ndryshme, duke qenë edhe pjesë e projekteve e organizimeve të shumta në nivel lokal dhe në atë qendror. Organizimet e tilla, kanë bërë që gjithë përfshirja të jetë fokusi kryesor në angazhimin rinor. Nga thirrja e hapur në kuadër të Projektit “Komuna për të rinjtë”, përfituan 13 (trembëdhjetë) organizata të shoqërisë civile dhe individë. Vlen të theksohet se ky projekt vjen si rezultat i mbështetjes direkte dhe bashkëpunimit mes Bankës Botërore, Qeverisë Japoneze, si dhe Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe Komunës së Ferizajt.

Zyrtarët e Sektorit të Rinisë përveç monitorimit të këtyre projekteve, në vazhdimësi, kanë organizuar edhe aktivitete dhe projekte të tjera, me qëllim përfshirjen e vullnetarëve në procese të dobishme për ta dhe komunitetin.

Organizimi i klasës për mësimin e gjuhës angleze - Aktiviteti i parë i shënuar në vitin 2024 ishte vazhdimi i klasës për mësimin e gjuhës angleze në Shkollën e Mesme të Ulët ‘Tefik Çanga’ në Ferizaj, ku përfitues ishin gjithsej katër shkolla. Numri i nxënësve përfitues të këtij projekti ishte gjithsej njëzetë (20) nxënës. Ky kurs pa pagesë u ofrua nga ushtarët e njësitit të LMT-së të KFOR-it Amerikan nga Baza Ushtarake “Bondsteel”, me ndërmjetësimin e Sektorit të Rinisë.

Tryezë informuese për projektin “ToKeQark” - Në bashkëpunim me organizatën *The Ballkan Forum* u mbajt tryeza për ndarjen e informatave mbi projektin ‘ToKeQark’ i mbështetur nga projekti rajonal ‘SMART Ballkans’, ku përfitues ishin 15 të rinj nga komuna jonë. Tryeza mbledhi bashkë akterë të ndryshëm, përfshirë përfaqësues nga pushteti lokal, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit, Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe grupin e të rinjve që janë përfitues direkt të projektit.

Të rinjtë e Ferizajt aprovuan Konventën e Rinisë - 30 janar 2024 - Në një takim ku morën pjesë të rinjtë nga Organizatat Rinore dhe Këshilli i Nxënësve të Shkollave të Mesme të Ferizajt u aprovua konventa e përbashkët e rinisë: “Bashkë e frymëzojmë ndryshimin”. Konventa Rinore ka për qëllim ngritjen e angazhimit të të rinjve në proceset vendimmarrëse përmes pjesëmarrjes, përfaqësimit dhe qytetarisë aktive në Komunitet e Ferizajt dhe Drenasit. Angazhimi për të bashkuar të rinjtë përmes deklaratës së përbashkët rinore “Bashkë frymëzojmë ndryshimin”, është krijimi i një platforme bashkëpunuese që nxit diskutimin e hapur, shkëmbimin e ideve dhe një plan veprimi kolektiv. Ky projekt është financuar nga Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, mbështetur nga Ambasada e SHBA-ve në Kosovë dhe administruar nga KUSA. Ky projekt është implementuar në Komunitetin e Ferizajt dhe Drenasit.

Takimi solemn për shpalljen e aktivistëve të vitit - Në kuadër të agjendës për shënimin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës u organizua takimi solemn për shpalljen e aktivistëve më të mirë për vitin 2023. Vullnetarja, e cila për vitin 2023 e mori epitetin e më të mirit, angazhimit e saj e ka shtrirë në shumë dimensione, me fokus të veçantë në fushën e rinisë, si dhe shërbimeve e kujdesit ndaj moshës së tretë. Ndërsa për tre aplikuesit e tjerë në procesin për shpalljen e vullnetarit të vitit, u dhanë mirënjohje dhe falënderime.

Vizitë në Komunitetin e Gostivarit - Në kuadër të aktiviteteve dhe të bashkëpunimeve me shtetet e Ballkanit Perëndimor, u realizua vizita në Komunitetin e Gostivarit (Maqedoni Veriore) respektivisht në Zyrën për Rininë, qendrat rinore dhe Qendrën e Autizmit. Grupi ynë fillimisht u prit nga Kryetari i Komunitetit të Gostivarit, për të vazhduar më tej takimet me zyrtarët për çështje rinore dhe vendimmarrëse në nivelin e qeverisjes, zyrtarët e dy Qendrave Rinore, Qendrën e Autizmit dhe institucioneve të tjera kulturore dhe rinore. Pjesë e kësaj vizite ishin edhe përfaqësuesit nga Organizatat e Shoqërisë Civile, si OJQ-SUOK, Qendra Sociale Edukative-Dubravë, OJQ-ROE, Kuvendi i të Rinjve, grupi i vullnetarëve të Sektorit Rinor, aktivistë, studentë dhe profesionistë të fushës së shërbimeve për të rinj.

Vizita në Kazermën “Skënderbeu” - Vullnetarët dhe aktivistët e Sektorit të Rinisë të shoqëruar nga anëtarë të Kuvendit të të Rinjve, vizituan Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Kazermën “Skënderbeu” në Ferizaj ku u pritën nga majori dhe stafi i tij. Të rinjtë patën rastin të vizitojnë qendrën e edukimit formal për mësimin e gjuhëve të huaja, zyrën për përgatitjen e oficerëve të rinj, pastaj kanë pasur mundësi të shohin në mënyrë praktike menaxhimin e konflikteve dhe armët që janë në shfrytëzim nga FSK ku e takuan edhe njërin nga snajperistët më të mirë që aktualisht ka Kosova.

Takim me përfaqësues të institucioneve lokale - Syri i Vizionit në kuadër të projektit “Fuqizimi i punësueshmërisë të të rinjve dhe grupeve të marginalizuara në Komunën e Ferizajt” – YEEP II, ka realizuar takimin me përfaqësues të ndryshëm të institucioneve lokale, përfaqësues të bizneseve dhe organizatave të shoqërisë civile. Tryeza, ku morën pjesë edhe zyrtarët të Sektorit të Rinisë, ka trajtuar integrimin socio-ekonomik të rinisë së Komunës së Ferizajt. Gjithashtu, pjesëmarrësit e takimit kanë ndarë rekomandime mbi atë se si duhet të përmirësohet mbështetja dhe shërbimet e ofruara nga palët përgjegjëse për këtë grup të të rinjve. Projekti YEEP II zbatohet nga Syri i Vizionit, në partneritet me SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), SOS Fshatrat e Fëmijëve në të gjithë botën dhe Fondi Hermann-Gmeiner (HGFD).

Peace Corps Kosovo - Ambasadori amerikan mirëpriti grupin e vullnetarëve të Peace Corps Kosovo të cilët u betuan për angazhimin e tyre në Kosovë. Vullnetarët kanë arritur falë partneriteteve me drejtorët e shkollave, organizatat joqeveritare dhe zyrtarët komunalë të shumë qendrave në Kosovë. Në mesin e tyre është edhe vullnetari i cili, për dy vite me radhë do të shërbejë në Sektorin e Rinisë, në kuadër të angazhimit vullnetar të Korpusit të Pages. Vullnetari amerikan, i treti me radhë në sektorin tonë, u mirëpriti nga vullnetarët dhe aktivistët rinor ferizajas.

Publikohet raporti mbi nevojat e të rinjve ferizajas - U publikua raporti për “Vlerësimin e nevojave të rinisë për vitin 2024 në Komunën e Ferizajt,” që është një hap i rëndësishëm drejt të kuptuarit dhe adresimit të sfidave dhe nevojave të të rinjve në komunën tonë. Prezenca e institucioneve, e organizatave dhe vetë të rinjve në prezantim të raportit tregoi një angazhim të përbashkët për të përmirësuar kushtet dhe mundësitë për rininë në Ferizaj. Përfaqësuesit e Qendrës Sociale “SUOK Kosovo” theksuan se raporti siguron një bazë të rëndësishme për zhvillimin e politikave dhe programeve që janë të përqendruara në nevojat dhe interesat e rinisë. Aktiviteti u mbështet nga projekti “Komuna për të rinjtë” që financohet nga Qeveria e Japonisë përmes Fondit Japonez për Zhvillim Social të administruar nga Banka Botërore dhe implementuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) me Fondin e Zhvillimit të Komunitetit (CDF), dhe participuar financiarisht nga Komuna e Ferizajt.

Punëtorja mbi vlerësimin e nevojave të rinisë ferizajase - Me mbështetjen e Misionit të OSCE-së, zyra në Gjilan, u mbajt takimi i tretë regional me pjesëmarrjen e zyrtarëve të Misionit të OSCE-së, përfaqësuesve të Organizatave të Shoqërisë Civile, grupeve formale dhe jo-formale. Tema e zhvilluar gjatë punëtorisë ishte “Vlerësimi i Nevojave të Rinisë në Komunën e Ferizajt” dhe “Plani i Veprimit për Rini 2024-2026”. Ky bashkëpunim vjen si rezultat i punës në terren nga Organizata ‘Qendra Sociale SUOK Kosova’.

Plani i Veprimit për Rininë - Sektori i Rinisë dhe SUOK kanë organizuar punëtori njëditore për Planin e Veprimit për Rininë 2024-2026 me përfaqësues të OJQ-ve. Në këtë punëtori, të mbështetur nga Zyra Rajonale e OSBE-së, u draftua dokumenti fillestar, ndërsa në takimet e tjera që janë mbajtur gjatë dy muajve vijuese është nxjerr dokumenti final i strategjisë.

“Java e KFOR-it” - Aktiviteti i parë në kuadër të agjendës tashmë tradicionale Java e KFOR-it, u realizua në hapësirat e Galerisë së Arteve me storien e suksesit nga një anëtare e Klubit të Karatesë “Lybeteni” dhe nga dy ushtarakë amerikanë. Takimi ishte tejet motivues për të rinjtë pjesëmarrës.

Aktivitet në SHFMU “Tefik Çanga” në kuadër të Javës së KFOR-it - Në Shkollën e Mesme të Ulët “Tefik Çanga” u zhvillua aktiviteti i dytë në kuadër të Javës së KFOR-it. Pjesë e aktivitetit ishin sportiste dhe karateiste nga Klubi i Karatesë “Lybeteni”, vullnetarët dhe aktivistët rinor, si dhe nxënësit nga shkolla nikoqire.

Aktivitet i pikturimit - Në ditën e tretë të agjendës Java e KFOR-it në hapësirat e Parkut të Lirisë u zhvillua aktiviteti i pikturimit me pjesëmarrjen e nxënësve nga Shkolla e Arteve, Gjimnazi “Dr. Shaban Hashani” dhe të rinj të talentuar në fushën e artit pamor. Gjithashtu, pjesë e aktivitetit ishin edhe anëtarë nga Shoqata Handikos - Ferizaj.

Aktivitete sportive – Në kuadër të aktivitetit të agjendës Java e KFOR-it, në Sallën e Sporteve “Bill Clinton”, u organizuan aktivitete sportive në basketboll dhe volejboll, me pjesëmarrjen e ekipeve nga KFOR-i Amerikan, Policia e Kosovës - Stacioni i Ferizajt, Klubi i Volejbollit “Lybeteni”, grupet jo-formale të të rinjve, si dhe aktivistë rinor.

Të rinjtë ferizajas certifikohen në fushën e IA –së - Certifikohen njëzetë e pesë të rinj të Komunës së Ferizajt në fushën e inteligjencës artificiale, trajnim ky i cili u realizua në mbështetjen e programit "Empowering Youth with AI" nga GIZ-i gjerman në kuadër të aktivitetit të Agjencisë të Punësimit të Kosovës. Trajnimi u realizua në dy faza: Faza e parë nga data 15 dhe zgjati deri më 17 maj, ndërsa Faza e dytë e trajnimit filloi nga data 20 dhe zgjati deri më 24 maj.

Aktivitet përmbyllës “Java e KFOR-it” - Java e KFOR-it 2024 përfundoi me aktivitetin ecje në natyrë (Hiking) tek Ujëvarat e Mirushës. I gjithë grupi ishte nën udhëheqjen e dy alpinistëve ferizajas. Pjesë e aktivitetit ishin vullnetarët e Sektorit të Rinisë dhe aktivistë të tjerë, në mesin e të cilëve kishte edhe infermierë nga Qendra e Mjekësisë Familjare.

Monitorimi i zhvillimit të aktiviteteve në kuadër të projektit Municipalities for Youth- Përfaqësuesit nga Banka Botërore/World Bank, Ambasada Japoneze, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Community Development Fund - CDF dhe Komuna e Ferizajt vizituan disa nga organizatat përfituese të mbështetjes në kuadër të projektit Municipalities for Youth. Ky projekt është financuar nga Qeveria e Japonisë përmes mbështetjes së Fondit Japonez për Zhvillim Social, të administruar nga Banka Botërore, implementuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me Community Development Fund - CDF, dhe participuar financiarisht nga Komuna e Ferizajt. Vizita kishte për qëllim monitorimin e ecurisë së aktiviteteve të organizuara në ciklin e dytë të projektit nga organizata SUOK, organizata HandiKos, Klubi i Volejbollit "Vjosa" dhe organizata Art Stars Union.

Aktivitet me storie suksesi nga të rinjtë ferizajas - Në kuadër të agjendës “Ditët e Kulturës 2024” në hapësirat e Shkollës së Arteve u zhvillua aktiviteti storiet e suksesit nga të rinjtë ferizajas.

Hapja zyrtare e Bibliotekës Rinore -U bë hapja zyrtare e projektit “Biblioteka Rinore” e realizuar në kuadër të projektit Municipalities for Youth financuar nga Qeveria e Japonisë përmes mbështetjes së Fondit Japonez për Zhvillim Social, administruar nga Banka Botërore, implementuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me Community Development Fund - CDF dhe participuar financiarisht nga Komuna e Ferizajt. Ky donacion është përfituar nga një grup jo formal i të rinjve, të cilët e bënë edhe inaugurimin e hapësirës së bibliotekës që do të jetë në dispozicion të të rinjve ferizajas.

Takim informues rreth projektit “Mirëqenia Psikologjike” - Është mbajtur takim informues në kuadër të projektit “Mirëqenia Psikologjike” për të shpalosur rëndësinë e shëndetit mendor dhe për të promovuar ndërgjegjësimin në komunitet. Gjatë takimit u shpalosën statistikën që treguan rëndësinë e shëndetit mendor në jetën e përditshme, si dhe u prezantuan rezultatet dhe mbarëvajtja e projektit. Folësit theksuan rëndësinë e kujdesit ndaj vetes dhe të tjerëve, ndërsa u fokusuan në ndërgjegjësimin dhe zbulimin e ndërveprimeve pozitive që mund të ndihmojnë në promovimin e mirëqenies shpirtërore. Në të njëjtën kohë, u bë thirrje për bashkëpunim dhe përkrahje reciproke në komunitet për të promovuar ndërgjegjësimin dhe kujdesin për shëndetin mendor.

Vizitë në Kampin Ushtarak Bondsteel - Grupi i vullnetarëve nga Sektori i Rinisë janë pritur nga ushtarakët amerikanë në Kampin Bondsteel.

Organizohet nata Stars and Stripes Trivia - Në Bibliotekën Rinore në Ferizaj u organizua nata Stars and Stripes Trivia. Pjesëmarrës të shumtë të rinj së bashku me pjesëtarë të KFOR-it amerikan. Para se të fillonte trivia, pjesëmarrësit kaluan pak kohë duke luajtur lojëra tavoline dhe rrjetëzime. Nata e trivia u hartua për të testuar njohuritë e pjesëmarrësve rreth Shteteve të Bashkuara, me pyetje që mbulojnë tema të ndryshme si historia, kultura, gjeografia dhe shënimet e famshme.

Vizitë në Astronomy Outreach of Kosovo - Aktiviteti i radhës organizuar nga Sektori i Rinisë ishte vizita në Astronomy Outreach of Kosovo në fshatin Rashincë, Komuna e Shtimes. Nga profesori udhëheqës i observatoriumit, të rinjtë u informuan rreth rrugëtimit që ka bërë ideja për themelimin e kësaj qendre deri në realizimin final dhe patën mundësi të vrojojnë Hënën përmes teleskopëve të avancuar dhe ndoqën shfaqjen mbi asteroidet në planetarium.

Rritet fondi i librave në Bibliotekën Rinore - 25 korrik 2024 - Me mbështetjen e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është zgjeruar fondi i librave në Bibliotekën Rinore, me 200 tituj të rinj nga të gjitha fushat.

Aktivitet pikturimi mbi rëndësinë e ekonomisë qarkore - Grupi i të rinjve nga Komuna e Ferizajt gjatë javës së kaluar kanë mbajtur një aktivitet ku përmes pikturimit patën qëllim që të përçojnë tek të rinjtë rëndësinë e ekonomisë qarkore. Pjesëmarrës në këtë aktivitet kanë qenë mbi 15 të rinj që kanë marrë njohuri nga trajnimi tregëtar mbi zgjidhjet inovative, ndryshimet klimatike dhe sfidat mjedisore.

Drejtoresha e Peace Korps Kosovo viziton Sektorin e Rinisë - Drejtoresha e Korpusit të Paqes në Kosovë vizitoi Sektorin e Rinisë për të parë nga afër angazhimin e vullnetarit të kësaj organizate dhe zyrën ku ai punon. Më pas ajo vizitoi Panairin e Librit, për të vazhduar më tej në organizatën Hendifer ku u mirëprit nga drejtoresha me bashkëpunëtorët e saj. Ndërsa vendet e radhës që Drejtoresha nga Korpusi Paqes i vizitoi gjatë qëndrimit në qytetin tonë ishin Muzeu i Qytetit dhe fenomeni i Bifurkacionit.

Diskutimi mbi shëndetin mendor të të rinjve ferizajas - Në Bibliotekën e Qendrës Rinore u mbajt diskutimi i hapur me temë "Shëndeti mendor tek të rinjtë në Komunën e Ferizajt". Ky diskutim u organizua nga Sektori i Rinisë në partneritet me organizatat Qendra Sociale SUOK Kosovo, HendiFer dhe Projekti "Mirëqenia psikologjike". Përfaqësueset e organizatave të përmendura prezantuan rezultatet e hulumtimeve të bëra në terren, në mesin e të rinjve të komunës sonë, ndërsa të pranishëm në takim ishin edhe përfaqësuesit e KFOR-it Amerikan.

Në Pleshinë filloi kursi i gjuhës angleze - Në SHFMU "Pesë Dëshmorët e UÇK-së" të fshatit Pleshinë filloi kursi i gjuhës angleze nga ushtarët e KFOR-it Amerikan në kohëzgjatje prej 6 muajsh. Ishte kjo një mundësi e veçantë për nxënësit e kësaj shkolle që të mësojnë dhe t'i përforcojnë njohuritë e tyre në gjuhën angleze.

Vizitë institucioneve kulturore e historike në Prishtinë - Aktivistët dhe vullnetarët e Sektorit të Rinisë vizituan disa nga institucionet kulturore e historike në Prishtinë përfshirë: Shtëpinë e Pavarësisë "Dr. Ibrahim Rugova", Galerinë e Arteve të Kosovës dhe Bibliotekën Kombëtare të Kosovës. Vizita të tilla të institucioneve kulturore pasurojnë njohuritë e të rinjve mbi rëndësinë e këtyre institucioneve dhe aktivitetin që ato zhvillojnë.

Kosova në sytë e ushtarëve amerikan – KFOR-i dhe të rinjtë - Me pjesëmarrjen e nxënësve nga shkollat e mesme të larta të qytetit në hapësirat e Qendrës Rinore u organizua ligjërata me temën "Kosova nëpërmjet syrit të një ushtari amerikan" ku ligjëruan tre ushtarë të KFOR-it Amerikan nga Njësi i LMT-së në Kampi Bondsteel. Ky takim u mbajt në shenjë falënderimi për ushtarët e njësitit në fjalë që ishin në përfundim të mandatit në Kosovë, me të cilët Sektori i Rinisë i DKRS-së ka pasur bashkëpunim të frytshëm.

Vizitë në Ambasadën Amerikane - 7 nëntor 2024 - Të rinjtë ferizajas vizituan Ambasadën Amerikane me ftesën e Ambasadorit Amerikan, përmes vullnetarit të Peace Corps Kosovo i angazhuar në Sektorin e Rinisë në Ferizaj. Qëllimi i këtij takimi ishte prezantimi nga ana e Ambasadorit Amerikan të sistemit të zgjedhjeve presidenciale që sapo u mbajtën në SHBA, me theks të veçantë tek organizimi demokratik i tyre. Grupi që vizitoi ambasadën ishin rreth 25 të rinj, nxënës dhe studentë të grup moshave 16 deri 25 vjeç.

Ekspozitë në shkollën e fshatit Zaskok - Në SHFMU “Naim Frashëri” të fshatit Zaskok, sot u hap ekspozita me fotografi nga vizita e nxënësve të kësaj shkolle në institucionet fetare dhe kulturore në qytetin e Prizrenit. Kjo ekspozitë është organizuar në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së, Zyra Regjionale në Gjilan, Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Komunitetet, Sektori për Pronë Trashëgimi Kulturore dhe Dialog Ndër fetar, si dhe menaxhmenti i shkollës. Në hapjen e ekspozitës ishte edhe Drejtori i Zyrës Rajonale të OSBE-së.

Ekspozitë në shkollën “Tefik Çanga” të qytetit - Në hapësirat e Shkollës së Mesme të Ulët "Tefik Çanga" me pjesëmarrjen e Drejtorit të DKA-së, zyrtarë pranë Misionit të OSBE-së, ushtarakëve amerikan nga Njësi i LMT-së si dhe menaxhmentit të shkollës u hap ekspozita me fotografi nga nxënësit pjesëmarrës në vizitën studimore në objektet fetare dhe kulturore në Manastirin e Deçanit dhe qytetin e Pejës. Ky organizim ishte një bashkëpunim mes Sektorit të Rinisë, mësimdhënësve të shkollës dhe Misionit të OSBE-së.

Aktiviteti “Sot dhe çdo ditë tjetër” - Në kuadër të fushatës Globale-16 Ditë të aktivizmit kundër dhunës në baza gjinore me moton 'Sot dhe Çdo Ditë Tjetër', Sektori i Rinisë organizoi tryezën e diskutimit me panelistë nga Policia e Kosovës, koordinatorja regjionale e dhunës në familje dhe mbikëqyrësja e Sektorit të dhunës në familje nga Stacioni Policor në Ferizaj, përfaqësueset nga Spitali Regjional i Ferizajt, nga Strehimorja dhe nga Zyra për Barazi Gjinore. Nxënësit pjesëmarrës u njoftuan mbi shërbimet dhe përgjegjësitë e institucioneve karshi viktimave të dhunës në baza gjinore. Përveç të përmendurve edhe ushtarakët amerikan ishin pjesë e agjendës “SOT DHE ÇDO DITË TJETËR”.

“Dita e Vullnetarizmit” - 5 dhjetor 2024 - Për nder të Ditës së Vullnetarizmit në Sallën e Kuvendit të Ferizajt u mbajt një takim dhe ekspozitë me foto nga aktivitetet e Sektorit të Rinisë ndër vite.

Orë letrare me nxënësit në Dubravë - Në kuadër të aktiviteteve të Sektorit të Rinisë u organizua një orë letrare me nxënësit në Qendrën Sociale Edukative në Dubravë.

Sektori i Sportit është dikaster që funksionon në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit – Ferizaj e që merret me aktivitete sportive. Këto aktivitete realizohen duke iu referuar planit të punës të përpiluar në fillim vit. Ky sektor organizon aktivitete sportive të përbashkëta me klubet sportive e komunitetin sportiv, me Komitetin Olimpik të Kosovës, Departamentin e Sportit dhe me Federatat Sportive. Krijon kushte për mbarëvajtjen e aktiviteteve të klubeve sportive e të sportistëve.

Fillimisht po paraqesim gjeneralet e klubeve sportive për vitin 2024 ku janë të përfshirë në organizimin e sportit ferizajas gjithsej 61 klube sportive dhe 4 shoqata sportive, të cilat janë të organizuara mjaft mirë në zhvillimin e sportit në Komunën e Ferizajt. Gjithashtu janë themeluar 2 klube të reja dhe është riaktivizuar Klubi i Mundjes “Kastrioti” dhe shkolla e futbollit “Yjet 05”.

Në të gjitha klubet sportive janë të përfshira të dy gjinitë me të gjitha grup moshat, duke u përfshirë nga grup mosha U7 deri tek veteranët, çka do të thotë se në Komunën tonë kemi diku rreth 4900 sportistë aktiv dhe rreth 6800 sportistë rekreativ. Te sportistët rekreativ janë të përfshirë edhe sportistët e garave shkollore dhe grupimet e sportit të futbollit, kalërimit, alpinizmit, motoristët, notuesit dhe shumë grupe të sportistëve që zhvillojnë edhe sportin rekreativ.

Stërvitjet e realizuara gjatë vitit 2024

Sektori i Sportit kujdeset për infrastrukturën fizike-sportive që të krijoj kushte sa më të mira për zhvillimin e orëve stërvitore dhe garave të ndryshme sportive. Njëkohësisht po krijohen edhe terrene të reja sportive edhe nëpër fshatrat e Komunës së Ferizajt, në këtë mënyrë aktivizojmë jo vetëm klubet aktive por edhe komunitetin në fshatra.

Pallati i Sporteve “Bill Clinton” – Klubet sportive kolektive dhe individuale e të sportit të pavarur, aktivitetin e tyre e realizojnë në Palestrën e Sporteve. Staf i Sektorit të Sportit kujdeset për lehtësimin e realizimit të aktiviteteve sportive. Në Pallatin e Sporteve “Bill Clinton” në Ferizaj gjatë vitit 2024 janë realizuar gjithsej 4189 orë ekonomike stërvitje. Shfrytëzues të Palestrës kryesisht janë klubet sportive të Komunës së Ferizajt e në disa raste edhe klubet sportive nga komunat fqinje.

Lojë kampionale - Në Pallatin e Sporteve “Bill Clinton” janë realizuar gjithsej 109 lojë kampionale, 6 (gjashtë) lojë për Kupë, 7 (shtatë) lojë miqësore dhe 2 (dy) lojë ndërkombëtare.

Në Palestrën e Sporteve janë realizuar edhe disa koncerte artistike dhe aktivitete të tjera jo-sportive për përgatitjen e pjesës teknike të aktivitetit është përkujdesur Sektori i Sportit.

Stadiumi i Qytetit - Në Stadiumin e Qytetit në Ferizaj janë realizuar 2005 orë ekonomike stërvitje. Shfrytëzues të Stadiumit të Qytetit janë kryesisht klube të futbollit të Komunës së Ferizajt. Në Stadiumin e Qytetit janë zhvilluar përpos stërvitjeve edhe lojë me rëndësi – Janë zhvilluar 159 lojë kampionale, 5 lojë për kupë dhe 8 lojë miqësore.

Shumica e klubeve sportive aktivitetet stërvitore i kanë mbajtur në Pallatin e Sporteve “Bill Clinton”, Stadiumin e Qytetit, Stadiumin në fshatin Tërrn, po ashtu janë shfrytëzuar palestrat sportive nëpër shkolla dhe hapësira tjera publike, gjithashtu edhe garat e planifikuara, turnetë dhe lojërat miqësore janë realizuar në objektet sportive publike.

Aktivitete sportive

Përveç punëve të përditshme në sektorin e sportit organizohen edhe aktivitete të ndryshme sportive, në bashkëpunim me klubet sportive dhe shoqata sportive. Në vijim të raportit shihni aktivitetet kryesore sportive.

Shpallja e Sportistit të Vitit - Këshilli i pavarur i formuar nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka bërë grumbullimin e rezultateve, si në sportet kolektive po ashtu edhe në sportet individuale dhe pas përfundimit të garave, ka filluar poentimin e më të mirëve në sportin ferizajas. Në Janar të vitit 2024, u organizua ceremonia e shpalljes së Sportistit të vitit 2023, ku u shpallën rezultatet për më të mirët në sportin ferizajas. Komisioni i pavarur i formuar nga DKRS-ja ka vazhduar punën në përcjelljen e sukseseve edhe gjatë vitit 2024.

Mbajtja e kuvendeve të rregullta për të gjitha klubet dhe shoqatat sportive - Sektori i Sporteve në bashkëpunim me klubet sportive kanë organizuar kuvendet e punës. Gjatë viti 2024 një pjesë e klube sportive të Komunës së Ferizajt, kanë mbajtur kuvendet e rregullta të punës dhe ato zgjedhore, ky organizim i kuvendeve ishte në pajtueshmëri me MKRS-në dhe KOK-un, si objektivi që të riorganizohen të gjitha kuvendet e klubeve.

Turneu memorial në volejboll (femrat) “Ismet Ramadani” - Nën organizimin e DKRS dhe KVF “Ferizaj” u mbajt turneu memorial në volejboll (femrat) “Ismet Ramadani” ku ishin pjesëmarrëse 4 ekipe të cilat treguan një cilësi të lartë të lojës së volejbollit. Tri vendet e para u shpërblyen me medalje dhe kupa.

Dita Ndërkombëtare e Sportit për Zhvillim dhe Paqe - Është organizuar në bashkëpunim me Sportin Shkollor dhe KOK-un.

Minimaratona “Vrapojmë me Policinë e Kosovës” – Minimaratona u organizua nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me DKRS-në, në kuadër të Ditës së Çlirimit të Ferizajt. Në këtë organizim morën pjesë qytetarë të moshave të ndryshme.

Turneu Memorial në Pingpong “Ahmet Hoxha” - Klubi i Pingpongut “Ahmet Hoxha” dhe DKRS organizuan turneun memorial në pingpong me disa klube pjesëmarrëse të Kosovës dhe shpërbleu tri vendet e para me kupa dhe medalje.

Turneu i Veteranëve në Pingpong “Gani Maloku” - Klubi i Pingpongut “Gani Maloku” në bashkëpunim me DKRS-në organizuan turneun e veteranëve në pingpong me disa klube pjesëmarrëse të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, ku tri vendet e para u shpërblyen me kupa dhe medalje.

Turneu Memorial në hendboll “Ahmet Petrova” – Për të nderuar veprimtarinë dhe kontributin e dhënë në sportin e hendbollit nga Ahmet Petrova, në Pallatin e Sporteve "Bill Clinton" u mbajt turneu memorial në hendboll.

Gara në Automobilizëm - Në organizimin e Federatës së Automobilizmit dhe DKRS-së u mbajt Kampionati në Automobilizëm ku morën pjesë një numër i madh i garuesve nga gjitha klubet e Kosovës të cilat zhvilluan garat në disa kategori të ndryshme në të dy gjinitë. Organizatori tri vendet e para i shpërbleu me kupa dhe mirënjohje.

Garat shkollore, lokale dhe regjionale - Në Pallatin e Sporteve u organizuan garat shkollore, lokale dhe regjionale në dy gjinitë ku morën pjesë të gjitha ekipet nga shkollat e Komunës sonë, si dhe ekipet nga Komuna e Shtimes, Lipjanit, Kaçanikut , Shtërpçës dhe Hanit të Elezit. Edhe në këtë garë tri vendet e para u shpërblyen me medalje dhe kupa si dhe dy vendet e para fituan të drejtë të marrin pjesë në garën finale që mbahet në Prishtinë.

Tiranë- Defile – Dita e Flamurit Kombëtar - Nën organizimin e Bashkisë së Tiranës, në bashkëpunim edhe me Komunën e Ferizajt dhe komunat tjera mbarë shqiptare, në nderim të Festës së Flamurit Kombëtar, u organizua një defile i përbashkët mbarë shqiptar nga gjitha bashkitë e komunat e trojeve shqiptare. Komuna e Ferizajt prezantoi me mbi 200 pjesëmarrës, prej tyre 11 klube sportive.

TË ARRITURAT NË SPORT PËR VITIN 2024

Sportet Kolektive – Sporti i Futbollit në Komunën e Ferizajt gjatë vitit 2024, ishte i organizuar mjaft mirë, kishte një ngritje të klubit të futbollit “Ferizaj”- u bë pjesë e Super ligës së Kosovës. Klubi i futbollit “Dinamo” është pretendent për Super ligën e Kosovës.

Klubet e hendbollit janë mirë të organizuar gjatë këtij viti, KH “Ferizaj” Super ligë: i organizuar mjaft mirë me gjitha grup moshat, fitues i Kampionatit të Kosovës dhe fitues i Kupës së Kosovës.

Po ashtu kemi ngritje të rezultatit dhe shumë synime drejt sukseseve nga KH “Kastrioti” (meshkujt). Të organizuar mjaft mirë me të gjitha grup moshat, fitues i Kupës së Kosovës dhe i rreshtuar në kreun e tabelës në Super ligë.

KVF “FerVolley” është suksesshëm i organizuar në Superligën A, është Fitues i Kupës së Federatës dhe në vendin e parë si në Ligë të Kosovës ashtu edhe në Ligën e Kombeve.

Klubi i Volejbollit “Kastrioti” është i organizuar mjaft mirë, aktualisht gjendet në kreun e tabelës në Super ligë dhe fitues i disa Garave Ballkanike në BeachVolley.

Klubi i Volejbollit “Ferizaj” M- në Super ligën A, është finalist i kupës së federatës, i organizuar mjaft mirë dhe është në mesin e 4 klubeve më të suksesshme në Kosovë.

Sukseset nuk kanë munguar edhe në klubet tjera kolektive, por në raport janë përfshirë rezultatet kryesore.

Sportet tjera individuale –Klubi i shahut në Ferizaj, klubet e karatesë, xhudos, notit, pingpongut, gjimnastika dhe automobilizmit i kanë sjellë qytetit të Ferizajt me qindra medalje nga turnetë e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Sportistë ferizajas i sollën qytetit të Ferizajt, medalje vendore dhe ndërkombëtare.

BIBLIOTEKA KOMUNALE “SADIK TAFARSHIKU”

Në Sektorin për Fëmijë u anëtarësuan 854 lexues me 13211 libra të lexuara.

Tek Sektori për të Rritur u anëtarësuan 561 lexues me 6898 libra të lexuara

Gjithsej:1415 lexues - 20109 libra të lexuara.

Në sallën e leximit ishin 4199 lexues, kurse të informatikës 196 lexues.

Në Talinoc të Muhaxherëve u anëtarësuan 95 lexues me 472 libra të lexuara.

Në Dardani u anëtarësuan 9 lexues me 40 libra të lexuara.

Në Komogllavë u anëtarësuan 172 lexues me 688 libra të lexuara.

Në Neredime u anëtarësuan 94 lexues me 188 libra të lexuara.

Gjithsej: 370 lexues me 1388 libra të lexuara

Në Sektorin e katalogimit dhe përpunimit të librit, u bë inventarizimi i 1761 librave. Ministria e Kulturës i dhuroi bibliotekës 604 libra.

Aktivitetet gjatë vitit 2024

- Nga Pen Qendra e Kosovës, u mbajt ligjëratë me temën “Pse shkruajmë” ku ligjëruan: Prof. Diçe Demiri Frangu dhe Prof. Milazim Krasniqi. Aktiviteti u moderua nga shkrimtari Ibrahim Berisha.
- U shënua 17 Shkurti - Dita e Pavarësisë së Kosovës, ku hapëm ekspozitën me artikuj të gazetave ku lajmërohej shpallja e Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Si dhe zgjodhëm lexuesit më të mirë për vitin 2023.
- Në Ditën Botërore të Poezisë, Biblioteka organizoi një aktivitet të përbashkët me shkollën “Tefik Çanga” ku nxënësit e kësaj shkolle recituan poezi dhe u takuan me poeten ferizajase Tahire Berisha Abazi.
- Fondacioni “Enver Maliqi” furnizoi sallën e leximit me inventarë të ri.
- Në Ditën Botërore të Librit, Bibliotekën e vizituan shumë shkolla të qytetit, ku nxënësit u njoftuan me rëndësinë e librit, rëndësinë e bibliotekës dhe me punën profesionale që bëhet në bibliotekë.
- Vizitë pune në bibliotekat në degë.
- Nga Komuna e Ferizajt, përkatësisht nga Drejtoria e Kulturës u pasurua fondi librar 426 kopje libri dhe 187 tituj.
- Aktivitet me lexues në sektorin për fëmijë, ku u analizua vepra “Princesha Argjiro” e Ismail Kadaresë.
- Ekspozuam për lexuesit librat e autorit Ismail Kadare, me rastin e vdekjes së autorit.
- Bashkëpunuam me Institutin e Historisë në Prishtinë dhe pas kërkesës së bërë nga Biblioteka, Instituti i dhuroi bibliotekës botimet e veta.
- Për nder të muajit të letërsisë, tetorit, ekspozuam librat e autorëve të lindur pikërisht në tetor.
- Për nder të 28 Nëntorit - Ditës së Flamurit, Biblioteka organizoi aktivitet së bashku me nxënësit e shkollës “Ahmet Hoxha” dhe stolisi ambientet e Bibliotekës me flamurin kombëtar.

ARKIVI HISTORIK

Gjatë vitit 2024, kjo njësi ka vazhduar punët e mbetura nga viti paraprak, duke i grumbulluar, evidentuar dhe vendosur nëpër rafte dokumentacionin arkivor. Dokumentacioni që gjendet në arkiv është përpunuar hollësisht dhe profesionalisht dhe është vendosur në vendin adekuat sipas numrit dhe llojit të lëndës.

Në vitin 2024 në Arkivin Historik kemi pasur gjithsej 186 qytetarë që i kemi shërbyer duke i respektuar kornizat ligjore, duke ju shërbyer me material arkivor dhe dokumentacione personale që ata kanë kërkuar nga ne.

Gjatë këtij viti kemi bërë ndarjen e materialit arkivor në Drejtoritë përkatëse, sipas shenjave dhe numrit të lëndëve. Në vitin 2024 në kryerjen e punës në Arkivin Historik jemi përcaktuar sipas kësaj veprimtarie:

1. Ndarja dhe përcaktimi i dokumentacionit arkivor dhe lëndës arkivore
2. Klasifikimi i lëndës arkivore në fonde
3. Formimi dhe kompletimi i dosjeve në fonde
4. Sistematizimi i lëndëve arkivore në fonde
5. Mbrojtja teknike
 - Përpunim i fondit: Dosjet të personelit komunal në Ferizaj
 - Përpunim i fondit: Raporte, vendime, aktvendime, procese viti 1985/86/87
 - Përpunim i fondit :Procesverbale të Kuvendit Komunal 1969/78
 - Përpunim i fondit: Plani urbanistik 2001
 - Përpunim i fondit: Vendim dhe procese të vitit 1985/86/87

Materiali i emërtuar: Dëmet e luftës së vitit 1998/99 në Ferizaj dhe rrethimi është dorëzuar në: Institutin e Krimeve Gjatë Luftës në Kosovë(IKKL) me datë 07.08.2024 me numër protokolli 033. Në bazë të ligjeve relevante: **LIGJI NR. 08/L-177 PËR INSTITUTIN E KRIMEVE TË KRYERA GJATË LUFTËS NË KOSOVË DHE LIGJI NR. 06/L-082 PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.**

PËRFUNDIM

Viti 2024 ishte vit i arritjeve, rezultateve dhe sukseseve në organizim të aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive. Ndonëse në fillim vit, DKRS shtron një plan dhe një kalendar të aktiviteteve që planifikohen të mbahen gjatë vitit, në fund shohim se plani është tejkaluar me shumë aktivitete shtesë.

Në bazë të analizës së raportit dalin këto rezultate:

Teatri “Adriana” - aktiv gjatë gjithë vitit - Menaxhmenti i Teatrit “Adriana” në çdo fillim muaji e publikon repertorin me shfaqje e repriza, që janë prodhim i Teatrit të Ferizajt, por gjithsesi prezantohen edhe shfaqje mysafire nga teatrot e tjera. Pastaj pjesëmarrja në qendra të tjera, në festivale të tjera, si dhe Festivali i Teatrove që sjell shfaqje të përzgjedhura nga teatri shqiptar.

Teatri i qytetit “Adriana” vazhdoi me repertorin e rregullt, po ashtu realizoi gjashtë premiera teatrore (katër për të rritur dhe dy për fëmijë), organizoi Festivalin e Teatrove (edicioni i 54-të), ku u shpërblye më së shumti trupa e teatrit tonë, pastaj ishte pjesëmarrëse në Festivalin e Tiranës, etj.

Muzeu dhe Galeria e Arteve – me vizitorë të shumtë.

Thuajse gjatë gjithë vitit, Muzeu dhe Galeria e Arteve në Ferizaj, presin vizitorë të shumtë. Vizitorët shpeshherë janë grupe të organizuara nga shkollat me nxënës, fakultete me studentë, grupe studimore, mysafirë ndërkombëtarë e qytetarë.

Në Muzeun e Qytetit kishte 48 vizita grupe të organizuara (nxënës, mësimdhënës, shkolla, kolegje etj.), si dhe afro 4000 vizitorë të Muzeut dhe aktiviteteve që ka organizuar kjo njësi.

Në Galerinë e Arteve u organizuan mbi dhjetëra aktivitete nga fusha e artit pamor, duke vazhduar me manifestimet tradicionale dhe aktivitetet e pavarura. Ndërsa Galeria e Arteve këtë vit kishte mbi 5000 vizitorë dhe mbi dhjetë grupe të organizuara (nxënës, mësimdhënës, shkolla, kolegje etj.) Njësia e Kulturës, organizon edhe shumë aktivitete edhe të disiplinave të tjera, si: koncerte, takime letrare, promovime, festivale, manifestime kulturore etj. dhe vetëm në këtë vit numërohen afro njëqind aktivitete të këtij lloji.

Nëse i kalkulojmë të gjitha aktivitetet kulturore të organizuara nga kjo drejtori, si dhe aktivitetet në bashkëpunime, na del se gjatë vitit 2024 janë organizuar **160 aktivitete kulturore konkrete**, pa përfshirë këtu vizitat grupe të shumta, takimet dhe organizime të tjera të pavarura.

Biblioteka e Qytetit “Sadik Tafarshiku” u pasurua me 187 tituj të rinj, me vizita të vazhdueshme dhe realizon në çdo vit kalendarik afërsisht 20 aktivitete.

Spektori i Sportit - Në objektet sportive që menaxhohen nga Spektori i Sportit u realizuan gjithsej 6194 orë stërvitore, 268 lojë kampionale, 6 lojë për kupë, 2 lojë ndërkombëtare dhe 15 lojë miqësore. Ndërsa aktivitete e realizuara për data dhe ngjarje të veçanta shtetërore e sportive, janë mbi 30 aktivitete.

Spektori i Rinisë - Ndërsa në Spektoriin e Rinisë janë të realizuara mbi 40 aktivitete rinore. Vlen të theksohet se u hartua “Strategjia për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë për vitin 2024-2029” dhe “Plani i Veprimit për Rininë 2024-2027”.

Me përfshirjen e të gjithë sektorëve të DKRS-se në Ferizaj, janë realizuar mbi **250 aktivitete kulturore, rinore dhe sportive**, pa përfshirjen e vizitave, takimeve, garave e organizime tjera.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2024

Kemajl Emini
Drejtore i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, paraprakisht ka bërë një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm të punëve dhe aktiviteteve të zhvilluara në vitin paraprak, me qëllim të identifikimit të të gjitha sfidave që do të merren si bazë në përcaktimin e objektivave kryesore për vitin 2024, për Sektorin e Shëndetësisë dhe Shtëpinë Bazë në Komunitet për Persona me Aftësi të Kufizuara Mendore.

SEKTORI I SHËNDETËSISË

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka vlerësuar si të domosdoshme mbajtjen e takimeve konsultuese me strukturat udhëheqëse të QKMF-së, Këshillin Drejtues, Këshillin Profesional si dhe udhëheqës të njësive për përcaktimin e objektivave.

Konkluzion i përbashkët ishte se bazë e përcaktimit të objektivave për vitin 2024, do të jetë buxheti që kemi, duke u fokusuar në objektivat më të domosdoshme në Kujdesin Parësor Shëndetësor që drejtpërsëdrejti do të reflektonin në nivelin e ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore për një mirëqenie shëndetësore më të mirë për qytetarët tanë.

Gjatë vitit 2024 në DSHMS, respektivisht Sektorin e Shëndetësisë, angazhim permanent ishte zhvillimi i politikave shëndetësore konform infrastrukturës ligjore në fuqi, që rregullon sferën e Kujdesit Parësor Shëndetësor, duke qenë të përkushtuar në ndërmarrjen e veprimeve për një funksionalizim të mirëfilltë të QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve, me të vetmin qëllim që qytetarëve tanë t'u ofrohen shërbime shëndetësore sa më dinjitoze dhe cilësore.

Jemi të vetëdijshëm se edhe përkundër përkushtimeve tona mbetet ende për tu bërë, ndaj angazhimi ynë do të jetë i përhershëm edhe përkundër që shpeshherë po përballemi me sfida jo të tej kalueshme, si furnizimi jo i mjaftueshëm me barna esenciale nga Ministria e Shëndetësisë. Kjo është arsyeja që jemi angazhuar të gjejmë alternativa të tjera që nga të hyrat nga participimi të furnizohemi me barna esenciale që sado pak t'i mbështesim qytetarët tanë.

Një sfidë e vazhdueshme është gjithashtu, mungesa e ligjit mbi sigurimet shëndetësore që pamundëson një sistem të mirëfilltë shëndetësor.

DSHMS është transparente për punën dhe aktivitetet që zhvillon kundrejt hierarkisë institucionale lokale dhe qendrore, ashtu si edhe ndaj qytetarëve. DSHMS-ja për vitin 2024 ka pasur në dispozicion mjete financiare si kategori e subvencioneve gjithsej 200,000.00 €, për përkrahje të rasteve më të rënda me shuma simbolike përballë nevojave dhe kostove për trajtime shëndetësore, për mbështetje të një hershme si ndihmë momentale.

Pasqyrim i transparencës është edhe bashkëngjitja në vazhdim e raportit njëvjeçar të punës QKMF-së si dhe raportin e SHBK-së.

RAPORT PUNE QKMF

Shkurtesat

AMC – Action for Mothers and Children

AMF – Ambulanca e Mjekësisë Familjare

AMFK - Asociacioni i Mjekëve Familjarë të Kosovës

CDF – Community Development Found

DAT - Dispanseri Antituberkular

DMF – Departamenti i Mjekësisë Familjare

DShMS - Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

ESP - Edukimi Specialistik Postdiplomik

EPSh – Edukimi dhe Promovimi Shëndetësor

EVP - Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

IKShPK – Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës

IRShPK – Instituti Rajonal i Shëndetit Publik të Kosovës

KAN – Kujdesi Antenatal

KD – Këshilli Drejtues

KP – Këshilli Profesional

KPSh – Kujdesi Primar Shëndetësor

MF – Ministria e Financave

MRCPG – Medical Royal College of General Practitioners

MSh - Ministria e Shëndetësisë

OBSH - Organizata Botërore e Shëndetësisë
OIK - Oda e Infermierëve të Kosovës
QKMF – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
OMK – Oda e Mjekëve të Kosovës
QMF – Qendra e Mjekësisë Familjare
QTMF – Qendra Trajnuese e Mjekësisë Familjare
QZhVP – Qendra për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional
SISh - Sistemi Informativ Shëndetësor
ShEP - Shërbimi Emergjent Primar
UNHCR - United Nations High Commissioner for Refugees
UNICEF - United Nations International Children's Emergency Found
ZhVP - Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional

HYRJE

Personeli i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare e filloi vitin 2024 me angazhimet e nevojshme me qëllim të përmbushjes së obligimeve dhe detyrave të punës. Që në ditët e para të vitit 2024, puna filloi me ritmin e zakonshëm nëpër të gjitha QMF – të dhe AMF – të, për të vazhduar më tej me synim të intensifikimit. Si gjithmonë, përkushtimi ndaj organizimit të punës dhe eliminimi i ngecjeve eventuale, kanë qenë preokupim i vazhdueshëm i stafit menaxhues dhe hap imediat drejt përmbushjes së objektivave të paracaktuara për këtë vit, të cilat janë:

- Menaxhimi i burimeve njerëzore;
- Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe performancës në punë në KPSH;
- Monitorimi i vazhdueshëm i standardeve bazike në KPSH;
- Koordinimi i punëve në Edukimin dhe Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional;
- Zonimi dhe listimi i pacientëve për mjekë;
- Kujdesi për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien në punë të të gjithë të punësuarve;
- Funksionalizimi i laboratorëve në QMF 6 në fshatin Pleshinë dhe QMF 7 në fshatin Neredime si dhe ofrimin e shërbimit të vaksinimit;
- Shtimi i llojeve të analizave në laboratorin e QKMF-së;
- Furnizimi me pajisje mjekësore, stomatologjike;
- Furnizimi me dy autoambulanca të reja;
- Krijimi i një plan-strategjie për shtimin e numrit të specialistëve të rinj në Mjekësi Familjare;
- Renovimi i objekteve shëndetësore;
- Vazhdimi i botimit të numrave të tjerë të revistës Kujdesi Shëndetësor;

- Vazhdimi i implementimit të tërësishëm të SISH-it dhe programit të SMSF-së dhe modulit të vaksinimit në bazë të SISH-it;
- Fillimi i ndërtimit të dy objekteve të QMF – ve në Rakaj dhe në Koshare.
- Propozimi për plotësim-ndryshimin e Draft-Statutit Unik të QKMF-së, të Ministrisë së Shëndetësisë, të datës 20.10.2020 dhe dërgimi për aprovim në Komunë.

Aktivitetet dhe takimet

Më 31.01.2024 - Në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit për kancerin e qafës së mitrës, në QTMF u mbajt ligjërata “Kanceri i qafës së mitrës – parandalimi përmes vaksinës HPV”. Të pranishmit, mjekë familjarë dhe mjekë të përgjithshëm u informuan hollësisht lidhur me rëndësinë që ka vaksina HPV në parandalimin e kancerit të qafës së mitrës, vaksinë kjo e cila është shtuar së fundi në kalendarin e rregullt të vaksinimit dhe u jepet vajzave në klasën e gjashtë.

Më 16.02.2024 - U publikua njoftimi për fillimin e aplikimit të vaksinës Human Papilloma Virus te nxënëset e klasave të 6-ta, në të gjitha shkollat e Komunës së Ferizajt nga data 20 shkurt. Ndërkohë, pas njoftimit të drejtorëve të shkollave përkatëse, prindërve dhe mësimdhënësve, nisën punën ekipet e vaksinimit.

Më 29.02.2024 - Ekipet e Grupit për Promovim dhe Edukim Shëndetësor filluan projektin për realizimin e vizitave sistematike në shkollat fillore të Komunës së Ferizajt me qëllim të vlerësimit të defekteve të boshtit kurrizor, problemeve me shqisën e të pamurit, higjienës së përgjithshme trupore dhe patologjive të tjera, si dhe vizitat sistematike për vlerësimin e shëndetit oral, higjienës orale dhe ofrimin e këshillave për parandalimin e kariesit të dhëmbit te nxënësit. Në projekt përfshihen nxënësit e grup moshave 6 vjet dhe 10 vjet (klasa e parë dhe e pestë) ndërsa ekipet përbëhen nga: mjeku familjar me infermierë, oftalmologu, fiziatr, fizioterapeuti dhe stomatologu me asistenten. Në vizitat e ditës së parë ishin të pranishëm edhe menaxhmenti i QKMF-së, koordinatorja për edukim dhe trajnerja e infermierisë familjare.

Më 20.03.2024 - Në Ditën Ndërkombëtare të Shëndetit Oral, ekipet e Grupit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor të QKMF - Ferizaj, Sektori i Shëndetit Oral, vizituan kopshtet e fëmijëve “Ardhmëria jonë” dhe “Engjujt”. Me këtë rast ekipet i këshilluan fëmijët për rëndësinë e shëndetit oral dhe bënë demonstrimin praktik të teknikave të drejta të pastrimit të dhëmbëve duke i angazhuar edhe fëmijët në këtë aktivitet. Po ashtu, në QMF 8 në Dardani në ordinancën stomatologjike ishin për vizitë nxënësit e klasës së parë, të shkollës fillore "4 Prilli" nga fshati Zllatar. Ndërsa në QMF 6 në Pleshinë në ordinancën stomatologjike ishin për vizitë nxënësit e klasës së tretë të shkollës fillore "Naim Frashëri" - Zaskok.

Më 02.04.2024 - Për nder të Ditës Botërore të Mbrojtjes së Ambientit, në shkollën e fshatit Prelez u mbajt një ligjëratë nga infermierët e Ekipit të Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor të QKMF-së. Nxënës dhe arsimtarë nga kjo shkollë e ndoqën me interesim të madh ligjëratën e sotme dhe shprehën interesim që edhe në të ardhmen të ketë ligjërata nga edukimi dhe promovimi shëndetësor në këtë shkollë si dhe në komunitet.

Më 17 Prill - Nën organizimin e Drejtorisë së SHMS dhe të QKMF-së ,në QT u mbajt Tryezë pune me temën “Reagimi i Emergjencave Shëndetësore të Regjionit të Ferizajt në raste emergjente”. Në këtë takim krahas nikoqirëve morën pjesë edhe drejtorë të DSHMS-ve, menaxhmentet e QKMF-ve nga Kaçaniku, Shtimja, Vitia, Hani i Elezit, SP, FSK dhe Policia e Kosovës. Me ç ‘rast është prezantuar Plani i ushtrimit fushor të emergjencës për datën 14.06.2024

në QKMF drejtuar MSH-së, me të cilën kërkohen 90 punëtorë shtesë të profileve të ndryshme: 16 -mjekë të përgjithshëm, 6 -stomatologë, 35 - infermierë të përgjithshëm, 5 - teknikë të farmacisë, 5 - teknikë laborantë, 5 teknikë të rëntgenit, 6 - asistente të stomatologut, 2 teknikë dentarë, 5 - vozitës dhe 5 - mirëmbajtës.

Më 22.04.2024 - Në QTMF filloi programi i ligjëratave nga Edukimi i Vazhdueshëm Profesional për infermierë që brenda vitit do të realizoj gjithsej 10 ligjërata me nga dy sesione secila, në mënyrë që të marrin pjesë të gjithë infermierët e interesuar.

Më 26.04.2024-Në Javën Botërore të Vaksinit, shërbimi i vaksinit të QKMF-së ka zhvilluar një sërë aktiviteteve si:

Në QMF-VII në Neredime është hap një pikë e re e vaksinit të rregullt, janë mbajtur ligjërata me nxënës të shkollave të komunës dhe në fshatin Dubravë, për rëndësinë e vaksinit në bazë të kalendarit si dhe te vajzat te klasat e gjashta, vaksinimi me vaksinë HPV për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës.

Më 10.05.2024- Për Ditën Ndërkombëtare të Infermierisë 12- Maj, është mbajtur tryeza profesionale “Infermiera sot” , infermierë nga QKMF-Ferizaj , Kaçanik, dhe Spitali i Përgjithshëm prezantuan punime shkencore të lëmisë së infermierisë. Punimet nga QKMF –Ferizaj (tri punime) u vlerësuan nga paneli si me të përgatiturat profesionalisht, për prezantuesit e këtyre punimeve u ndanë mirënjohje nga drejtoria e QKMF-së.

Më 14.06.2024 - Me aktivitete të shumta u shënuar 15 Qershori - Dita e Shëndetësisë në Ferizaj, duke filluar nga homazhet e stafit shëndetësor tek Kompleksi i Varrezave të Dëshmorëve në Ferizaj, homazhe tek obelisku në QKMF-Ferizaj dhe homazhe në Gurëz tek obelisku i Heroit të Kosovës Rexhep Bislimi.

Në këto aktivitete ka marrë pjesë edhe Kryetari i Komunës, Agim Aliu, Drejtori i DSHMS-së Dr. Kemajl Emini, menaxhmenti i QKMF-së, i SP dhe i institucioneve tjera shëndetësore.

Pas kësaj është bërë një ushtrim fushor me emergjencat e Rajonit të Ferizajt.

Më 20.06.2024 - Nën organizimin e administratës së QKMF-së, në QTMF –Ferizaj u mbajt takim profesional me administratat e QKMF-ve në nivel të vendit. Qëllimi i këtij takimi ishte adresimi i problemeve që kanë rrjedhur nga implementimi i Ligjit për Zyrtar Publik dhe Ligjit të Pagave dhe akteve të tjera nënligjore që në mënyrë diskriminuese e kanë trajtuar këtë sektor, si dhe nevoja e organizimit të një administrate moderne dhe efikase duke u bazuar në digjitalizim intensiv ,procese dhe teknika inovative

Me qëllim të harmonizimit dhe adresimit të këtyre problemeve në instancat më të larta, u formua një grup punues prej 7 përfaqësuesve të administratës së QKMF-ve.

Pjesëmarrësit e takimit më pas vizituan pikën 1 dhe 6 të UÇK-së në Parkun Memorial në fshatin Jezerc si dhe fenomenin natyror Bifurkacioni.

Më 18.07.2024: Komuna vazhdon të investoj ne mjekësinë ferizajase, veçanërisht në blerjen e dy autoambulancave, të cilat do të mundësojnë shërbime më efikase për qytetarët.

Më 07.08.2024: Filloi java e ushqyerjes me qumësht gjiri me moton "Të mbështesim gji dhënien" nga 01-07.08.2024, në klasën për nëna në QMF-1 nga infermieret e MF-2 u organizua aktiviteti, takim me nëna me fëmijë të vegjël dhe lehona, të cilat u këshilluan për rëndësinë e ushqyerjes me qumësht gjiri në zhvillimin e fëmijës dhe sistemin imunitar të tij.

Më 12.09.2024: U bë hapja e QMF-10 në fshatin Prelez të Muhaxherëve, e cila do t'iu shërbej me shërbime shëndetësore banorëve të këtij fshati dhe fshatrave përreth.

Më 30.09.2024: Në QKMF është shënuar Dita Ndërkombëtare e Zemrës.

Infermieret e QKMF-së, QMF-I dhe QMF-IV kanë bërë matje të tensionit arterial, këshillimin e pacientëve lidhur me shëndetin , parandalimin e sëmundjeve të zemrës dhe bënë shpërndarjen e fletëpalosjeve për Ditën Botërore të Zemrës.

Më 01.10.2024: U bë hapja e fushatës për Muajin Rozë, muajin e ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit, me moto "Zbulimi i hershëm shpëton jetë". Këtë muaj janë mbajtur një varg i gjatë i aktiviteteve nën patronatin e DSHMS në bashkëveprim me QKMF, SP, IKSHP dhe QMSH.

Nga ekipet e Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor janë mbajtur një sërë ligjëratash në komunitet, shkolla të mesme, shpërndarje të fletëpalosjeve, dhurimi i gjakut nga disa punëtorë të QKMF-së, mbajtja e ligjëratës qendrore me 15 Tetor në sallën e Kuvendit Komunal dhe përmbyllja e fushatës me marshin nëpër qytet deri në sheshin “Adem Jashari” për sensibilizim dhe ndërgjegjësim të popullatës për parandalim dhe zbulim të hershëm të kancerit të gjirit. Me 31 Tetor u bë përmbyllja e aktiviteteve nga DSHMS dhe QKMF.

Më 07.11.2024: U nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit midis Komunës së Ferizajt dhe Shoqatës së të Drejtave të Pacientëve që ka për qëllim themelimin dhe monitorimin e Këshillit të Pacientëve në QKMF-Ferizaj.

Më 22.11.2024: Kryetari i Komunës, Agim Aliu bashkë me Drejtorin e DSHMS-së Dr. Kemajl Eminin, vizituan QKMF-në, të pritur nga stafi menaxherial, e cila së fundmi ka hapur Muzeun e Bibliotekën në kuadër të saj, e pajisur me pajisje mjekësore të mjekëve ferizajas ndër vite, literaturë të shkencave mjekësore, dokumentacion të vjetër administrativ dhe materiale të tjera që e bëjnë këtë nismë të veçantë e unike në gjithë vendin.

Më 27.11.2024: Në fshatin Koshare u vendos gur themeli i objektit të ri të QMF-së, i cili do të shtrihet në sipërfaqe prej 260m2, i cili do të pajiset me pajisje mjekësore të nevojshme për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për banorët e këtij fshati dhe gjithë zonës përreth.

Më 04.12.2024: Objektit të ri të QMF-së në fshatin Prelez të Muhaxherëve nga ana e shoqatës “Qëndresa Kosovare” iu shtuan donacion një autoambulancë, pajisje laboratorike, EKG dhe sistemin e ngrohjes qendrore, të cilat plotësuan nevojat e QMF-së, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore për banorët e fshatit dhe të zonës përreth tij.

Më 20.12.2024:Në Ferizaj nën patronatin e DSHMS-së, me iniciativë të Këshillit Organizativ dhe me përkrahje të drejtoreshës së QKMF-së dhe sponsorizuar nga AQH e QKMF, u mbajt Simpoziumi i Parë i Administratave të QKMF-ve në nivel të Kosovës me moto „Fuqizimi i burimeve njerëzore për një të ardhme digjitale”, ku u theksua rëndësia e standardizimit të procedurave, fuqizimit të stafit administrativ dhe përmirësimit të infrastrukturës.

Qëllimi i këtij Simpoziumi ishte përmirësimi i efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve në QKMF përmes një platforme bashkëpunimi, diskutimi dhe inovacioni.

Numri i përgjithshëm i të gjitha shërbimeve shëndetësore në QKMF gjatë *dymbëdhjetë muhorit Janar-Dhjetor 2024* është **1 042 554** nga të cilat **245 639** janë vizita mjekësore, **760 637** shërbime infermierie dhe shërbime të tjera, **36 110** janë shërbime stomatologjike.

TRUPAT PROFESIONALE TË QKMF – së KËSHILLI DREJTUES DHE ZYRA E DREJTORIT

Këshilli Drejtues si organi më i lartë i udhëheqjes së QKMF – së, gjatë *periudhës Janar-Dhjetor* ka mbajtur dhjetë mbledhje, për të cilat janë mbajtur rregullisht procesverbalet, që pas aprovimit janë protokolluar dhe ruhen në arkiv. Në këto mbledhje ndër temat kryesore që u shqyrtuan ka qenë të lidhura me organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit të punës në QKMF.

Me 11.04.2024-Menaxhmenti i QKMF-së, në prani të personelit të QKMF-së, kanë pritur në takim donatorin nga Zvicra, Dr.Hofer Martin nga qyteti Interlaken dhe bashkatdhetarin Sami Bajramin. Me ç’rast për EP dhe stafin e saj u pranua donacioni në përbërje:6 monitorë me aksesore,60xhaketa,një barelë, imobilizatorë, mbajtëse për bombola të oksigjenit e aksesore të tjerë si dhe helmeta mbrojtëse për zjarrfikës.

Më 08.02.2024 - në mbledhjen e Këshillit Drejtues ku ishte i pranishëm edhe Komisioni për shqyrtimin e Draft-Statutit të QKMF-së, u dhanë propozimet për procedimin e mëtejme Draft-Statutit. Ndërsa në pjesën e dytë të mbledhjes u shqyrtua dhe aprovua kërkesa e KRU "Bifurkacioni" për pajisjen e punëtorëve me certifikata mjekësore.

Më 28-29-30.10.2024,në mbledhje të KD, u shqyrtua:

- **Hartimi dhe aprovimi i draftit të Planifikimit Përfundimtar të Prokurimit për vitin 2025 , si dhe**
- **Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft-Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës.**

KËSHILLI PROFESIONAL DHE ZYRA E KRYESHEFIT TË DMF (DEPARTAMENTIT TË MJEKËSISË FAMILJARE)

Zyra e Kryeshefit të Departamentit të Mjekësisë Familjare gjatë *dymbëdhjetë mujërit Janar-Dhjetor 2024* është angazhuar në menaxhimin e punës nëpër njësi, sistematizimin e personelit dhe përpilimin e kujdestarive. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur mbledhje të Këshillit Profesional me datat: 18.01.2024, 05.02.2024, 21.03.2024, 30.05.2024, 30.07.2024 në të cilat mbledhje shefat e njësive kanë raportuar për procesin e punës së kryer dhe janë shqyrtuar çështje të lidhura me mbarëvajtjen e punës nëpër njësi. Gjatë kësaj periudhe Kryeshefi i DMF ka marrë pjesë nëpër takime dhe aktivitete, krahas drejtoreshës dhe zv.drejtorit të QKMF-së, gjithashtu ka mbajtur dhe udhëhequr Takime të Këshillit Profesional gjatë të cilave është diskutuar rreth detyrave, angazhimeve dhe çështjeve të tjera thelbësore për rrjedhën e procesit të punës. Detyrë permanente e Zyrës së Kryeshefit edhe më tej mbetet angazhimi në monitorimin e mbarëvajtjes së procesit të punës dhe realizimit të objektivave në vijim:

1. Respektimi i orarit të punës nëpër njësi nga stafi shëndetësor dhe ai mbështetës;
2. Përpilimi i orareve për kujdestaritë e të dielave dhe festave;
3. Vizitat mbikëqyrëse nëpër njësitë e QKMF-së;
4. Takimet dhe kontaktet e vazhdueshme me shefat e njësive;
5. Vazhdimi i ligjëratave dhe trajnimeve për stafin shëndetësor.

Zyra e Kryeinfermierit

Shërbimet infermierike në QKMF përbëjnë mbi 75% të volumit të përgjithshëm të punës në këtë institucion, prandaj edhe kërkojnë një menaxhim serioz dhe përkushtim ndaj punës infermiore si tërësi, shumica e punëve në këtë institucion dhe cilësia e tyre varen nga përgatitja dhe profesionalizmi i punës së infermiereve.

Në QKMF shërbimet infermierike kryhen me përgjegjësi dhe disa nga këto shërbime udhëhiqen nga stafi infermior si p.sh.: Vizitat shtëpiake për të sëmurë kronikë dhe kujdesi paliativ, Shërbimi i vizitave shtëpiake për nëna dhe fëmijë, Kujdesi antenatal, Dispanzeri antituberkular etj. shërbime këto që edhe gjatë kësaj periudhe janë kryer me sukses dhe ne si institucion mund të mburremi me to.

Më 16.01.2024 - në mbledhjen e parë me kryeinfermiere të njësive është diskutuar plani i punës për vitin 2024, ku edhe janë caktuar edhe disa objektiva nga do të orientohet puna, si:

1. Menaxhimi i resurseve humane të stafit infermior në QKMF (për QMF dhe AMF)
2. Ngritja dhe aftësimi profesional i stafit infermior përmes trajnimeve dhe ligjëratave të EVP-së, të parapara për vitin 2022.
3. Trajnimi i stafit infermior për vizita paliative.
4. Perfeksionimi i shërbimeve infermiore nëpër njësi dhe ekupeve të vizitave në terren.
5. Vazhdimi i nxjerrjes së revistës Kujdesi Shëndetësor në kuadër të QKMF-së

6. Bashkëpunimi me koordinatorët për Edukim dhe Promovim Shëndetësor në organizimin dhe shënimin e ditëve të promocionit të shëndetit sipas datave të caktuara nga OBSH, në komunitet dhe në institucion.

Këto objektiva do të realizohen në bashkëpunim me drejtorinë e QKMF-së dhe në koordinim me të gjithë sektorët e QKMF-së.

Sfidë në vete për Zyrën e Kryeinfermierit është edhe planifikimi i punës praktike të stazhierëve në lëmin e infermierisë të shkollave të mesme të drejtimeve mjekësore, të Fakultetit të Infermierisë në UP, si dhe drejtimeve të infermierisë nga kolegjet me të cilat QKMF ka marrëveshje të shkruar.

Në nëntëmujorin Janar-Shtator janë regjistruar 234 studentë të infermierisë, kurse në vijim të stazhit janë edhe 69 praktikantë të infermierisë duke ndjekur stazhin në QKMF, QMF dhe njësitë e tjera të QKMF-së.

ZYRA PËR CILËSI DHE SIGURI TË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE

Krahas punës së përditshme me pacientë, Koordinatori i Cilësisë ka kryer edhe detyra të tjera në kuadër të përgjegjësisë së tij, si dhe ka marrë pjesë në takimet e Këshillit Drejtues dhe Këshillit Profesional, ku janë shqyrtuar çështje të ndryshme dhe janë marrë vendime në interes të institucionit tone.

Gjatë kësaj *periudhe-dymbëdhjetë mujore* Koordinatori i Cilësisë ka zhvilluar një varg aktivitete, si:

- Përgatitja e planit të punës për vitin 2024
- Përgatitja e formularit për secilin mjek për regjistrimin e të dhënave të referimeve të jashtme (konsultative dhe diagnostike), terapia i.m dhe i.v., përshkrimi i terapisë parenterale nga jashtë qendrës, përshkrimi i antibiotikëve oralë dhe parenteral dhe numri i pacientëve për muajin e caktuar.
- Përgatitja e listës të 57 mjekëve, të cilët kanë punuar gjatë muajit Nëntor 2023 lidhur me përshkrimin e antibiotikëve.

I. DEPARTAMENTI I MJEKËSISË FAMILJARE

Departamenti i Mjekësisë Familjare, me shtrirjen e aktivitetit nëpër Qendrat e Mjekësisë Familjare në të gjitha nivelet, ka vazhduar angazhimet drejt realizimit të objektivave të veta mbi shëndetin, për të gjithë banorët e komunës sonë, aktivitete këto që bëhen duke respektuar gjithnjë politikat lokale për shëndetësi të referuara nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (Sektori i Shëndetësisë) dhe Ministria e Shëndetësisë, të bazuara në ligjet dhe rregulloret administrative në fuqi.

Departamenti i Mjekësisë Familjare gjatë *dymbëdhjetë muajit Janar-Dhjetor*, si gjithnjë funksionimin e vet e ka përqendruar në kryerjen e shërbimeve të përhershme: Shërbimet konsultative nga mjeku i përgjithshëm, mjeku familjar dhe specialistët e tjerë (fiziatri, oftalmologu), shërbimet e shëndetit oral, shërbimet infermierike, shërbimet preventive (edukimi, vaksinimi, KAN-i, vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë, Qendra informuese për shëndetin e gruas), shtëpiake, emergjente dhe diagnostike (EKG, ECHO, shërbimet laboratorike, shërbimet rëntgenologjike).

Raporti në vazhdim jep një pasqyrë të detajuar të punës dhe angazhimeve të personelit shëndetësor në Departamentin e Mjekësisë Familjare.

1. SHËRBIMET MJEKËSORE

Shërbimet mjekësore kërkojnë një bashkëpunim të ngushtë mes mjekëve dhe infermierëve, krahas përgjegjësisë dhe shkallës së lartë të përgatitjes profesionale. Gjatë punës dhe aktivitetit të përditshëm të mjekëve dhe infermierëve bëhen përpjekje të vazhdueshme për të ofruar shërbime shëndetësore me cilësi të lartë për të gjithë qytetarët e komunës sonë dhe më gjerë.

Numri i shërbimeve dhe mbarëvajtja – Rezultatet e punës për *dymbëdhjetë mujorin Janar-Dhjetor*, në Departamentin e Mjekësisë Familjare të QKMF – së, mund të radhiten sipas qendrave dhe sektorëve, me sa vijon:

- **Në QKMF:** janë ofruar shërbime **215662** shëndetësore, prej tyre **58676** janë vizita mjekësore kurse shërbime infermierie **1596986**.
- **Në QMF 1:** janë kryer **144218** shërbime shëndetësore, prej tyre **41128** janë vizita mjekësore, kurse **103090** shërbime infermierie.
- **QMF 2:** janë kryer shërbime **7636** shëndetësore, prej tyre **2131** janë vizita mjekësore kurse **5506** janë shërbime infermierie dhe të tjera.
- **QMF 3 - Greme:** janë kryer **22379** shërbime shëndetësore, prej tyre **6381** janë vizita mjekësore kurse **15998** janë shërbime infermierie.
- **QMF 4:** janë kryer **140933** shërbime shëndetësore, prej tyre **40231** janë vizita mjekësore kurse **100702** shërbime infermierie.
- **QMF 5 - Komogllavë:** janë kryer **16320** shërbime shëndetësore, prej tyre **4842** janë vizita mjekësore kurse **11478** shërbime infermierie.
- **QMF 6 - Pleshinë:** janë kryer **13002** Shërbime shëndetësore, prej tyre **4022** vizita mjekësore dhe **8980** shërbime infermierie.
- **QMF 7 - Neredime:** janë kryer **8726** shërbime shëndetësore, prej tyre **2775** vizita mjekësore dhe **5951** shërbime infermierie.
- **QMF 8 - Dardani:** janë kryer **15194** shërbime shëndetësore, prej tyre **4486** vizita mjekësore dhe **10708** shërbime infermierie.
- **QMF 9 - Softaj:** janë kryer **9749** shërbime shëndetësore, prej tyre **3262** vizita mjekësore dhe **6487** shërbime infermierie.
- **QMF 10- Prelez:** janë kryer **2104** shërbime shëndetësore, prej tyre **716** vizita mjekësore dhe **1388** shërbime infermierie.
- **AMF –të** – janë kryer **6898** shërbime shëndetësore, prej tyre **2029** vizita mjekësore kurse **4869** shërbime infermierie.
- **KUJDESTARIA E NATËS** – si njësi që funksionon në kuadër të Shërbimit Emergjent Primar në QKMF, ka ofruar gjithsejtë **69412** shërbime shëndetësore, nga të cilat **36290** vizita mjekësore dhe shërbime infermierie **33122**.

- **KUJDESTARIA E TË DIELAVE** – ka kryer gjithsej **43003** shërbime, prej të cilave **28221** vizita mjekësore dhe **147282** shërbime infermierie. Prej tyre **19661** shërbime shëndetësore janë ofruar në **QSHEP** dhe **8560** në **QMF 1**

Tabela 4. Numri i shërbimeve në të gjitha QMF-të dhe AMF-të

Qendra	Numri i vizitave mjekësore	Numri i shërbimeve infermierie	Numri i përgjithshëm i shërbimeve
QKMF	58676	156986	215662
QMF 1	41128	103090	144218
QMF 2	2131	5506	7636
QMF 3 - Greme	6381	15998	22379
QMF 4	40231	100702	140933
QMF 5 - Komogllavë	4842	11478	16320
QMF 6 - Pleshinë	4022	8980	13002
QMF 7 - Neredime	2775	5951	8726
QMF 8 - Dardani	4486	10708	15194
QMF 9 - Softaj	3262	6487	9749
QMF 10-Prelez	716	1388	2104
AMF - të	2029	4869	6898
Kujdestaria e natës	36290	33122	69412
Kujdestaria e të dielave	28221	14782	43003

2. SHËRBIMET DIAGNOSTIKE

2.1. Njësia e laboratorit

Personeli i laboratorëve në pesë qendrat ka ofruar shërbime të vazhdueshme, në këta laboratorë janë kryer shumica e analizave të nevojshme për diagnostikim, numri i përgjithshëm i të cilave gjatë *këtij dymbëdhjetë muaji* arrin në **152328** analiza, prej të cilave **138278** janë analiza gjaku dhe **14050** analiza urine.

Tabela 5. Numri i shërbimeve në laboratorët e qendrave

Laboratorët në qendra	Analiza urine	Analiza gjaku	Gjithsej
QKMF	10208	111017	121225
QMF 1	2323	15460	17783
QMF 2	0	0	0
QMF 3 (Greme)	333	2892	3225
QMF 4	745	6187	6932
QMF 8 - Dardani	400	2674	3074
QMF 9 - Softaj	41	48	89
Totali	14050	138278	152328

2.2. Njësia e radiologjisë

Njësia e Radiologjisë në kuadër të QKMF-së është e ndarë në gjashtë kabinete: RTG në DAT, RTG digjital në SHEP, RTG dental, Mamografia dhe kabineti i radiologes i pajisur me aparat të ultrazërit. Shërbimet e kryera gjatë *periudhës dymbëdhjetë mujore Janar-Dhjetor* në këtë njësi janë paraqitur në tabelën vijuese:

Tabela 6. Shërbimet në Kabinetin e RTG-së

Shërbimet	Numri i shërbimeve
Vizita specialistike radiologjike	3862
Radiografia të ekstremiteteve	9754
Radiografi të mushkërive	2265
Radiografi e dhëmbit	0
Echo	306
Mamografi eksponime	3106
Mamografi lexim	418
Gjithsej	19711

3. DISPANZERI I SËMUNDJEVE TË MUSHKËRIVE

Në DAT gjatë këtij *dymbëdhjetë mujori* janë ofruar gjithsej **5235** shërbime. Pas ekzaminimit të rasteve të dyshuara, janë diagnostikuar **61** raste të reja me TB, **42** me TBC pulmonare dhe **19** me TBC ekstra pulmonare.

Tabela 7. Shërbimet në Dispanserinë Antituberkular

Shërbimet	Numri
Vizita specialitike	1314
Patronazh (edukim shëndetësor)	1434
Përpunim i kontaktit	233
Baciloskopi	792
BK+	46
Laborator (Se)	49
PPD	495
Vizita shtëpiake	217
Inhalime	31
Testi i HIV-it	48
Punktate	20
Gen Expert	149
Matja e peshës	407
Gjithsej	5235

4. SHËRBIMET PREVENTIVE

Në shërbimet preventive, që nënkuptojnë promovimin e shëndetit në komunitet, bëjnë pjesë dy njësi të QKMF – së:

- a) Edukimi shëndetësor dhe
- b) Vaksinimi.

Të dyja këto njësi ofrojnë shërbime nëpër shkolla dhe në komunitet dhe organizojnë punën nëpërmjet ekipeve përkatëse.

4.1. Edukimi shëndetësor

Nisma e angazhimeve për anëtarët e Grupit të Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor gjatë këtij *dymbëdhjetë mujori*, filloi me realizimin e objektivave të përcaktuara në drejtim të:

- Zhvillimit të aktiviteteve promovuese edukative për përparimin e shëndetit të popullatës së Ferizajt,
- Zhvillimit të aktiviteteve promovuese të shëndetit në respektim të Ditëve Ndërkombëtare sipas kalendarit për Ditët Ndërkombëtare.

Më 20.03.2023 - Ekipet e Sektorit të Stomatologjisë të QKMF Ferizaj, filluan aktivitetet për shënimin e “Ditës Botërore të Shëndetit Oral”. Aktivitetet, përmes demonstrimit praktik të mënyrës së higjienës së duhur të dhëmbëve dhe këshillave edukuese u zhvilluan me grupin e nxënësve parashkollorë, në dy kopshtet e fëmijëve: “Ardhmëria jonë” dhe “Engjujt”. Përmes aktiviteteve të tilla, që organizohen çdo vit, Sektori i Stomatologjisë synon të sensibilizoj nxënësit për rëndësinë e shëndetit oral dhe të sanoj gjendjen në drejtim më të kënaqshëm në këtë segment.

Më 25.03.2024 - Me moton “Po! Mund t'i japim fund tuberkulozit”, në nder të “Ditës Botërore kundër Tuberkulozit”- në QKMF u zhvilluan aktivitete të ndryshme me qëllim të ngritjes së vetëdijes, në mesin e popullatës, për pasojat e rënda shëndetësore, sociale dhe ekonomike që ka tuberkulozi, si dhe të shtohen angazhimet për t'i dhënë fund epidemisë globale të tuberkulozit.

Grupi i Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor në bashkë koordinim me stafin profesional shëndetësor nga DAT-i, realizuan aktivitete në disa dimensione.

- Aktivitetet me rol edukativo- promovues në formë të ligjëratave vetëdijësuese mbi këtë sëmundje u zhvilluan me nxënësit e shkollës fillore “Jeronim de Rada” dhe në shkollën e mesme “Zenel Hajdini”.

- Testimi me tuberkulinë në formë skreningu, në vlerësim të identifikimit të rasteve të mundshme me tuberkuloz në popullatën e fshatit Dubravë, si dhe në klientët e Qendrës Rehabilituese në Shtime, nga stafi profesional i Dispanzerit Antituberkular të QKMF-së.

- Në Qendrat e Mjekësisë Familjare janë shpërndarë fletëpalosje me këshilla dhe udhëzime rreth parandalimit dhe trajtimit të sëmundjes së tuberkulozit.

Përgjatë një jave, aktivitetet u zhvilluan me të vetmin qëllim që sa më mirë dhe në përfshirje më të gjerë, të bëhet avokim vetëdijesues për shëndetin dhe mirëqenien, janë shpërndarë informata mbi rëndësinë e sëmundjes, me objektiv të qartë për të arritur sensibilizim më të gjerë me grupet më vulnerabile, për të përmbushur misionin në luftë kundër tuberkulozit. Gjatë këtij tremujori, grupi për Edukim dhe Promovimi Shëndetësor ka zhvilluar aktivitetet e planifikuara për vizitat sistematike të nxënësve në klasën e parë dhe të pestë nga ekipet e mjekësisë familjare, stomatologjia, fiziatra dhe oftalmologjia.

Këto vizita ishin të fokusuar në vlerësimin e higjienës; ekipi i stomatologjisë realizoi kontrollin stomatologjik në vlerësimin e shëndetit oral; ekipi nga fiziatra vlerësoi posturën dhe gjendjen e shtyllës kurrizore me qëllim të identifikimit të hershëm të çrregullimeve në këtë fushë, ndërsa ekipi nga oftalmologjia realizoi vizita oftalmologjike, për të identifikuar problemet e nxënësve me shikimin.

Pas çdo ekzaminimi ekipet mjekësore ofruan sugjerimet dhe këshillat e nevojshme për nxënësit duke ndihmuar në edukimin e tyre shëndetësor rreth mirëmbajtjes së higjienës trupore e orale, dhe në veçanti nxënësit pranuan këshillat e qëndrimit të drejtë trupor dhe ata nxënës të identifikuar me probleme në sy u referuan për trajtim të më tutjeshëm.

Po kështu u realizuan edhe vizitat sistematike të nxënësve të shkollave fillore të Ferizajt.

4.2. Shërbimi i vaksinimit

Gjatë këtij *dymbëdhjetë mujori Janar-Dhjetor* në Shërbimin e Vaksinimit në të gjitha QMF-të dhe AMF-të, janë dhënë gjithsej **29519** vaksina.

Tabela 8. Vaksinimi sipas qendrave

Qendra	Vaksinat nëpër njësi
QKMF	18151
QMF 1	3227
QMF 2	3396
QMF 3 - Greme	1049
QMF 4	1182
QMF 5 - Komogllavë	279
QMF 7-Neredime	269
QMF 8- Dardani	597
QMF 9-Softaj	931
KBR	48
Nxënës	263
AMF - të	127
Gjithsej:	29519

4.3. Qendra Informuese për Shëndetin e Gruas

Në Qendrën Informuese për Shëndetin e Gruas në QMF 2, gjatë *këtij dymbëdhjetë mujori* janë ofruar gjithsej **180** shërbime, ku përfshihen trajnimet individuale dhe grupore, për gra shtatzëna dhe familjet e tyre.

4.4. Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë 0 deri 3 vjeç

Shërbimi i Vizitave Shtëpiake për Nëna dhe Fëmijë gjatë *këtij dymbëdhjetë mujori*, ka ofruar **3984** vizita që janë tejet të rëndësishme për ruajtjen e shëndetit të nënave dhe fëmijëve, ushqyeshmërinë e shëndetshme të fëmijëve dhe parandalimin e sëmundjeve të ndryshme apo identifikimin e hershëm të tyre.

Tabela 9. Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë 0 deri 3 vjeç

5.	Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë 0 deri 3 vjeç	Numri i shërbimeve
	QKMF	1503
	QMF 1	643
	QMF 2	617
	QMF 3 - Greme	36
	QMF 4	745
	QMF 8 - Dardani	89
	QMF 9 - Softaj	318
	GJITHSEJ	3984

SHËRBIMET EMERGJENTE

Shërbimi emergjent si njësi në kuadër të QKMF-së, gjatë *dymbëdhjetë mujorit Janar-Dhjetor* ka intervenuar në **5245** raste emergjente.

Tabelat në vijim përfshijnë në mënyrë të përmblëdhur rezultatet e punës në Shërbimin Emergjent Primar.

Tabela 10. Shërbimet emergjente primare

Shërbimet emergjente	Numri i rasteve
Emergjencat internistike	300
Emergjencat infektive	1
Emergjencat kirurgjike	68
Emergjencat pediatrike	4
Emergjencat gjinekologjike	17
Emergjenca toksikologjike	44
Emergjencat neurologjike	335
Emergjencat psikiatrike	242
Emergjencat geriatrike	1294
Dhimbje akute	1353
Trauma në komunikacion	589
Trauma të tjera	96
Djegje, mërdhitje, mbytje në ujë	0
Vetëvrasje me armë	0
Vetëvrasje me mjete kimike	2
Verifikim i vdekjes	366
Sëmundje malinje	465
Emergjencat ortopedike	69
GJITHSEJ	5245

Pacientët tek të cilët intervenohet jo gjithëherë vazhdojnë trajtimin në QKMF, një numër i tyre dërgohen edhe nëpër institucionet e tjera brenda ose jashtë qytetit, varësisht nga gjendja e tyre shëndetësore dhe mjekimi që duhet t'u ofrohet.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat lidhur me vazhdimin e mëtejshëm të trajtimit të tyre.

Tabela 11. Trajtimi i pacientëve pas ndihmës emergjente

Të trajtuar në:	
QKMF	176
Shtëpi	2925
Aksident komunikacioni	589
Të transportuar në:	
Spital – Ferizaj	839
QKUK	14
Polici	254

Tabela në vijim paraqet shërbimet e tjera që ofrohen në objektin e SHEP.

Tabela 12. Shërbimet e tjera në SHEP

Shërbimet e tjera	Numri
Vizita mjekësore	861
EKG	1146
Therje intramuskulare	1016
Therje intravenoze	0
Infuzione	17290
Lidhtore	672
Kateterizime	152
Reanimime	508
Matja e glikemisë	380
Totali	22525

6. KUJDESI SHTËPIAK PALIATIV

Në kuadër të kujdesit shtëpiak si njësi që funksionon në katër QMF – të, realizohen vizitat shtëpiake paliative me një staf të përgatitur mirë që tregon suksese në përmbushjen e obligimeve të punës, përkundër faktit që kjo punë bëhet nëpër shtëpitë e pacientëve të cilët janë në gjendje shumë të rëndë dhe të palëvizshëm. Gjatë *dymbëdhjetë mujorit Janar-Dhjetor* janë kryer gjithsej **6770** vizita shtëpiake.

Tabela 13. Shërbimet e Kujdesit Shtëpiak

Kujdesi shtëpiak	Numri i shërbimeve
QKMF	2220
QMF 1	1525
QMF 2	280
QMF 4	2528
DAT-i	217
GJITHSEJ	6770

KUJDESI SHËNDETËSOR ANTENATAL (KAN)

Kujdesi shëndetësor antenatal realizohet në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare, ku gjenden dhomat për Kujdesin antenatal (KAN) të cilat udhëhiqen nga infermieret e trajnuara për këtë qëllim, që bashkë me mjekun, përcjellin tek pacientet periudhën e shtatzënisë dhe lehonisë. Raporti i këtij shërbimi për *dymbëdhjetë mujorin Janar-Dhjetor* është **4872** vizita.

Tabela 14. Shërbimet e Kujdesit Antenatal

Kujdesi Antenatal	Numri i shërbimeve
QKMF	1241
QMF 1	40
QMF 2	31
QMF 4	3560
AMF	0
GJITHSEJ	4872

AMBULANCAT E MJEKËSISË FAMILJARE

Në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare funksionojnë pesë Ambulanca të Mjekësisë Familjare në fshatrat: Mirash, Varosh, Gaçkë, Llojza dhe Talinoc, ndërsa në Greme, Komogllavë, Pleshinë, Neredime, Dardani dhe Softaj funksionojnë QMF 3, QMF 5, QMF 6, QMF 7, QMF 8, QMF 9 dhe nga data 12.09.2024 edhe QMF-10 në fshatin Prelez të Muhaxherëve kur u bë edhe përrurimi i saj, e cila do t'iu shërbej me shërbime shëndetësore banorëve të këtij fshati dhe fshatrave përreth.

9. NJËSIA E FARMACISË

Njësia e farmacisë gjatë *dymbëdhjetë mujorit Janar-Dhjetor* ka vazhduar punën e saj në distribuimin dhe disperzimin e barnave dhe materialit medicinal. Depoja qendrore pranë QKMF - së furnizohet nga: Ministria e Shëndetësisë - Divizioni i Farmacisë; Operatori ekonomik dhe Donacionet.

a) Furnizim i rregullt nga Depoja Qendrore e Ministrisë së Shëndetësisë:

Furnizimi nga MSh për këtë vit kalendarik bëhet një herë në tre muaj)

Tabela 15. Furnizimi nga Depoja Qendrore në MSH

Nr.	Numri i faturës	Vlera	Furnizuesi	Data
1	2/2024	677.10	Divizioni i Farmacisë	02/07/2024
2	1/2024	20,525.60	Divizioni i Farmacisë	04/07/2024
3	3/2024	324.87	Divizioni i Farmacisë	12/07/2024
4	67/2024	1,985.00	Divizioni i Farmacisë	09/07/2024
5	14/2024	563.70	Divizioni i Farmacisë	16/07/2024
6	15/2024	1.08	Divizioni i Farmacisë	15/07/2024
7	11/2024	275.15	Divizioni i Farmacisë	05/08/2024
8	16/2024	1,985.00	Divizioni i Farmacisë	14/08/2024

9	19/2024	1,355.00	Divizioni i Farmacisë	23/09/2024
10	17/2024	6,423.88	Divizioni i Farmacisë	09/09/2024
11	18/2024	33.00	Divizioni i Farmacisë	13/09/2024
12	23/2024	21,909.60	Divizioni i Farmacisë	09/12/2024
13	24/2024	21,456.00	Divizioni i Farmacisë	10/12/2024
14	21/2024	126.00	Divizioni i Farmacisë	11/10.2024
15	20/2024	48,821.51	Divizioni i Farmacisë	02/10.2024
16	22/2024	346.21	Divizioni i Farmacisë	18/11/2024

b) Furnizimi nga operatori ekonomik

Tabela 16. Furnizimi nga operatori ekonomik MADEKOS

Nr.	Numri i faturës	Vlera	Furnizuesi	Data
1	285-24	901.53	Madekos	01/08/2024
2	384-24	3663.60	Madekos	01/08/2024
3	754/24	257.38	Madekos	26/11/2024
4	753/24	2968.00	Madekos	26/11/2024
5	826/24	85.75	Madekos	27/12/2024
6	825/24	2898.00	Madekos	27/12/2024

Tabela 17. Furnizimi me material stomatologjik nga Operatori Ekonomik Alfadent

Nr.	Numri i faturës	Vlera	Furnizuesi	Data
1	121224001-2	9,136.00	Madekos	12/12/2024

Furnizim nga Operatori Ekonomik: Messer Medica

Nr.	Numri i faturës	Vlera	Furnizuesi	Data
1	082224001-4	20.16	MesserMedica	22/08/2024
2	080124001-4	811.25	MesserMedica	01/08/2024
3	091124001-4	20.16	MesserMedica	11/09/2024
4	093024003-4	15.12	MesserMedica	30/09/2024
5	10224001-2	20.16	MesserMedica	28/10/2024

Tabela 14. Furnizimi sipas kërkesave për terapi

Furnizimi sipas kërkesave për terapi				
Periudha	Insulina	Terapi orale	Terapi ampulare dhe infuzione	Terapi antituberkulare
Janar -Dhjetor	I plotë	Pjesërisht i mirë	Nuk ka qenë i mjaftueshëm	I plotë

AKTIVITETET - distribuimi dhe disperzimi i barnave dhe materialit mjekësor nëpër pikat furnizuese të paraqitura në tabelën vijuese:

Tabela 15. Distribuimi dhe disperzimi i barnave

Barnatorja	Kryeinfermieri	Laboratori	Të tjera
QKMF	QKMF	QKMF	- Kujdestaria e natës I-II-III - Shërbimi Emergjent - Kabineti i rëntgenit - Sektori i Stomatologjisë dhe - AMF-të
QMF 1	QMF 1	QMF 1	
QMF 2	QMF 2	QMF 2	
QMF 4	QMF 3	QMF 3	
	QMF 4	QMF 4	

Gjatë *dymbëdhjetë mujorit Janar-Dhjetor* niveli i furnizimit me barna nuk ka qenë i njëtrajtshëm por ka ndryshuar nga një periudhë në tjetrën. Gjithashtu, ka pasur ndryshime edhe në plotësimin e kërkesave për terapi të kategorive të caktuara.

AKTIVITETE: Distribuiu dhe disperzoi i barnave ,materialit medicinal, materialit mbrojtës.

Distribuiu i mirë në këto pika furnizuese:

Barnatorja pranë QKMF

Barnatorja pranë QMF I

Barnatorja pranë QMF II

Barnatorja pranë QMF III

Barnatorja pranë QMF IV

Barnatorja pranë QMF V

Barnatorja pranë QMF VI

Barnatorja pranë QMF VII

Barnatorja pranë QMF VIII

Barnatorja pranë QMF IX

Laboratori QKMF

Laboratori QMF I

Laboratori QMF II

Laboratori QMF III

Laboratori QMF IV

Kujdestari e natës –I-II-III

Kujdestaria e festave dhe vikendeve

Shërbimi Emergjent

Rëntgeni

DAT

Auto Parku

Shërbimi Teknik

Stomatologjia

AMF Mirosalë

AMF Mirash

AMF Varosh

AMF Talinoc

AMF Gaçkë

AMF Llojza

Distribuijmë dhe disperzime të barnave, materialit medicinal, materialit mbrojtës në të gjitha njësitë punuese të QKMF-së dhe në të gjitha institucionet, të cilat janë pjesë e K.K Ferizaj

VËREJTJE:

Furnizimet në tremujorin e katërt të vitit 2024 për kategorinë e insulinë marrësve janë plotësuar në plotni.

Furnizimi në tremujorin e katërt të vitit 2024 me terapi orale ka qenë pjesërisht i mirë.

Furnizimi në tremujorin e katërt të vitit 2024 me terapi ampulare nuk ka qenë i mjaftueshëm, po ashtu mbulimi me terapi nga grupi i barnave antituberkulare është i mirë.

II. QENDRA TRAJNUESE E MJEKËSISË FAMILJARE

2.1. Aktivitetet në QTMF

Aktivitetet e zhvillimit në QTMF-Ferizaj për *periudhën dymbëdhjetë mujore* janë të lidhura me zbatimin e programit të shkollimit specialistik në Mjekësi Familjare për gjeneratën 2021/2024 ku përshihen:

- Ushtrimet Klinike në QTMF / Ferizaj;
- Ligjëratat qendrore në QZHM / Prishtinë;
- Monitorimi i ushtrimeve klinike në repartet klinike në Spitalin e Përgjithshëm të Ferizajt, IKSHP-Ferizaj dhe QSHM - Ferizaj;
- Vlerësimi në mes të modulit dhe në fund të modulit në programin e Mjekësisë Familjare
- Raportimet e rregullta të implementimit dhe zbatimit dhe vijueshmërisë në MSH në Prishtinë;
- Koordinimi dhe zbatimi në implementim të programit të Mjekësisë Familjare me institucionet përgjegjëse Komunale DSHMS dhe Drejtorin e QKMF-së.
- I gjithë ky aktivitet realizohet me stafin e QTMF / Ferizaj ku bëjnë pjesë koordinatori, mentorët klinikë dhe trajnerët.

Në gjeneratën 2021/2024 vijnë specializimin 7 specializantë nga QKMF –Viti, 2 nga QKMF-Kaçanik, 1 specializant nga QKMF / Prishtinë dhe 1 specializant nga QKMF /Ferizaj që është transferuar nga QKMF –Hani i Elezit.

2.2. Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional

Në bazë të planit vjetor për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional për mjekë familjarë dhe të përgjithshëm, gjatë *dymbëdhjetë muorit Janar-Dhjetor 2024* janë mbajtur këto aktivitete sipas planit vjetor të dorëzuar në Odën e Mjekëve të Kosovës:

Tabela 16. Ligjëratat dhe trajnimet e mbajtura në kuadër të ZHVP-së

Aktiviteti	Data/Muaji
Ligjëratë: Vaksinimi i rregullt i fëmijëve Kanceri i qafës së mitrës - parandalimi përmes vaksinës HPV	31.01.2024
Riauditi klinik: Përshkrimi i antibiotikëve	03.2024
Ligjëratë: Rëndësia e planifikimit Familjar në KP	03.2024
Ligjëratë: Raportimit të sëmundjeve jo ngjitëse dhe infektive	03.2024
Ligjëratë: Menaxhimi i sëmundjeve ngjitëse kronike KP	04.2024
Udhërrëfytyesi klinik-Kujdesi Antenatal dhe Postnatal në Kp	05.2024
Ligjëratë: GMCD(Udhëzuesi Ndërkombëtar për monitorimin e zhvillimit të fëmijës	06.2024
Ligjëratë: Parandalimi i konflikteve me pacient - PRAK	08.2024
Ligjëratë: GMCD(Udhëzuesi Ndërkombëtar për monitorimin e zhvillimit të fëmijës	06.2024
Ligjëratë: 3Ligjerata	11.2024
Ligjëratë: 3 Trajnime	11.2024
Ligjeratë: 2 Shqyrtime kolegjiale per DM sipas planit vjetor	12.2024

Këto aktivitete zyra e ZHVP i ka akredituar në Odën e Mjekëve të Kosovës duke iu mundësuar mjekëve t'i realizojnë pikët e nevojshme për licencim dhe ri licencim dhe njëkohësisht të rritet niveli i cilësisë së punës në praktikën e përditshme profesionale.

Sa i përket metodologjisë gjatë realizimit të këtyre aktiviteteve, QTMF në Ferizaj është përkujdesur që përmes metodave interaktive me pjesëmarrësit e ligjëratave, përveç prezantimit, të identifikohen edhe vështirësitë në vendin e punës për zbatim të dhënave më të reja shkencore

2.3. Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional Infermieror

Aktivitetet për ZHVP për Infermierë Zyra janë mbajtur sipas planit të hartuar paraprakisht me qëllim të arritjes së objektivave të zhvillimit profesional drejt ngritjes së cilësisë dhe plotësimit të standardeve për kujdes shëndetësor. Gjatë *dymbëdhjetë muorit janar-dhjetor* janë mbajtur këto aktivitete sipas planit vjetor të dorëzuar në Odën e Infermierëve të Kosovës.

Tabela 17. Ligjëratat e mbajtura në kuadër të ZHVP-së për Infermierë

Ligjërata	Data
Analizat Biokimike	11.01.2024
Dukuritë devijante në shoqëri (droga, alkooli, duhani, prostitucioni	20.01.2024
Analizat Biokimike	25.01.2024
Trajtimi i Plagëve dekubitae, shputa diabetike dhe kujdesi infermieror	08. dhe 22.02.2024
Shëndeti Oral dhe parandalimi i kariesit	14.02.2024
TBC- Dita Ndërkombëtare	24.03.2024
Mbrojtja dhe kontrolli nga Infeksioni-Sterilizimi dhe dezinfektimi	07.03.2024
Mbrojtja dhe kontrolli nga Infeksioni-Sterilizimi dhe dezinfektimi	18.03.2024
“Kujdesi për higjienën e ambientit”	01.04.2024
EKG-Teknikat e Realizimit	04 dhe 12.04.2024
Vaksinat e Reja, mënyra e vaksinimit dhe ruajtjes së tyre	10.05.2024
Parandalimi i TB	24.04.2024
Tryeza e Rrumbullakët	10.05.2024
Vaksinat e Reja, mënyra e vaksinimit dhe ruajtjes së tyre	21.05.2024

Ndalo Duhanin! Duhani Vret.	31.05.2024
Drogat dhe Pasojat e Drogave	25.06.2024
Ushqyerja me qumësht gjiri	08.09.2024
Procedurat e Fashimit	12 dhe 20.09.2024
Administrimi i Oksigjenit-Oksigjenimi	27.09.2024 dhe 7.10.24
Administrimi i medikamenteve dhe dozimi	17.10.2024
Kanceri i gjirit	25.10.2024
Parandalimi i komplikimeve të Diabetit	12.11.2024
Parandalimi i HIV/AIDS-prioritet i shoqërisë	01.12.2024

III. SEKTORI I STOMATOLOGJISË

Spektori i Stomatologjisë në kuadër të QKMF – së në Ferizaj organizon punën në tri shtylla kryesore:

1. Shërbimet stomatologjike primare - shtrihet përveç QKMF – së edhe nëpër QMF-të në qytet dhe disa fshatra
2. Shërbimet stomatologjike sekondare - në QKMF të paraqitura në tabelën vijuese

Tabela 8. Shërbimet stomatologjike

Llojet e shërbimeve	Me pagesë	Pa pagesë	Totali
Vizita specialistike	390	3960	4350
Vizita stomatologjike	2245	11385	13630
Nxjerrje me anestezion	1207	1953	3160
Nxjerrje pa anestezion	36	1911	1947
Aplikim i barit me anestezion	30	70	100
Drenazhë	347	2957	3304
Aplikim i barit	801	3905	4706
Ekstirpim vital me mbushje	15	66	81
Ekstirpim mortal	110	406	516
Mbushje e kanalit	114	350	464
Amalgam pllombë	269	256	525
Helio pllombë	802	791	1593
Largimi i shtresave të buta	24	53	77
Pastrimi i dhëmbëve	103	166	269
 - Deklaratë për falje nga Jeton Rexha nga fsh. Rakaj e falin ngastrën kadastrale 1014-66 Zk. Rakaj me sip. 76 m².

- Deklaratë për falje nga Sefedin Murati etj nga fsh. Jezerc i falin ngastrat kadastrale 532-2 Zk. Jezerc me sip. 91 m², ng.kad. 534-2 Zk. Jezerc me sip. 39 m², ng.kad. 539-2 Zk. Jezerc me sip. 91 m², ng.kad. 540-2 Zk. Jezerc me sip. 37 m², ng.kad. 541-1 Zk. Jezerc me sip. 78 m², ng.kad. 542-2 Zk. Jezerc me sip. 353 m².
- Deklaratë për falje nga Mehmet Mustafa etj nga fsh. Prelez i Jerlive e falin ngastrën kadastrale 701-6 Zk. Prelez i Jerlive me sip. 567 m².
- Deklaratë për falje nga Dalip Salihu nga fsh. Rahovicë e fal ngastrën kadastrale 1073-10 Zk. Talinoc i Muhaxhereve me sip. 16 m² dhe ng.kad. 1113-0 Zk. Talinoc i Muhaxherëve me sip. 2042 m².
- Deklaratë për falje nga Avni Ratkoceri nga Ferizaj e fal ngastrën kadastrale 47-11 Zk. Ferizaj me sip. 81 m².
- Deklaratë për falje nga Ramadan Mani etj nga fsh. Stagovë i falin ngastrat kadastrale 3214-0 Zk. Ferizaj me sip. 343 m², ng.kad. 3215-6 Zk. Ferizaj me sip. 377 m², ng.kad. 3213-0 Zk. Ferizaj me sip. 292 m², ng.kad. 2844-23 Zk. Ferizaj me sip. 24 m², ng.kad. 3468-0 Zk. Ferizaj me sip. 84 m², ng.kad. 2844-24 Zk. Ferizaj me sip. 145 m², ng.kad. 2744-1 Zk. Ferizaj me sip. 84 m² dhe ng.kad. 3212-3 Zk. Ferizaj me sip. 258 m².
- Deklaratë për falje nga Rexhep Osmani etj nga fsh. Jezerc e falin ngastrën kadastrale 1470-5 Zk. Jezerc me sip. 677 m².
- Deklaratë për falje nga Isuf Kadrija etj nga fsh. Slivovë e falin ngastrën kadastrale 719-4 Zk. Slivovë me sip. 513 m².
- Deklaratë për falje nga Sabri Elezi etj nga fsh. Sllatinë e falin ngastrën kadastrale 1033-2 Zk. Nekodin me sip. 129 m².
- Deklaratë për falje nga Ragip Osmani etj nga fsh. Rahovicë e falin ngastrën kadastrale 2305 Zk. Rahovicë me sip. 1538 m².
- Deklaratë për falje nga Hajrush Qatani etj nga fsh. Talinoc i Muhaxherëve i falin ngastrat kadastrale 987-11 Zk. Talinoc i Muhaxhereve me sip. 533 m² dhe ng.kad. 987-9 Zk. Talinoc i Muhaxherëve me sip. 534 m².
- Deklaratë për falje nga Hamit Rizani etj nga Ferizaj e falin ngastrën kadastrale 1085-27 Zk. Talinoc i Muhaxherëve me sip. 1243 m².
- Deklaratë për falje nga Shkëlqim Shabani etj nga fsh. Varosh e falin ngastrën kadastrale 2223-2 Zk. Tankosiq me sip. 2849 m².
- Deklaratë për falje nga Hamdi Tershana nga Ferizaj e fal ngastrën kadastrale 3448-8 Zk. Ferizaj me sip. 195 m².
- Deklaratë për falje nga Avni Berisha nga Ferizaj e fal ngastrën kadastrale 787-2 Zk. Mirosalë me sip. 153 m².
- Deklaratë për falje nga Azem Sinani etj nga fsh. Brod i falin ngastrat kadastrale 445-2 Zk. Rakaj me sip. 244 m² dhe ng.kad. 444-2 Zk. Rakaj me sip. 241 m².
- Deklaratë për falje nga Rexhep Imeri etj nga fsh. Izhancë e falin ngastrën kadastrale 208-10 Zk. Rakaj me sip. 726 m².
- Deklaratë për falje nga Ilaz Ugzmajli nga fsh. Pleshinë e falin ngastrën kadastrale 71-9 Zk. Pleshinë me sip. 503 m².
- Deklaratë për falje nga Arblin Piraj nga Essen Gjermani e fal ngastrën kadastrale 583-74 Zk. Bibaj me sip. 527 m².
- Deklaratë për falje nga Egzon Selimi nga fsh. Gërlicë i fal ngastrat kadastrale 485-3 Zk. Gërlicë me sip. 92 m² dhe ng.kad. 485-4 Zk. Gërlicë me sip. 57 m².
- Deklaratë për falje nga Arblin Piraj nga Essen Gjermani e fal ngastrën kadastrale 583-86 Zk. Bibaj me sip. 258 m².
- Deklaratë për falje nga Asllan Spahiu nga Ferizaj e fal ngastrën kadastrale 1060-4 Zk. Talinoc i Muhaxherëve me sip. 297 m².

- Deklaratë për falje nga Idriz Hyseni nga fsh. Neredime e Poshtme e fal ngastrën kadastrale 1515-1 Zk. Neredime e Poshtme me sip. 614 m².
- Deklaratë për falje nga Ekrem Qerimi, Naser Qerimi, Qenan Ajvazi nga fsh. Muhoc i falin pjesët e ngastrave kadastrale në ZK. Muhoc 217-0 me sip 47 m², 218-2 me sip 39 m², 218-3 me sip. 3 m², 226-0 me sip. 34 m², 759-0 me sip. 32 m², 233-0 me sip. 36 m², 234-2 me sip. 22 m², 234-1 me sip. 22 m², 243-2 me sip. 29 m², 243-1 me sip. 11 m², 244-0 me sip. 13 m², 245-0 me sip. 9 m², 246-0 me sip. 10 m², 251-3 me sip. 31 m², 252-0 me sip. 20 m², 259-0 me sip. 24 m², 260-0 me sip. 16 m², 267-0 me sip. 53 m², 268-0 me sip. 58 m², 783-0 me sip. 52 m², 784-1 me sip. 25 m², 784-2 me sip. 15 m², 57-3 me sip. 12 m², 57-4 me sip. 29 m², 25-1 me sip. 4 m², 25-3 me sip. 40 m², 75-6 me sip. 17 m², 28-1 me sip. 15 m², 129-1 me sip. 8 m², 129-2 me sip. 5 m², 30-0 me sip. 22 m², 132-0 me sip. 20 m², 133-0 me sip. 22 m², 134-0 me sip. 21 m², 135-0 me sip. 30 m², 763-0 me sip. 65 m², 138-0 me sip. 36 m², 139-0 me sip. 34 m².
- Deklaratë për falje nga Selvete Murati nga fsh. Komogllavë i fal ngastrat kadastrale 2777-6 Zk. Komogllavë me sip. 329 m² dhe ng.kad. 4014-10 Zk. Komogllavë me sip. 308 m².
- Deklaratë për falje nga Qendrim Qeli nga fsh. Rakaj e fal ngastrën kadastrale 1044-4 Zk. Rakaj me sip. 548 m².
- Deklaratë për falje nga Isuf Salihu nga fsh. Koshare e fal ngastrën kadastrale 810-21 Zk. Koshare me sip. 770 m².
- Gjatë periudhës së vitit 2024 pronarët e paluajtshmërive kanë falur për rrugë sipërfaqet prej: 23.483 m² ose (2.34.03. ha).

- Aktvendime për lirim të pronave komunale: 48
- Përfaqësime në Gjykatën Themelore në Ferizaj në cilësinë e përfaqësuesit juridik: 49
- Përgjigje në padi, me paditë e ushtruar në Gjykatë lidhur me shpronësime: 14
- Ankesa e ushtruar Gjykatës së Apelit kundër Aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Ferizaj: 3
- Punë në terren me Komisionin për Dhënie të Pronave Komunale në Shfrytëzim për të gjitha bizneset që operojnë në Zk. Babush dhe Prelez i Muhaxherëve.
- Komisioni për shqyrtimin e ankesave dhe parashtrësive ndaj vendimeve të inspektoratit komuna gjithsej numri i ankesave të shqyrtuara: 6
- Njoftime për bankë: 10



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E BUJQËSISË

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2024

Burim Bajrami
Drejtör i Drejtorisë së Bujqësisë

Drejtoria e Bujqësisë në kuadër të aktivitetit të saj ka në përbërje tre njësi:

- Njësinë e Lavërtarisë,
- Njësinë e Blegtorisë,
- Njësinë e Zhvillimit Rural

Të gjitha këto njësi kanë në kuadër të tyre staf të përgatitur profesional dhe aktivitetin e tyre e zhvillojnë konform rregullave dhe ligjeve të parapara në këtë sektor.

Drejtoria e Bujqësisë gjatë periudhës raportuese në vazhdimësi ka zbatuar politikat sektoriale sipas:

- Strategjive zhvillimore,
- Planit të Punës së Drejtorisë të hartuar për vitin 2024,
- Planit Zhvillimor Komunal,
- Vendimeve të Kuvendit të Komunës dhe sipas kërkesave të qytetarëve.

Aktivitetet e Drejtorisë gjatë kësaj periudhe janë fokusuar kryesisht në realizimin e subvencioneve dhe projekteve si dhe në shqyrtimin dhe zgjidhjen e kërkesave në lëmi të ndryshme të fermerëve.

Drejtoria e Bujqësisë gjatë vitit 2024 ka zhvilluar këto aktivitete:

- 1. Furnizimi i fermerëve me serra** – me realizimin e këtij projekti janë ngritur 270 serra me sipërfaqe 50m², në këtë projekt është përfshirë konstruksioni i serrës, folia, transporti, punët rreth vendosjes së serrës dhe sistemi i ujitjes. Interesimi i fermerëve ka qenë shumë i madh për këtë projekt, kanë aplikuar 570 fermerë.
- 2. Furnizimi i fermerëve me folie dhe sistem të ujitjes** – me këtë projekt përkrahen fermerët kultivues të perimeve me folie të zezë dhe me sistem të ujitjes. Janë mbështetur me këtë sasi 24 fermerë: sistem i ujitjes pikë – pikë 159,200 metër gjatësi, folie të zezë 61,000 m² dhe folie për sallatë të gjelbër 8,400m².
- 3. Subvencionimi i fermerëve kultivues të perimeve në serra dhe jashtë tyre me pajisje** – me këtë projekt janë përkrahur 100 fermerë kultivues të perimeve me nga një moto kultivator 5.2 kW me freza.
- 4. Subvencionimi i fermerëve me mekanizim bujqësor** – është një prej projekteve shumë të rëndësishme ngase ndikon në zhvillimin e një bujqësie intensive. Kërkesat e fermerëve për këtë projekt janë shumë të mëdha. Janë furnizuar 168 fermerë.
- 5. Furnizimi i fermerëve kultivues të perimeve në serra dhe jashtë tyre me spërkatëse** - me realizimin e këtij projekti janë furnizuar 10 fermerë kultivues të perimeve me nga një spërkatëse portative elektrike, janë furnizuar edhe 30 fermerë kultivues të perimeve me nga një spërkatëse manuale. Këto pajisje janë shumë efektive dhe ua lehtësojnë punën fermerëve gjatë mbrojtjes së kulturave perimore nga sëmundjet dhe dëmtuesit.

6. Furnizimi i fermerëve kultivues të pemëve me spërkatëse profesionale – me këtë projekt janë furnizuar 39 fermerë kultivues të pemëve me nga një spërkatëse profesionale për pemishtet e tyre.

7. Furnizimi i fermerëve me makina (printer) për vulosje të vezëve – Drejtoria e Bujqësisë ka realizuar këtë projekt me qëllim të përkrahjes së sektorit të shpeztarisë (pulave vojse) për krijimin e fermave komerciale të orientuara nga tregu. Për këtë projekt janë kryer procedurat për furnizim me makina për vulosjen e vezëve. Përfitues të printerëve janë 5 fermerë që në fermat e tyre kanë mbi 5000 pula vojse.

8. Furnizimi i fermerëve me sistem mbrojtës të bletishteve nga kafshët e egra (gardhet elektrike) – Janë përkrahur 20 bletarë me këto pajisje si masë e rëndësishme e mbrojtjes së bletishteve nga kafshët e egra.

9. Furnizimi i fermerëve me pajisje për bletë – Për një cilësi të produkteve të mjaltit rol të rëndësishëm ka përdorimi i pajisjeve për bletë e sidomos makinat për nxjerrjen e mjaltit. Me këtë projekt janë furnizuar 62 fermerë me nga një centrifugë elektrike, tymuese dhe bluzë me kapelë.

10. Ndërtimi i shtëpizave për apiterapi - trajtimi me apiterapi është një lloj terapie alternative që përdor produkte që rrjedhin drejtpërdrejt nga bletët. Janë përkrahur tre bletarë mbarështrues të bletëve për ndërtimin shtëpizave dhe pajisje për Apiterapi.

11. Trajtimi i qenve endacak – ky projekt është realizuar duke pasur parasysh kërkesat e shumta nga ana e qytetarëve për qentë endacak dhe rrezikun që paraqesin për jetën e qytetarëve e sidomos fëmijëve që shkojnë në shkollë. Drejtoria e Bujqësisë e ka realizuar projektin e trajtimit të qenve endacak përmes KSVL-së ku janë trajtuar rreth 400 qenë endacak.

12. Furnizimi i tetë pikave me ushqim të koncentruar dhe ujë të pijes për qentë endacak - për uljen e agresivitetit të qenve endacak, Drejtoria e Bujqësisë edhe këtë vit ka realizuar projektin e furnizimit të tetë (8) pikave me ushqim të koncentruar dhe ujë të pijes.

13. Mbarësimi artificial i lopëve qumështore dhe mëshqerrave - që ferma të jetë rentabile, përveç ushqimit të mirë, patjetër që duhet të investohet në përzgjedhjen e drejtë të racës së kafshës me këtë mundësohet kontrolla e sëmundjeve infektive dhe trajtimi i problemit të fertilitetit të ulët. Me material gjenetik janë mbarësuar 2062 krerë lopë dhe mëshqerra.

14. Vaksinimi i fondit blegtoral – Në fermat komerciale dhe gjysmë komerciale kjo masë preventive kundër sëmundjeve infektive (sëmundjeve clostridiale) është bërë tek gjedhet, delet dhe dhitë. Janë vaksinuar 2670 krerë gjedhe (lopë qumështore, mëshqerra dhe viqa) dhe bagëti të imëta (dele, qengja, dhi e keca) - 10845 krerë.

15. Rregullimi dhe mirëmbajtja e thundrave tek lopët qumështore - Sëmundjet e thundrave ndikojnë në shëndetin dhe prodhimtarinë blegtorale ku vjen deri te rënia e prodhimtarisë e njëherit edhe te humbjet ekonomike në ferma. Është bërë rregullimi i thundrave në 1502 krerë lopë qumështore dhe mëshqerra.

16. Ndërtimi i siloseve për ruajtjen e grurit – realizimi i këtij projekti është një indikator që ndikon në stimulimin e fermerëve për rritjen e sipërfaqeve të mbjella me kulturën e grurit, ua mundëson fermerëve ruajtjen e grurit në kushte më të mira, ua mundëson ruajtjen e grurit deri në momentin kur tregu iu ofron çmime më të larta. Është projekt trevjeçar, ofron një kapacitet të deponimit të grurit deri në 8000 ton. Implementimi ka filluar gjatë vitit 2023 dhe janë kryer të gjitha punët sipas planit të paraparë për këtë vit edhe gjatë vitit 2024 janë kryer të gjitha punët e parapara sipas kontratës.

17. Rregullimi i Qendrës së Panaireve – Hipodromi – lokacioni i këtij projekti është në mes të fshatit Prelez i Muhaxherëve dhe fshatit Papaz, është projekt trevjeçar, ku fermerët e kanë mundësinë që pas përfundimit të investimeve në këtë vend të zhvillojnë aktivitete të ndryshme si panaire, gara apo kalërimë kuajsh etj. Është një mundësi shumë e mirë për të gjithë fermerët që janë të interesuar t'i ekspozojnë aktivitetet apo produktet e tyre bujqësore. Realizimi i projektit ka filluar gjatë vitit 2023 dhe janë kryer punët që ishin të planifikuara gjatë këtij viti si: pastrimi i terrenit, punët tokësore (gërmimet, rrafshimi i terrenit, ngjeshja etj) edhe gjatë vitit 2024 janë kryer të gjitha punët e parapara sipas kontratës.

18. Rregullimi i rrugëve të arave me zhavorr- Në vitin 2024 është arritur të rregullohen disa rrugë të arave dhe të hapen disa rrugë të reja.

19. Hapja e kanaleve kulluese për tokat bujqësore - me këtë projekt deri më tani janë hapur disa kilometër kanale kulluese të tokave bujqësore dhe se përmes saj është arritur të mbrohen nga vërshimet qindra hektarë tokë të punuara, duke mbrojtur kështu edhe kulturat bujqësore. Kanalet janë hapur në terrenet ku janë më të rrezikuara nga vërshimet. Kanalet janë hapur në shumë fshatra të Komunës së Ferizajt.

20. Rregullimi i Tregut të Kafshëve - janë duke vazhduar punimet për fazën e dytë të tregut të kafshëve dhe strehimores për qentë endacak.

21. Kompensimi i dëmeve në bujqësi – Drejtoria e Bujqësisë për vitin 2024 në kuadër të subvencioneve ka ndarë një buxhet për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe dëmet tjera në ferma. Varësisht nga dëmet e shkaktuara fermerët kanë bërë kërkesat në Drejtorinë e Bujqësisë. Komisioni i formuar nga ekspertët e kësaj drejtorie i kanë shqyrtuar 150 kërkesa dhe janë bërë vlerësimet.

- Drejtoria e Bujqësisë ka kryer të gjitha procedurat për realizimin e projekteve të cekura më lartë, ka bërë menaxhimin e projekteve deri në përfundimin e tyre, ka bërë pagesat sipas kontratave të nënshkruara dhe vazhdon monitorimin e mëtutjeshëm.

Përveç projekteve të cekura më lartë në Drejtorinë e Bujqësisë janë kryer edhe këto aktivitete:

- Aplikimi i fermerëve për subvencione nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Ky aplikim është kryer në zyrat e Drejtorisë së Bujqësisë, ishte një punë shumë voluminoze ku ishte angazhuar i tërë stafi i Drejtorisë së Bujqësisë në kryerjen e këtyre punëve:

- Shpallja e njoftimeve për aplikim për subvencione,
- Kontrollimi dhe pranimi i dokumenteve,
- Regjistrimi në Regjistrin e Fermës,
- Digjitalizimi i parcelave në ELPIS,
- Aplikimi online për të gjitha subvencionet në EFR.

Gjatë vitit 2024 për subvencionet nga MBPZHR në Drejtorinë e Bujqësisë kanë aplikuar gjithsej 1164 fermerë për këto subvencione: lopë 1569 krerë, mëshqerra 171, dele 7797 krerë, dhi 119 krerë, pula 101000 copë, bletë 9558, grurë 2951ha, misër 3171 ha, elbi 10ha, thekra 8.5 ha, molla 41 ha, kumbulla, 15ha, aronija 3ha, mjedra 5 ha, arra 80 ha, vishnje 2.5ha, lajthia 35 ha, patate 38ha, kunguj 25 ha, qepë 13ha, shalqi 9ha, lakra 6 ha, tërshërë 57 ha, kunguj të misirit 8ha, dredhëza 2.6ha, fasule 71 ha, marulla 0.6 ha, speci 9.11 ha, dardha 0.5ha, bimë mjekësore dhe aromatike 12.26 ha, tranguj 12.76 ha perime në serra 4.57 ha, qershia 7.29 ha, material fidanor 377150 copë, dhe luledielli 175.56ha.

Në Drejtorinë e Bujqësisë janë bërë:

- Pagesat për të gjitha subvencionet dhe projektet e realizuara,
- Pagesat për të gjitha kategoritë e shërbimeve dhe mallrave,
- Janë bërë raportet mujore dhe gjashtëmujore për faturat e papaguara,
- Planet dhe raportet e mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore,
- Janë bërë përgatitjet për korrje-shirje dhe raportet e korrje-shirjeve,
- Kemi bërë edhe vlerësimin e dëmeve sipas kërkesave të fermerëve që kompensohen nga Agjencioni për Menaxhimin e Emergjencave,
- Janë organizuar trajnime të rregullta me fermerë në bashkëpunim me MBPZHR – Departamentin e Shërbimeve Këshillimore.
- Jemi të përfshirë në Komisionin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,
- Janë pajisur fermerët me vërtetime si prodhues bujqësor për nevoja të tyre personale,
- Të gjitha kërkesat që i janë drejtuar kësaj Drejtorie janë shqyrtuar dhe janë zgjidhur konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCË

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2024

Alberton Sahiti

Drejtore i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

HYRJE

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë në kuadër të fushë veprimtarisë së vetë ka sektorin e shërbimeve publike dhe sektorin e emergjencave.

Sektori i shërbimeve publike mbulon aktivitete që ndërlidhen me mirëmbajtjen e hapësirave publike si mirëmbajtja e rrugëve me asfalt, me zhavorr, riparimin e trotuareve, pastaj mirëmbajtja e rrugëve me shenja të komunikacionit si ato horizontale dhe vertikale, mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara si sheshet, menaxhimi i mbeturinave, parqet, drunjtë dekorativ, mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik si dhe zgjerimin e tij aty ku paraqiten nevojat sipas mundësive buxhetore, pastaj mbarëvajtjen e komunikacionit rrugor dhe atij të mallrave, mirëmbajtjen e infrastrukturës nëntokësore si rrjeti i kanalizimit atmosferik dhe atij fekal, rrjetin e ujësjellësit etj., çdo herë në koordinim edhe me ndërmarrjet publike për detyrat dhe obligimet që ato i kanë ndaj qytetarëve të përcaktuara me ligjet dhe udhëzimet administrative në fuqi.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-027 për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, në të cilin përcaktohen dhe rregullohen detyrat bazë të sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, Komuna në territorin e saj organizon mbrojtjen nga zjarri, kujdeset për zbatimin, përparimin e masave të mbrojtjes nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera natyrore si vërshimet, rrëshqitjet e dheut apo erërat, si dhe fatkeqësi tjera natyrore që mund të ndodhin në Komunën e Ferizajt.

Në të njëjtën kohë, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë zhvillon aktivitete për shënimin e datave të rëndësishme mjedisore si dhe dekorimin e qytetit për festat e fund vitit dhe festave tjera zyrtare.

Gjatë vitit 2024 janë pranuar 1439 kërkesa nga zyra pritëse të adresuara nga qytetarët për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, pas shqyrtimeve të gjitha janë shpërndarë tek zyrtarët përkatës të Drejtorisë të cilat pas verifikimeve në terren disa prej tyre janë miratuar disa janë refuzuar e disa janë në proces.

Kërkesa të pranuar	Kërkesa të miratuara	Kërkesa të refuzuara, anuluar	Kërkesa në proces, pezulluar, ceduar
1439	1202	198	39

2. SEKTORI I EMERGJENCAVE

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-027 për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, në të cilin përcaktohen dhe rregullohen detyrat bazë të sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera natyrore, stafi i sektorit të emergjencave është munduar që të përmbush këto obligime që dalin nga ligji duke kryer këto detyra në terren që lidhen me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve.

- Gjatë këtij viti kemi pranuar kërkesa të natyrave të ndryshme, ku të gjitha janë shqyrtuar.
- Mbikëqyrja e kryerjes së punëve në pastrimin e rrugëve të qytetit dhe fshatrave gjatë sezonit dimëror dhe veror ku për këtë qëllim të kontraktuara janë operatorë ekonomik privat dhe publik.
- Menaxhimi-shqyrtimi i kërkesave të qytetarëve për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore si reshjet e shiut, borës, erërave dhe rastet e zjarreve në bashkëpunim me Policinë, zjarrfikësit, kompanitë publike.
- Është bërë mirëmbajtja e hapësirave nëpër Institucione Publike nga N.P.L “Ambienti” në qytet dhe fshatra si: Oborret e zyrave të gjendjes civile, qendrat e mjekësisë familjare dhe ambulancat, parqet, kopshtet e fëmijëve, bibliotekave dhe fushave sportive, hapësirat publike të banesave të vjetra kolektive, prerja dhe largimi i drunjve që paraqesin rrezik, rregullimi i ulëseve dhe shportave të mbeturinave, vendosja (zëvendësimi) i flamujve.
- Është bërë pastrimi, larja, mirëmbajtja e rrugëve, parqeve, shesheve, lapidarëve, mirëmbajtja e hapësirës së Varrezave të Dëshmorëve, krasitja e drunjve dekorativ, është zëvendësimi i drunjve të dëmtuar, mbjellja e drunjve të rinj, si dhe mbjellja e luleve pranverore dhe vjeshtore nëpër hapësira të ndryshme të qytetit të Ferizajt.
- Po ashtu edhe gjatë vitit 2024 kemi vazhduar me operatorin ekonomik për pastrimin e varrezave të qytetit të të gjitha kulteve fetare si ato myslimane, katolike dhe ortodokse, si dhe është bërë vendosja e gurëve të varreve nga materiali “mermer”, në varrezat e qytetit në Fshatin e Vjetër.
- Pjesëmarrja në trajnime të organizuara nga AKK-së dhe GIZ-i gjerman për menaxhimin e mbeturinave.

2.1 Hapja dhe pastrimi i kanaleve ujore dhe shtretërve të lumenjve

Me qëllim mirëmbajtjen e shtretërve të lumenjve, kanaleve ujore dhe rregullimi i argjinaturave për të eliminuar vërshimet gjatë reshjeve janë hapur 26.149m¹ gjatësi të kanaleve dhe shtretërve të lumenjve dhe janë eliminuar 876m³ të shkurreve dhe drunjve, 300.50 orë pune e punëtorëve fizik në pastrim të lumenjve nga mbeturinat e ndryshme, punimi i leshasave me tuba të betonit 40metra.

Me qëllim të eliminimit të vërshimeve është intervenuar në këto fshatra: Talinoc i Muhaxherëve, Salla “Bill Clinton” (lumi “Bifurkacioni”), Neredime, Koshare, Varosh, Fshati i Vjetër, Pleshinë, Zaskok dhe Doganaj.

2.2 Raste zjarri, shiu, vërshime dhe erë, për të cilat qytetarët kanë bërë kërkesa për dalje në vendngjarje

Në bazë të kërkesave të qytetarëve që i janë shkaktuar dëme nga të reshurat e shiut, breshëri, si dhe erërat e forta që kanë ndodhur gjatë vitit 2024 janë: Gjashtë raste (6) kërkesa për kompensim të dëmeve në ekonomitë familjare dhe biznese. Vendet që më së shumti pësuan dëme si pasojë e reshjeve të dendura të shiut janë: Ferizaj – qytet, fshatrat: Greme, Rakaj, Varosh etj.

Duhet potencuar se stafi i emergjencave në kuadër të Drejtorisë, pas pranimi të kërkesave nga qytetarët për dalje në vendngjarje për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarri ka verifikuar duke dalë në terren – në vendin e ngjarjes, ku gjatë vitit 2024 kemi pasur 7 raste nga zjarri -rrufeja, duke përfshirë: raste zjarri në ekonomi familjare dhe në biznese të ndryshme, po ashtu kemi pasur 3 raste të kërkesave nga qytetarët për konstatime të gjendjes së krijuar nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

2.3 Njësia e Menaxhimit të Mbeturinave

Me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të pastër, si dhe largimin e mbeturinave nga hapësirat publike janë zhvilluar një numër i madh i aktiviteteve, të ndryshme në ruajtjen dhe pastrimin e ambientit, aktivitetet janë zhvilluar në zona urbane dhe rurale.

- Identifikimi i deponive ilegale të mbeturinave përfshirë mbeturina prej amvisërisë, mbeturina të ndërtimit/inerte, mbeturina industriale/rrezikshme, mbeturinat e vëllimshme dhe mbeturina të përziera. Në lokacionet urbane në qytet dhe fshatra në bashkëpunim me GIZ-in Gjerman si dhe eliminimi i tyre është bërë nga kompania publike K.R.M „Pastërtia”, ku gjatë vitit 2024 i kemi larguar – pastruar 392 ton mbeturina të amvisërisë dhe 990m³ mbeturina të ngurta dhe inerte.
- Janë shënuar edhe data me rëndësi mjedisore si Dita e Pranverës, Dita e Tokës dhe Dita e Mjedisit, Dita e Pranverës, si dhe data tjera me rëndësi ekologjike dhe mjedisore.
- Gjatë vitit 2024, Komuna e Ferizajt ka zhvilluar projekte të rëndësishme duke ndihmuar Kompaninë Rajonale të Menaxhimit të Mbeturinave duke i furnizuar me 685 kontejnerë mbitokësor 1.1 m³ dhe 162 kontejnerë shtëpiak 120L e të cilat janë shpërndarë në qytet dhe fshatra duke mundësuar kështu rritjen dhe zgjerimin e klientëve në sistemin e menaxhimit të mbeturinave.
- Në bashkëpunim me GIZ-in gjerman kemi përfunduar fazën finale të hartimit për Menaxhimin e Integruar Ndër komunal të Mbeturinave në Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.

3. SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

Në kuadër të shërbimeve publike janë zhvilluar një numër i madh aktiviteteve të cilat drejtpërdrejt kanë prekur interesat e qytetarëve si në riparimin e kanalizimeve, ujësjellësve, mirëmbajtjen e rrugëve me zhavorr, asfalt dhe mirëmbajtjen e trotuareve.

Duke u nisur edhe nga kërkesat e qytetarëve dhe gjendjes në terren janë realizuar këto punë dhe aktivitete.

Gjatë vitit 2024, kemi pranuar kërkesa të ndryshme kryesisht nga pjesët rurale dhe nga pjesa urbane të cilat kanë të bëjnë më së shumti me riparime të rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza dhe kyçje të reja, si dhe meremetimin-mirëmbajtjen e rrugëve me zhavorr.

Gjatë vitit 2024 kemi kryer shumë raste aty ku ka pas mundësi për de bllokime në bashkëpunim me Kompaninë KRU „Bifurkacioni” kemi bërë de bllokimin e rrjeteve, kurse pjesët ku ka qenë nevoja për ndërrimin e tubave, dhe kyçje të reja i kemi kryer si në shënimet në vijim:

3.1 Riparimi i rrjetit të kanalizimit

Gjatë vitit 2024 kemi pranuar një numër të madh të kërkesave dhe ankesave që lidhen me rrjetin e kanalizimeve atmosferike dhe fekale, andaj pas verifikimit të tyre në terren dhe konstatimit se janë jashtë funksionit për të cilin janë të dedikuar kemi ndërmarr masa për të riparuar apo edhe instaluar në gjatësi të caktuara rrjet të kanalizimit fekale në zonat urbane dhe rurale të komunës.

Gjatësia e riparimeve dhe instalimeve të këtij rrjeti të kanalizimeve arrin 6,730m¹.

Gjatësia e riparimeve të rrjetit të ujësjellësit arrin 420m¹.

3.2 Riparimi i rrugëve me asfalt dhe zhavorr, riparimi i trotuareve

Gjithashtu për të përmirësuar infrastrukturën rrugore sektori i shërbimeve publike ka kryer një numër të madh të aktiviteteve duke u nisur nga gjendja në terren dhe kërkesat e qytetarëve. Pas daljes në terren dhe verifikimit të gjendjes nga zyrtarët e shërbimeve publike e duke u dhënë prioritet rasteve më emergjente si dhe duke pasur parasysh kufizimet buxhetore janë riparuar, mbi 2694.34m² të trotuareve me kubëza, si dhe 64,720m² të rrugëve me zhavorr, riparim i rrugëve me asfalt 13,857.00 m².

3.3 Rregullimi i pusetave të kanalizimit fekal dhe pastrimi i tubave të ujërave atmosferik

Gjatë vitit 2024 kemi pranuar një numër të madh të kërkesave dhe ankesave që lidhen me rrjetin e ujërave atmosferik dhe rregullimin e pusetave të kanalizimit fekal, andaj pas verifikimit të tyre në terren dhe konstatimit se janë jashtë funksionit për të cilin janë të dedikuar kemi ndërmarr masa për të riparuar apo edhe pastruar tubat e ujërave atmosferike në gjatësi dhe rregullimin e pusetave të kanalizimit fekal, në zonat urbane dhe rurale të komunës.

Gjatësia e pastrimit të tubave të kanalizimit atmosferik të gjitha profileve, arrin 2,269 m¹

Pastrimi i pusetave të kanalizimit atmosferik, janë në sasi prej 155 copë

Pastrimi i ujëmbledhësve janë në sasi prej 354 copë

Montimi i kapakëve të metalit, janë në sasi prej 116 copë

Montimi i kapakëve me grila për ujëmbledhës, janë në sasi prej 4 copë

3.4 Ndërtimi i hidrantëve dhe mirëmbajtja e tyre

Në bazë të planifikimeve për këtë vit, kemi realizuar këto projekte në ndërtimin e hidrantëve dhe testimin e tyre, riparimi dhe mirëmbajtja e hidrantëve ekzistues në sasi prej 31 copë janë testuar dhe riparuar nëpër qytet dhe fshatra të Komunës së Ferizajt.

4. NJËSIA E TRANSPORTIT DHE KOMUNIKACIONIT RRUGOR

Nga përshkrimi i detyrave zyrtare të cilat rrjedhin nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, zyrtari i lartë për komunikacion rrugor gjatë periudhës një vjeçare sipas planit të parashikuar, për këtë vit ka realizuar këto punë:

4.1 Transporti rrugor i udhëtarëve dhe mallrave

Transporti i udhëtarëve me autobus dhe taksi është duke u zhvilluar në një nivel të kënaqshëm, ku nga 45 fshatra sa ka Komuna e Ferizajt, 34 prej këtyre fshatrave janë të përfshira direkt në transportin e rregullt urban-periferik, kurse 9 fshatra e shfrytëzojnë transportin ndër-urban, ndërsa 2 fshatra nuk janë të përfshira fare në transport publik.

Duke pasur parasysh dinamikën e zhvillimit të Komunës në përgjithësi si dhe zhvendosjen e Stacionit të Autobusëve në një lokacion tjetër nga ai ekzistues, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë ka zhvilluar procedurën për hartimin dhe inicimin e katër linjave urbane në transportin publik të udhëtarëve, ku bazë për hartimin e këtyre linjave urbane është marr drafti i Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban.

1. Linja A përfshin segmentin rrugor nga lokacioni i ri i Stacionit të Autobusëve, vazhdon nëpërmjet rrugëve “Brahim Ademi”, “Ahmet Kaçiku”, “Rexhep Bislimi” dhe rrugës nacionale (N2) dhe si destinacion përfundimtar prapë është Stacioni i Autobusëve.
2. Linja A1 përfshin segmentin rrugor nga lokacioni i ri i Stacionit të Autobusëve, vazhdon nëpërmjet rrugës nacionale (N2) Prishtinë-Ferizaj dhe rrugëve “Rexhep Bislimi”, “Ahmet Kaçiku”, “Brahim Ademi” dhe si destinacion përfundimtar prapë është Stacioni i Autobusëve.
3. Linja B përfshin segmentin rrugor nga rruga “Brahim Ademi” (Parku i Lirisë) vazhdon rrugës “Ramadan Rexhepi”, “Nënkalimi” dhe rruga “Vëllezërit Gërvalla” (te rrethi HIB) dhe anasjelltas.
4. Linja C përfshin segmentin rrugor nga rruga “Brigada 161” (Rrethi me Shqiponjë) vazhdon rrugës “Ahmet Kaçiku” dhe rrugës “Gursel dhe Bajram Sylejmani” deri tek rruga e Qiraxhive dhe anasjelltas.

Në fushën e transportit urban-periferik edhe këtë vit kemi vazhduar me ndërtimin e vend-ndaljeve për autobusë dhe pritoreve për pritje të udhëtarëve në linjat Ferizaj-Balaj-Manastirc-Neredime-Jezerc.

4.2. Komunikacioni rrugor

Në këtë pikë është paraparë rregullimi teknik i qarkullimit në komunikacion, ku së bashku me njësinë e trafikut të Policisë kemi analizuar disa rrugë dhe trotuare të qytetit dhe kemi bërë disa ndërhyrje dhe ndryshime konkrete të cilat janë realizuar me qëllim të lehtësimit dhe krijimit të një ambienti më të sigurt dhe më të kënaqshëm për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion rrugor, ku vlen të potencohen këto ndërhyrje:

1. Në rrugën urbane “Ahmet Kaçiku”, praktikisht segmenti nga “Village Shopping Centre” në drejtim të rrethit tek objekti i Stacionit Policor Ferizaj, në aksin e rrugës janë vendosur pengesa statike (shtylla anti-parking nga masa plastike) për ta mundur rrjedhën ma të mirë dhe të sigurt të komunikacionit.
2. Në hyrje të rrugës urbane “Vëllezërit Gërvalla”, praktikisht segmenti nga dalja e nënkalimit e deri tek kryqëzimi me rrugën urbane “Gjon Serreçi”, në aksin e rrugës janë vendosur pengesa statike (shtylla anti-parking nga masa plastike) për ta mundur rrjedhën ma të mirë dhe të sigurt të komunikacionit.

3. Në hyrje të rrugës urbane “Rexhep Bislimi”, nga kryqëzimi me rreth-rrotullim me rrugën “Ahmet Kaçiku” në një gjatësi të caktuar në aksin e rrugës janë vendosur pengesa statike (shtylla anti-parking nga masa plastike) për ta mundur rrjedhën më të mirë dhe të sigurt të komunikacionit.
4. Në rrugën urbane “Gjon Serreçi”, praktikisht në hyrje të shkollës fillore janë vendosur shtyllat anti-parking nga çeliku, për ta bërë të pamundur parkingun e veturave në trotuar dhe pengimin e lëvizjes së lirë të nxënësve/këmbësorëve.
5. Në rrugën “Zenel Hajdini” në kryqëzim me rrugën “12 Qershori” dhe tek shkolla fillore “Ahmet Hoxha” janë vendosur shtyllat anti-parking nga çeliku, për ta bërë të pamundur parkingun e veturave në trotuar dhe pengimin e lëvizjes së lirë të nxënësve/këmbësorëve.

4.3 Shenjat e komunikacionit

Në bazë të planifikimeve për këtë vit, kemi realizuar edhe këto projekte në sinjalizimin e rrugëve me shenja horizontale dhe shenja vertikale trafikut, me qëllim të përmirësimit dhe krijimit të një ambienti më të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacionin rrugor.

4.3.1 Shenjat vertikale të komunikacionit

Në rrugët e qytetit dhe fshatrave kemi bërë mirëmbajtjen dhe vendosjen e shenjave vertikale të rrezikut, urdhrave të prera dhe shenjat e lajmërimit, ku me prioritet i kemi vendosur shenjat para institucioneve arsimore dhe janë përfshirë vendosja e shenjave për kufizimin e shpejtësisë dhe atyre të paralajmërimit të prezencës së fëmijëve në ato segmente rrugore.

Udhëtreguesit në komunikacion janë vendosur thuajse në të gjithë territorin e Komunës së Ferizajt, ku rëndësi të veçantë i kemi kushtuar unazës së brendshme dhe të jashtme të qytetit, ku vlen të potencohet se me vendosjen e këtyre udhëtregueseve kemi pasur përmirësim në lehtësimin e qarkullimit në komunikacion, meqenëse pjesëmarrësit janë paralajmëruar saktë dhe me kohë për mundësitë që i kanë për orientimin në komunikacion.

4.3.1 Shenjat horizontale të komunikacionit

Gjatë vitit 2024 kemi shënuar me shenja horizontale këto rrugë urbane qytetit dhe rrugët në fshatra:

1. Në rrugën e fshatit Gaçkë, praktikisht segmenti nga rreth rrotullimi deri në brendësi të fshatit.
2. Sipërfaqja brenda objektit të ri të KRM “Pastërtia” në fshatin Gurëz.
3. Në rrugën “Brahim Ademi”, praktikisht segmenti nga nënkalimi i ri deri tek rreth-rrotullimi tek “HIB Petrol”.
4. Rruga “Driton Islami” është shënuar me shenja horizontale - vija e aksit dhe shiritave, vendkalimet e këmbësorëve dhe mbishkrimet në rrugë, ishujt, shigjetat etj.
5. Rruga “Rexhep Bislimi” është shënuar me shenja horizontale - vija e aksit dhe shiritave, vendkalimet e këmbësorëve dhe mbishkrimet në rrugë, ishujt, shigjetat etj.
6. Rruga “Kemajl Hetemi” është shënuar me shenja horizontale - vija e aksit dhe shiritave, vendkalimet e këmbësorëve dhe mbishkrimet në rrugë, ishujt, shigjetat etj.
7. Rruga “28 Nëntori” është shënuar me shenja horizontale - vija e aksit dhe shiritave, vendkalimet e këmbësorëve dhe mbishkrimet në rrugë, ishujt, shigjetat etj.
8. Rruga “Fatmir Ratkoceri” është shënuar me shenja horizontale - vija e aksit dhe shiritave, vendkalimet e këmbësorëve dhe mbishkrimet në rrugë, ishujt, shigjetat etj.
9. Rruga “Kadri Zeka” është shënuar me shenja horizontale - vija e aksit dhe shiritave, vendkalimet e këmbësorëve dhe mbishkrimet në rrugë, ishujt, shigjetat etj.
10. Rruga “Ahmet Kaçiku” është shënuar me shenja horizontale - vija e aksit dhe anësore, vendkalimet e këmbësorëve dhe mbishkrimet në rrugë, shtigjet e biçikletave, shigjetat etj.
11. Dy rrethet e projektit “Bashkimi i Qytetit” si dhe hyrja e parkingut të është shënuar me shenja horizontale.
12. Segmenti nga fshati Tërrn deri në fshatin Slivovë është shënuar me shenja horizontale - vija e aksit dhe anësore vendkalimet e këmbësorëve dhe mbishkrimet në rrugë.
13. Rruga “Gursel dhe Bajram Sylejmani” është shënuar me shenja horizontale - vija e aksit dhe anësore, vendkalimet e këmbësorëve dhe mbishkrimet në rrugë, shtigjet e biçikletave, shigjetat etj.
14. Rruga “Zenel Hajdini” është shënuar me shenja horizontale - vija e aksit dhe anësore, vendkalimet e këmbësorëve dhe mbishkrimet në rrugë para shkollës.
15. Rruga “Blenisht” në fshatin Zaskok është shënuar me shenja horizontale – vija e aksit, shigjetat, pengesat dhe vendkalimet e këmbësorëve.
16. Rruga “Tafalia” në fshatin Komogllavë është shënuar me shenja horizontale – vija e aksit.
17. Parkingu dhe rruga afër shkollës fillore në fshatin Fshati Vjetër është shënuar me shenja horizontale – vija e aksit, parkingu i shkollës, vendkalimi i këmbësorëve dhe mbishkrimet në rrugë para shkollës.
18. Parkingu tek objekti i Komunës së re në rrugën “Faik Goga”.
19. Rruga “Hajrullah Kastrati” prapa Spitali të Ri është shënuar me shenja horizontale – vija e aksit, vijat anësore, shigjetat, pengesat dhe vendkalimet e këmbësorëve.

Në këto rrugë janë aplikuar këto shënime horizontale të komunikacionit:

- Vijat gjatësore dhe tërthore,
- Vendkalimet e këmbësorëve,
- Shigjetat orientuese,
- Vend-parkingjet për persona me aftësi të kufizuara,
- Vend-parkingjet për taksì,
- Sipërfaqe të ndryshme orientuese,
- Mbishkrime në rrugë (afër institucioneve arsimore).

4.4 Pengesat rrugore për qetësimin e komunikacionit

Në kuadër të kësaj fushe kemi bërë vendosjen e pengesave rrugore për qetësimin e komunikacionit në disa rrugë urbane të qytetit dhe në fshatra, ku prioritet i kemi dhanë rrugëve në afërsi të shkollave si dhe në ato rrugë ku ka frekuentim më të madh të fëmijëve duke analizuar edhe infrastrukturën përcjellëse (mungesa e trotuareve dhe shtigjeve për ecje).

4.5. KAMERAT E SIGURISË

Në kuadër të këtij projekti janë realizuar këto punë:

- Shtirja e fibrës optike në kanalet nëntokësore në rrugët urbane “Driton Islami”, “Ahmet Kaçiku”, “Vëllezërit Gërvalla”, “Rexhep Bislimi”, “Gursel dhe Bajram Sylejmani” dhe rrugë tjera, fibra optike ka kaluar në mënyrë ajrore nëpër shtylla elektrike dhe të ndriçimit.
- Janë vendosur kamera të reja të sigurisë dhe janë funksionalizuar kamerat ekzistuese.

5. NJËSIA E NDRIÇIMIT PUBLIK

Gjatë vitit 2024 ka vazhduar puna me intensitet të shtuar në mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik i cili po vjen çdo herë duke u zgjeruar.

Pozicionet të cilat janë ndërruar më shumë gjatë këtij viti për shkak të defekteve prishjeve etj. gjatë mirëmbajtjes:

- Trupa ndriçues LED 50V – 1739 copë
- Trupa ndriçues 80-100 [V] – 228 copë
- Trafo për trupa ndriçues LED 50V – 1155 copë
- Trafo për trupa ndriçues LED 80-100 [V] – 120 copë
- Çipa për LED – 432 copë
- Kontaktorë – 98 copë
- Përçuesi i pestë Al 16mm² - 3793 m

Gjatë vitit 2024 janë vendosur 366 trupa ndriçues të rinj LED (294 trupa ndriçues 50V +72 trupa ndriçues 100V) me një vijë gjatësore prej 12.5 Km.

Gjithsej deri më tani vija gjatësore e tërësishme e ndriçimit publik në Komunën e Ferizajt deri në fund të vitit 2024 ka arritur në 772.5 Km.

Përveç punës në mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik në fund të vitit 2024 kemi bërë dekorimin e qytetit për festat e fund vitit duke i vendosur bredhin e Vitit të Ri dhe elementet tjera dekorative në sheshin “Adem Jashari” para objektit të Komunës në bulevardin “Dëshmorët e Kombit” dhe në disa pika tjera më frekuentuese në qytet.

5.1 Mirëmbajtja dhe rregullimi i konstruksioneve dhe objekteve nga metali, druri dhe plastika

Në kontratën e mësipërme gjatë viti 2024 janë kryer punët si në tabelën e mëposhtme,

Furnizimi dhe montimi i konstruksioneve metalike me dimensione 60x40x2.5mm	m	382
Furnizimi dhe montimi i konstruksioneve metalike me dimensione 40x40x2mm	m	254
Furnizimi dhe montimi i rrjetave metalike për fushat sportive me trashësi 5.5mm	m ²	552
Rregullimi i parqeve (në këtë pozicion përfshihet komplet rregullimi i hapësirave duke filluar me gërryerjen e dheut, rregullimin e sipërfaqes e deri ne fazën finale - mbjellja e barit)	m ²	6029
Furnizimi dhe montimi i ulëseve me material drusor dhe hekur	Copë	9
Furnizimi dhe mbjellja e drunjve dekorativ në parqet e shkollave	Copë	81
Furnizimi dhe montimi i konstruksioneve metalike me dimensione 100x100x2.5mm	m	173
Furnizimi dhe montimi i konstruksioneve metalike me dimensione 20x40x2mm	m	60

6.NJËSIA E SHËRBIMIT TË ZJARRFIKJES DHE SHPËTIMIT

Në vitin 2024 Shërbimi Zjarrfikës dhe Shpëtimit ka pasur **gjithsej 897 dalje** të ndara në kategori intervenimesh të cilat janë paraqitura në pjesën e dytë të raportit pjesa grafike e intervenimeve.

Si sfida më të mëdha përpos intervenimeve të ndryshme që kemi marrë pjesë nga më të ndryshmet shërbimi ynë sfidë serioze që ka ndikuar drejtpërdrejt në punën tonë ka qenë numri i pamjaftueshëm i zjarrfikësve profesional. Po ashtu çështje me prioritet në zhvillimin e shërbimit zjarrfikës është aktivizimi i njësisë vartëse zjarrfikëse në rrugën “Enver Topalli” ku objekti ri ka përfunduar por vetëm duhet plotësuar me inventarë shtesë, automjete dhe pranimin e punëtorëve zjarrfikës.

Realizimi i përgjithshëm i intervenimeve në zjarre dhe intervenime të tjera 2023-2024

NJËSIA PROFESIONALE E ZJARRFIKJES DHE SHPËTIMIT - FERIZAJ

Viti 2023

Viti 2024

822

897

Nr .	Muajt e Vitit 2024	Pjesëmarrja e zjarrfikësve	Pjesëmarrja e automjeteve	Objekte ndërtimore	Zjarre malore	Zjarre fushore	Aksidente trafiku	Automjete	Pajisje elektrike	Shërbime	Intervenime teknike	Mbeturina	Bombola gazi	Objekte tjera	Vërshime	Oxhaqe	Ushqim të kafshëve	Stabilimente elektrike	Të rrejshme	Eksplozive	Të lënduar	Të vdekur
1	Janar			10	0	1	1	2	0	0	10	2	0	0	0	6	2	7	0	0		
2	Shkurt			6	5	42	0	1	1	0	8	8	0	1	0	3	0	5	0	0		
3	Mars			0	4	13	2	1	3	5	8	12	0	1	0	1	0	3	0	0		
4	Prill			4	13	8	2	2	3	5	7	7	1	1	1	0	0	3	0	0		
5	Maj			0	0	0	1	2	2	6	1	7	0	0	0	0	0	3	1	0		
6	Qershor			7	1	10	4	1	1	10	10	10	0	2	23	0	2	5	0	0		
7	Korrik			9	4	65	4	2	0	4	11	11	1	2	0	0	0	7	0	0		
8	Gusht			9	24	109	3	2	2	19	14	21	0	0	0	0	0	7	2	0		
9	Shtator			9	7	26	1	1	4	6	5	10	0	2	0	0	0	0	1	0		
10	Tetor			3	2	3	3	1	7	0	4	14	0	1	0	0	0	0	0	0		
11	Nëntor			15	0	0	4	3	8	6	5	6	0	0	0	0	0	1	1	0		
12	Dhjetor			8	0	0	1	2	21	9	8	6	0	0	1	0	0	10	0	0		
Intervenimet mujore të vitit 2024				80	60	277	26	20	52	70	91	114	2	10	25	10	4	51	5	0		897
897 Intervenime																						
2024 Ferizaj											NJPZSH - FERIZAJ											



ferizaj.rks-gov.net